

RAPORTI MIDIS IDEOLOGJISË DHE PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË

Burim Mexhuani

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me
profil Shkenca Politike-Marrëdhënie Ndërkombëtare, për marrjen e gradës
shkencore Doktor

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Ervis Iljazaj

Numri i fjalëve: 55.881

Tiranë, Korrik 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Përmes kësaj deklarate premtoj se punimi në fjalë është punë e imja origjinale dhe se të gjitha idetë, të dhënat dhe gjuha e përdorur e cila mund t'i takojë një subjekti tjetër është cituar me saktësi dhe sipas rregullave të kërkuara duke ia atribuar autorësinë subjektit të cilit i jam referuar në punim.

ABSTRAKTI

Kjo tezë ka për qëllim të studioj raportin midis Partive Politike në Kosovë dhe ideologjisë. Ndërsa hulumtimet paraprake kanë një perspektivë socio-ekonomike tepër të madhe për të analizuar raportin e Partive Politike në Kosovë me Ideologjinë, ne kemi marrë në konsideratë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm (rrethanat politike dhe historike, prezencën e administratës ndërkombëtare; mungesën e elitave politike dhe efektet globale) që shprehinë paqartësinë e raportit midis Partive Politike dhe Ideologjisë. Ndikimi i ideologjisë tek partitë politike si mjet me të cilin partitë politike e përdorin për të treguar përkatësinë e orientimit ideologjik, më shpie mua të paraqes një pyetje se si sillen partitë politike në Kosovë në raport me Ideologjinë?

Metodologjia e përdorur është metoda cilësore dhe sasimore, metoda e përshkrimit, krahasimit, analizës së variablave dhe analizës së të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga procesi i hulumtimit. Punimi i këtij studimi bazohet në hulumtimin e literaturës nga autorë dhe njohës vendor dhe të huaj, mbledhja dhe analiza e të dhënave lidhur me raportin e Partive Politike me Ideologjinë.

Duke përdorur rast studimi Kosovën, ne argumentojmë që Partitë Politike në Kosovë kanë një lidhje të dobët me ideologjinë dhe nuk janë pozicionuar mirë sipas kërkesave të krahëve ideologjik të caktuar, pasi ato ofrojnë pikëpamje kontradiktore mbi pikëpamjet socio-ekonomike dhe vendimmarrjen në qeverisje.

*Ky studim kontribuon në literaturën mbi “Ideologjinë politike në Partitë Politike”, duke demonstruar efekte në një kontekst të rëndësishëm, por ende të anashkaluar, deri tani tek partitë politike. **Fjalët kyçe: Partitë Politike, Ideologji, PDK, LDK, VV***

ABSTRACT

This thesis aims to study the behaviour of political parties in Kosovo concerning Ideologies. While previous research has a very large socio-economic perspective to analyze the relationship of Ideology with Political Parties in Kosovo, we have considered internal and external factors (political and historical circumstances, the presence of international administration; lack of political elites; and globalizing effects) that affect the expression of the uncertainty of the relationship of Political Parties with Ideology. The influence of ideology on political parties as a means by which political parties use it to show the affiliation of ideological orientation, leads me to present a question of how political parties behave in Kosovo with Ideology?

The methodology used is the qualitative and quantitative method, method of description, comparison, analysis of variables and analysis of data and information collected from the research process. The paper of this study is based on the research of literature by local and foreign authors and connoisseurs, data collection and analysis related to the relationship of Political Parties with Ideology.

Using the Kosovo case study, we argue that Political Parties in Kosovo have a weak connection to ideology and are not well positioned according to the demands of certain ideological wings, as they offer contradictory views on socio-economic views and governance decision-making.

*This study contributes to the literature on "Political Ideology in Political Parties", demonstrating effects in an important but still overlooked context, so far on political parties. **Keywords: political parties, ideologies, KDP, DLK, VV***

DEDIKIMI

Djalit tim Kronit.

FALENDERIME

Shprehë falënderimet e mija për dhe mirënjohjen të thellë Prof. Dr. Asoc. Ervis Iljazi, i cili më ka udhëzuar me shumë kujdes dhe profesionalizëm në secilën etapë të punës sime kërkimore.

Gjithashtu falënderoj kolegët e mijë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të cilët më ndihmuan në realizimin e anketimit.

Së fundmi, falënderimet i adresohen bashkëshortes sime Liridona, e cila më ka krijuar lehtësira dhe mjedisin e ngrohtë familjarë për të realizuar këtë temë doktrate.

HYRJE	10
KAPITULLI METODOLOGJIK	12
1.1 RISHIKIMI I LITERATURËS	12
1.2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT	20
1.3 SHTRIMI I PROBLEMIT	21
1.4 PYETJA KËRKIMORE DHE HIPOTEZA	22
1.5 METODAT DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT	24
1.5.1 BURIMET E REFERIMIT.....	25
1.6 STRUKTURA E TEZËS	26
KAPITULLI 2: KUADRI TEORIK	29
2.1 MËNYRA TË NDRYSHME TË KONCEPTIMIT TË IDEOLOGJISË	31
2.2 PROFILET KRYESORE IDEOLOGJIKE	35
2.2.1 LIBERALIZMI	40
2.2.2 KONSERVATORIZMI	43
2.2.3 SOCIALIZMI.....	45
2.3 DISKUTIMET TEORIKE RRETH KONCEPTEVE “E MAJTË”, “E DJATHTË”	47
2.4 TEZAT PËR “FUNDIN E IDEOLOGJISË”	61
KAPITULLI 3: PARTITË POLITIKE NË KOSOVË PARA DHE PAS PAVARËSISË.....	64
3.1 SFONDI HISTORIK I FORMIMIT TË PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË	64
3.2 PARTITË POLITIKE NË KOSOVË GJATË ADMINISTRIMIT NDËRKOMBËTAR.....	68
3.3 PARTITË POLITIKE PAS PAVARËSISË SË KOSOVËS	70
KAPITULLI 4: ANALIZË: SJELLJA E PARTIVE POLITIKE NË RAPORT ME IDEOLOGJINË	74
4.1 SISTEMI PARTIAK NË KOSOVË	74
4.2 IDEOLOGJITË E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË	78
4.2.1 RAPORTI MIDIS IDEOLOGJISË DHE LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVË.....	81
4.2.2 RAPORTI MIDIS IDEOLOGJISË DHE PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS.....	90
4.2.3 RAPORTI MIDIS IDEOLOGJISË DHE LËVIZJES VETËVENDOSJE	97
4.3 PROGRAMET ELEKTORALE DHE LIGJËRIMET TË SUBJEKTEVE POLITIKE NË KOSOVË	103
4.4 NDIKIMI I ADMINISTRATËS NDËRKOMBËTARE NË VENDIMMARRJEN E POLITIKAVE LOKALE.....	109
4.5 EFEKTET E GLOBALIZMIT TEK IDEOLOGJITË E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË	113
4.6 PERCEPTIMI I ELEKTORATIT NË KOSOVË MBI RAPORTIN NDËRMJET IDEOLOGJISË DHE PARTIVE POLITIKE	121
4.6.1 METODOLOGJIA E ANKETIMIT.....	121
4.6.2 REZULTATET E ANKETIMIT	125
4.6.3 INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË ANKETIMIT	138
KAPITULLI V: REZULTATET E ANALIZËS TË INDIKATORËVE	140
5.1 REZULTATET E ANALIZËS TË INDIKATORIT 1.....	140
5.2 REZULTATET E ANALIZËS TË INDIKATORIT 2	141
5.3 REZULTATET E ANALIZËS TË INDIKATORIT 3	142
5.4 REZULTATET E ANALIZËS TË INDIKATORIT 4	144
KAPITULLI VI: DISKUTIMET DHE PËRFUNDIMET	147
6.1 KUFIZIMET E STUDIMIT-IMPLIKIMET DHE HULUMTIMET NË TË ARDHMEN	147

6.2	RISIA E KËTIJ STUDIMI	149
6.3	PËRFUNDIMET	153
REFERENCAT		158
SHTOJCA 2: STRUKTURA E PYETJEVE		176
SHTOJCA 3: LISTA E TABELAVE DHE DIAGRAMEVE		182

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
BE	Bashkimi European
BPV	Bruto Produkti Vendor
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja VETËVENDOSJE
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Kombet e Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim European
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

HYRJE

Studimet e mëhershme mbi partitë politike në Kosovë kanë pasur tendencë për të qartësuar profilet ideologjike, por të gjitha ato studime nuk kanë mundur të përcaktojnë profilet ideologjike në një kategori të vetme. Më herët partitë politike në Kosovë i përkasin një profili të caktuar ideologjik, ashtu siç kreu i ati subjekti politik. Në shumë vende, të cilat kanë një demokraci të zhvilluar, partitë politike nuk kanë një profil të qartë ideologjik. Kjo duket të jetë edhe më e vështirë për shtetin e Kosovë me një shoqëri të dalë nga konflikti, që ende është në përpjekje për të ndërtuar shtetësinë e vet.

Ne në këtë punim doktrate përpiqemi që t'i plotësojmë studimet e mëparshme, duke bërë një analizë të partive kryesore politike në Kosovë. Shpërndarja kolektive e mendimeve është një tregues real se si qëndron raporti midis partive politike dhe ideologjisë, dhe çfarë trendi të votimit mund të pritet të kenë përfaqësuesit e tyre në legjislaturë.

Mungesa e një profili të qartë ideologjik mund të shpjegohet vetëm duke e pasur parasysh faktin se partitë politike në Kosovë janë formuar gjatë përpjekjeve për çlirim. Partitë kryesore në Kosovë u krijuan në kohën e rezistencës paqësore dhe pas përfundimit të luftës. Prandaj, mund të thuhet se partitë politike në Kosovë kanë prirje majtiste, liberale, ose nacionaliste, sepse këto anime nuk kanë qenë kriter për përafrimin e tyre fillestar.

Për shkak se Kosova një pjesë të madhe të tranzicionit nuk është qeverisur nga vetë kosovarët, është vonuar po ashtu edhe zhvillim evolutiv i partive politike drejt profilizimit ideologjik.

Kosova për një kohë të gjatë u administrua nga bashkësia ndërkombëtare (UNMIK), e cila privoi elitën politike nga qeverisja e vendit – dhe kjo mospjesëmarrje në qeverisje i kurseu politikanët e zgjedhur vendorë nga nevoja për tu pozicionuar për çështje specifike politike.

Kosova ende nuk është anëtare e OKB-së, politika e saj e jashtme po ashtu mund t'ia lejoj vetes që të mos marrë ndonjë qëndrim për çështjet me rëndësi ndërkombëtare.

KAPITULLI METODOLOGJIK

1.1 Rishikimi i literaturës

Partitë politike, mënyra e funksionimit të tyre, programet politike, ideologjitë dhe struktura e tyre janë studiuar shumë nga shumë shkencëtarë social dhe politik. Disa nga më të njohurit por jo vetëm që janë: (Sartori, 1998; Duverger, 1954; Seiler, 2012; Gunther, R., Diamond, L , 2003; Kitschelt H. , 1995).

Gjithashtu (Dommett K. , 2014; Millard F. , 2004; Webb, P., White, S. , 2007; Lewis, 2001), për partitë politike pas rënies së regjimeve komuniste si pjesë e demokracive të reja. Pavarësisht grupeve të tjera, partitë politike bazuar në programet që i ofrohen elektoratit, mbajnë një qëndrim të qëndrueshëm për problemet sociale dhe ekonomike, politikën e jashtme dhe tema të tjera.

Artikulimi i qëndrimeve, besimeve, qasjeve ndaj fenomeneve dhe mënyrës së zgjidhjes së disa çështjeve të qeverisjes përbëjnë ideologjinë e një partie politike. Për më tepër, më shumë mund të argumentohet se “ideologjia është një sistem besimi, i përfaqësuar nga një grup i caktuar i aktorëve shoqërorë. Ideologjia mund të ndryshohet tek persona të caktuar, në varësi të besimit dhe vizionit në lidhje me qëndrime të caktuara” (Van Dijk, 2006). Partitë politike bazuar në programet dhe ideologjitë e tyre ndahen në tre grupe të përgjithshme: E djathta, e majta dhe e qendrës që kanë ose element të djathtë ose të majtë.

Kontribut të jashtëzakonshëm në studimin e Partive Politike ka dhënë (Gunther, R., Diamond, L , 2003), të cilët në analizën e tyre: “*Speciet e Partive Politike, tipologjia e re*”, ata i kategorizojnë partitë politike në tre tipologji: E para ka të bëjë me organizimin zyrtar

të partive politike. E dyta përfshin natyrën e angazhimit programatik të Partive Politike. Disa parti mbajnë pozicione të artikuluar mira ideologjike, bazuar në filozofi, besime fetare ose ndjenja kombëtare. Disa janë pragmatike dhe nuk kanë angazhime të qarta ideologjike ose programore. Ndërsa disa të tjera drejtohen në veçanti drejt grupeve të caktuara etnike, zonat fetare, sociale ose ekonomike, ose zonat e përcaktuara gjeografike, përkundër partive që janë heterogjene, nëse jo diskriminuese dhe gjithëpërfshirëse. E treta merret me strategji dhe norma të sjelljes së Partive Politike (Gunther, R., Diamond, L , 2003).

Tipologjia e dytë e partive politike për sa i përket organizimit programatik është sfiduese në vendet e dala nga komunizmi në Kosovë. (Kitschelt H. , 1995) bëri kategorizimin e partive politike bazuar në: “Karizmi, Klientizmi dhe Programet”.

Për shkak të konkurrencës së partive politike bazuar në programet e tyre, një numër i autorëve pretendojnë se:

“(1) demokracitë postkomuniste nuk do të bazohen në programe në të ardhmen e afërt, por shumë më tepër në udhëheqje dhe patronazhi dhe;

(2) demokracitë postkomuniste do të mbeten të pa konsoliduar për një periudhë të caktuar kohe” (Kitschelt H. , 1995).

Nga zhvillimet e mëvonshme, në shumë vende dhe në Kosovë, analiza e Kitschelt vazhdon të mbetet ende e pranishme. Kategoritë e lartpërmendur përfshijnë në parim pothuajse të gjitha llojet e partive politike. Secila parti politike është pjesë e një ose më shumë prej këtyre kategorive, në varësi të nivelit të zhvillimit të demokracisë, kontekstit të themelimit

të tyre, rrethanave të veprimit dhe profilizimit. Në demokracitë e konsoliduar, partitë politike janë profilizuar dhe strukturuar, krahasuar me demokracitë e reja në procesin e konsolidimit. Kjo gjithashtu vlen për vendet e dala nga komunizmi, të cilat, nga një sistem një partiakë, janë transferuar në sistemin shumë partiak. Ndërsa partitë të cilat ishin më afër sistemit komunist ose që ishin pasardhës të drejtpërdrejtë të këtij sistemi, ato kishin pozicione të majta edhe pse në rrethana të reja demokratike.

Partitë që dolën nga lëvizjet e studentëve, punëtorëve ose lëvizjet intelektuale, të cilat ishin në favor të ndryshimit të sistemi mono-partiak, duke e kundërshtuar atë në mënyra të ndryshme. Me vendosjen e sistemit shumë partiak dhe krijimin e partive të reja, të lindura nga kundërshtarët e sistemit komunist, ato u klasifikuan si parti e krahut të djathtë. Sipas (Millard F. , 2004), partitë ideologjike në vendet e mëparshme komuniste nuk ishin gjithmonë koherente, si dhe shqetësimet dhe përparësitë e tyre të programit ndryshonin në mënyrë thelbësore nga partitë e Europës Perëndimore. Shumica e Partive Parlamentare dëshmuar aftësi të dobët për të vendosur politika të qarta dhe të prekshme. Partitë politike në Europën Qendrore dhe Lindore ishin të dy llojeve: Ato ishin të ngjashëm në konkurrencën për pushtet, kishin dobësi në profilizimin e tyre ideologjik dhe mungesë qëndrueshmërie. Lloji i parë erdhi si rezultat i sfidimit të partisë komuniste në pushtet. E dyta ishin Partitë politike në pushtet në sistemet e fuqishme presidenciale si në Rusi (de jure) dhe në Ukrainë (de facto). Këto parti formuan partitë me një elitë të dobët ideologjike, përmes ofertave gjithëpërfshirëse elektorale me qëllimin e vetëm për të mbetur në pushtet (Millard F. , 2004).

Shqyrtimi i tanishëm i literaturës ka të bëjë me hulumtimin në lidhje me dimensionin e ideologjisë, ose strukturës së qëndrimeve shoqërore. Struktura e qëndrimeve i referohet marrëdhënieve midis qëndrimeve ndaj objekteve të ndryshme, të mbajtura nga individë në një popullsi të caktuar.

Literatura sociologjike shpesh i referohet qëndrimeve shoqërore, por referencat për ideologji apo qëndrime politike janë gjithashtu të zakonshme. Qëndrimet vlerësohen si shoqërore kur u referohen objekteve që kanë “rëndësi të përbashkët shoqërore në fushat ekonomike, politike, fetare, arsimore, etnike dhe të tjera sociale” (Kerlinger, Fred N., Cees P. Middendorp, and J. Amon. , 1976)

Ideologjia e majtë nga e djathta vlerësohet si një shprehje e ndarjeve socio-ekonomike. Kohët e fundit, ajo është zgjeruar për të përfshirë orientime të tilla si nacionalizëm ose post-materializëm, dhe forcon lidhjen e saj me strukturën shoqërore. Për më tepër, kuptimi i të majtës dhe të djathtës politike ndryshon në kontekstet politike.

Për të kuptuar dimensionin ideologjik të së majtës së djathtë në një kontekst specifik, është e nevojshme të shqyrtohen mënyrat se si partitë politike në Kosovë i referohen qëndrimeve shoqërore, ekonomike, politike etj.

Konceptet e të majtës dhe të djathtës politike janë disa nga nocionet më qendrore politike, veçanërisht në kontekstin Europian. Ligjërimi politik dhe literatura akademike vështirë se mund të konceptohen pa këto koncepte. Ato duken të domosdoshme për të përshkruar ideologjitë dhe lëvizjet politike, ngjarjet, partitë politike, aktorët dhe fenomenet e tjera politike. E majta dhe e djathta politike janë emërtime të përdorura edhe për vetë-përshkrim. Individët dhe grupet shpesh përshkruajnë pikëpamjet dhe preferencat e tyre për sa i përket të majtës dhe të djathtës (Fuchs, D., & Klingemann, H. D, 1990). Këto koncepte shërbejnë

një mori funksionesh - komunikimi politik, orientimi dhe vetë-përshkrimi. Dimensioni “i majtë” dhe “i djathtë” shërben gjithashtu si një “shkurtim njohës”, i cili mund të ndihmojë publikun të artikulojë preferencat e tyre, përfshirë zgjedhjen e një partie për të votuar në zgjedhje, me një përpjekje minimale njohëse.

Në vendet perëndimore, identifikimi i krahut të djathtë shoqërohet në mënyrë tipike me mbështetjen për disa grupe partish: partitë që promovojnë politika ekonomike (treg të lirë), parti liberale (ato që mbështesin shtrirjen e lirive civile, por edhe 'tregun e lirë'), si dhe parti popullsiste nacionaliste, anti-emigruese, të krahut të djathtë. Identifikimi i krahut të majtë është tipik për përkrahësit social-demokratikë, si dhe për ata që mbështesin më shumë ideologjinë tradicionale socialiste, si dhe forma të ndryshme të kategorive më ekstreme të partive të majta (komuniste, anarkiste etj).

Situata në Evropën Lindore tregon disa ndryshime sistematike. Së pari, dimension i ideologjik ka një lidhje të dobët me preferencat e partisë, gjë që nuk është për t'u habitur duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë dhe fragmentimin e lartë të këtyre sistemeve partiake. Ende, parti-trashëgimtarë të ish-komunizmit janë zakonisht të majtë, ndërsa partitë fetare janë në të djathtë. Në disa vende të Europës Lindore, identifikimi i së djathtës dhe së majtës shpejt ndoqën modelin e Europës Perëndimore, duke shfaqur preferencat të forta për ekonomi të tregut të lirë (Kitschelt, H., Mansfeldova, Z., Markowski, R. & Tóka, G, 1999).

Bazuar në përshkrimin e mësipërm, pritjet e caktuara për Kosovën mund të nxirren. Në këndvështrimin global, Kosova është afër “Perëndimit” për sa i përket tipareve kulturore dhe sociale, dhe në ekspozimin ndaj rrymave kryesore ideologjike dhe traditave intelektuale që i frymëzojnë ato. Prandaj, modeli themelor duhet të përafrohet drejt modelit

perëndimor. Sidoqoftë, për shkaqe të rrethanave historike dhe politike nuk është përshkruar në mënyrë tipike për sa i përket koncepteve ideologjike të majta dhe të djathta. Përkundrazi, emërtimet ideologjike të përhapura në ligjërimin publik kanë qenë demokratikë, nacionalistë, socialistë. Si rezultat, konceptet ideologjike të majta dhe të djathta nuk duken qartësisht të kuptueshme për partitë politike.

Gjithashtu, kur ata shprehin pozicionin e tyre, mund të mos ketë lidhje me kërkesat e profileve ideologjik që ato deklarojnë se i përkasin.

Punimi ynë i doktoratës mbështetet tek një numër i studimeve kritike të spikatura. Këto studime më kanë shërbyer në punën time në dy funksione: Për të përcaktuar perspektivën aktuale kritike dhe për të justifikuar që hulumtimi im përparon drejtë objektivit kërkimor.

Për sa i takon Kornizës teorike, ne kemi analizuar makro teoritë të studiueseve të ndryshëm si Andrea Heewood, Karl Marx, Lipset, Scarrow, Brunell, Rajmond, Max Horkheimer, Theodor W. Adorno, Erich Fromm dhe Herbert Marcuse për të shpjeguar konceptet teorike të Ideologjisë dhe dimensionet “e majtë” dhe “e djathtë”.

Studime për profilet ideologjike të partive politik ka pasur edhe nga studiues kosovarë. Ne kemi analizën e prof. Adem Beha në librin ”Zgjedhjet, partitë politike dhe demokracia brenda partiak”, ku trajtohet ndër të tjera edhe aspekti ideologjik i partive politike në Kosovë dhe i bëhet kritikë mungesës së ideologjive të qarta të partitë politik në Kosovë. Në këtë libër, i bëhet një kritikë fuqisë së pa kontestuar të liderit për të ekzekutuar vendime pa e konsultuar as anëtarësinë e gjerë dhe aq më tepër strukturat vendimmarrëse që pamundëson vendimmarrjen demokratike brenda partive politike. Kjo trajtesë përshtatet me njërin nga variablatë tona të hipotezës se paqartësia e raportit midis partive politike dhe ideologjisë ka të bëjë edhe me arbitraritetin e udhëheqjes së partive se në çfarë profili

ideologjike synojnë të kenë partia e tyre. Profilin ideologjikë që ato deklarojnë në programe dhe ligjërime politike shpesh nuk përputhen me vendimmarrjen e as me votimit të tyre në Kuvendin e Kosovës.

Gjithashtu, disa studime janë kryer edhe nga ambasadori Leon Malazog nga instituti “D4D”, ku është bërë hulumtim mbi pozicionet e profileve kryesore të ideologjive në kontekstin e disa demokracive perëndimore. Gjetjet e prezantuara nga ky studim na kanë për të kuptuar më mirë nivelin e pikëpamjeve ideologjike dhe se si partitë zhvillojnë politika pozicionuese”. Autori i këtij studimi kushton një vëmendje të madhe orientimit ideologjik të partive politike në Kosovë duke përdorur si metodë pune intervistimin e zyrtarëve të partive kryesore. Marrë në përgjithësi, të gjitha studimet kanë një karakter deskriptiv dhe mund të thuhet harta e orientimit të partive politike është bërë vetëm në kuadrin e kuadratit të dëshiruar ideologjik të zyrtarëve partiakë.

Një analizë e karakterit përshkruar nga pikëpamja teorike është bërë edhe nga instituti “KIPRED”, tek: “*Sistemi Zgjedhor dhe Partiak në Kosovë*”. Autori në këtë analizë ofron elementë analitikë duke na informuar për zhvillimin e partive politike që nga përfundimi i luftës. Një analizë serioze për funksionalitetin e partive politike në Kosovë është ndërmarrë nga studjuesi Valon Krasniqi që është botuar në Revistën shkencore “*Revista de Saúde Pública*”. Autori ka përdorur teoritë më të spikatura në fushën e shkencave politike për të pasqyruar një raport të mundshëm midis partive politike dhe ideologjisë.

Gjithashtu, duhet nënvizuar se në të gjitha këto studime nuk analizohen disa variabla që kanë pasur ndikim në paqartësinë e raportit midis partive politike dhe Ideologjisë, siç janë: efektet globale, roli i FMN-së dhe mungesa e elitave politik sipas profileve ideologjike.

Ky punim sjell risi në literaturën shkencore mbi raportin që Partitë politike kanë me ideologjitë.

Ky punim doktrate ka implikime thelbësore për qartësimin e raportit ndërmjet Ideologjisë dhe partive politike. Hulumtimet paraprake kanë një perspektivë socio-ekonomike tepër të madhe për të analizuar raportin midis Partive Politike dhe Ideologjisë, ne kemi marrë në konsideratë faktorët politikë që kanë ndikim në raportin e ideologjisë me partitë politike.

Ky studim ndërmerr hap të rëndësishëm në atë drejtim duke marrë parasysh bazat ideologjike të sjelljes së partive politike në shmangien e ideologjisë. Duke treguar që partitë politike ndryshojnë në mënyrë sistematike jo vetëm në prirjen e tyre ideologjike por dhe në ligjërimin e tyre politik dhe vendimmarrje. Ky studim përfshin një hapësirë të konsiderueshme në zgjerimin e të kuptuarit shkencor të paqartësisë ideologjike tek partitë politike në Kosovë.

Si i tillë, ky studim kontribuon në literaturën mbi “Ideologjinë politike në Partitë Politike”, duke demonstruar efekte në një kontekst të rëndësishëm, por ende të anashkaluar, deri tani tek partie politike.

Ne argumentojmë që partitë politike në Kosovë kanë një lidhje të dobët me ideologjinë dhe nuk janë pozicionuar mirë sipas kërkesave të krahëve ideologjik të caktuar, pasi ato ofrojnë pikëpamje kontradiktore mbi pikëpamjet socio-ekonomike dhe vendimmarrjen në qeverisje. Nga pikëpamje ideologjike sugjerohen pikëpamje të qarta lineare për sa i përket programeve politike, ligjërimin politik dhe vendimmarrjes në qeverisje si kriter për qartësimin e pozicionimit ideologjik.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij punimi është për të studiuar raportin midis Partive Politike në Kosovë dhe Ideologjisë.

Në këtë punim vërehet se Partitë Politike në Kosovë kanë një marrëdhënie jo që qartë me ideologjitë politike. Partitë politike në Kosovë kanë programe të paqarta sipas pikëpamjeve të caktuara ideologjike. Kjo situatë shprehet qartë edhe në raportin midis veprimit politik, programeve politike dhe ligjërimit politik.

Krijimi i Partive politike në Kosovë u ndikuan nga rrethanat politike dhe historike, duke përjashtuar modelin ideologjik të themelimit të partive; paqartësia e raportit të partive politike në Kosovë me ideologjinë u ndikua edhe nga administrata ndërkombëtare, mos përcaktimi i statusit dhe marrëdhënieve me Serbinë. Partitë politike në Kosovë janë në proces të konsolidimi dhe profilizimi. Kjo shfaqet gjatë debateve, ofertave elektorale dhe programeve të tyre.

Ky qëllim mund të përfshijë edhe shpjegimin e shkakut themelor të këtij studimi.

Ky disertacion doktorate synon përmbushjen e këtyre objektive:

- Ky studim ka implikime thelbësore për qartësimin e raportit të partive politike me Ideologjinë.
- Ky studim ndërmerr një hap të rëndësishëm në atë drejtim duke marrë parasysh bazat ideologjike të sjelljes së partive politike në shmangien e ideologjisë.
- Ky studim përfshin një hapësirë të konsiderueshme në zgjerimin e të kuptuarit shkencor të paqartësisë ideologjike tek partitë politike në Kosovë.

- Studim kontribuon në literaturën mbi “ideologjinë politike në Partitë politike”, duke demonstruar efekte në një kontekst të rëndësishëm, por ende të anashkaluar, deri tani tek partie politike.

1.3 Shtrimi i problemit

Partitë kryesore në Kosovë kanë një raport të paqartë me ideologjinë, dhe ky raport shprehë dëshirën e udhëheqjes së partisë se çfarë profili ideologjik synojnë ta zhvillojnë partinë në të ardhmen. Profilin të cilin e kërkojnë nuk përkon me ligjërimin e tyre politik dhe as me historinë e votimit të tyre në Kuvend.

Profili ideologjik tek partitë politike në Kosovë përcaktohet nga organet e saj udhëheqëse. Është me rëndësi thelbësore të analizohen partitë politike kryesore në Kosovë si: PDK (Partia Demokratike e Kosovës), LDK (Lidhja demokratike e Kosovës) dhe LVV (Lëvizjen Vetëvendosje), të cilat kanë mbajtur barrën kryesore të ndërtimit të shtetit të Kosovës.

Për këtë arsye, ideologjia është thellësisht e lidhur me interpretimin, por ndryshe nga diskursi teorik, argumentoj se për një ideologji është e nevojshme që gjykimet të qëndrojnë në konflikt me një tjetër vizion, duke ofruar një diagnozë të ndryshme të interesit shoqëror.

1.4 Pyetja kërkimore dhe hipoteza

Ndikimi i ideologjisë tek partitë politike si mjet me të cilin partitë politike e përdorin për të treguar përkatësinë e orientimit ideologjike, më shpie mua të paraqes një pyetje fillestare:

Çfarë raporti ekziston midis sjelljes së partive dhe ideologjive politike në Kosovë?

Krijimi i Partive politike në Kosovë u ndikuan nga rrethanat politike dhe historike, duke përjashtuar modelin ideologjik të themelimit të partive.

Hipoteza: Programet dhe vendimmarrjet e partive në Kosovë tregojnë një sjellje jo të qartë ideologjike të partive politike.

Partitë Politike në Kosovë kanë prezantuar gjithnjë platforma të paqarta të politikave për shkak të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm.

Një nga avantazhet e platformave të paqarta të politikave, në krahasim me orientimet e qarta ideologjike, është se mund të ndihmojnë ndryshimin e politikës brenda partive. Kjo do të thotë, partitë politike mund ta kenë më të lehtë të bien dakord për një grup më të gjerë të politikave, në vend që të krijojnë një marrëveshje për një platformë konkrete politikash. Për më tepër, partitë politike synojnë pjesë më të madhe të votuesve kur propozojnë një platformë të paqarta politike.

Sjellja e Partive Politike në Kosovë në raport me Ideologjinë u ndikua në masë të madhe nga administrata ndërkombëtare në Kosovë, mos përcaktimi i statusit dhe marrëdhënieve me Serbinë; roli i institucioneve ndërkombëtare, efektet globale dhe mungesa e elitave spas profileve ideologjike.

Hipoteza mund të deduktohen indikatorët si vijon:

Indikator 1: Nëse rrethanat politike dhe historike të statusit të Kosovës (deri më 2008),

ka qenë një nga faktorët që e ka bërë të padukshme ideologjinë në kuadër të partisë, atëherë kemi gjetur të dhëna që e konfirmojnë atë.

Indikatori 2: Nëse administrata ndërkombëtare në Kosovë ka ndikuar në krijimin e paqartësisë së raportit parti politike – ideologji, atëherë ne kemi gjetur të dhëna që e konfirmojnë atë.

Indikatori 3: Nëse efektet globale kanë ndikim në raportin e partive politike me ideologjinë, atëherë ne kemi gjetur të dhëna që e konfirmojnë atë.

Testimi i indikatorit 1: Ekzistojnë të dhëna që shërbejnë se rrethanat politike dhe historike të statusit të Kosovës, ka qenë një nga faktorët që e ka bërë të padukshme ideologjinë në kuadër të partisë. Këtu analizojmë historikun e krijimit të partive politike në Kosovë, kauzat e tyre politike, statutet dhe platformat e tyre elektorale.

Testimi i indikatorit 2: Ekzistojnë të dhëna që konfirmojnë se administrimi ndërkombëtar nga UNMIK-u ka qenë një faktorët që ka bërë të paqartë sjelljen e partive politike me ideologjinë. Këto ne bazohemi në aktet dhe urdhëresat ligjore të UNMIK.

Testimi i indikatorit 3: Ekzistojnë të dhëna që konfirmojnë se efektet global janë një nga faktorët që tregojnë se pse partitë në Kosovë nuk kanë një raport të qartë me ideologjinë politike.

Gjatë këtij studimi ne kemi realizuar edhe një anketim me elektoratin në Kosovë për të analizuar nga këndvështrimi i elektoratit profilin ideologjik të partive politike në raport me ideologjinë.

Anketa nuk parashtron pyetje të hapur për prirjet ideologjike, por i parashtroi 12 (dymbëdhjetë) pyetje specifike për një varg çështjesh. Secila nga përgjigjet përkon me një sistem të pikëve, e cila janë paraqitur në diagram.

1.5 Metodat dhe metodologjia e studimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim është analitike, duke analizuar variablat si dhe të dhënat dhe informacionet të mbledhur nga procesi i hulumtimit. Punimi i këtij studimi bazohet në hulumtimin e literaturës nga autorë dhe njohës vendor dhe të huaj, mbledhja dhe analiza e të dhënave lidhur me raportin e Partive Politike me Ideologjinë. Po ashtu do të analizojmë në mënyrë kritike vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga autorë të ndryshëm, literatura dhe raporte relevante, artikuj të ndryshëm shkencor, programet dhe statutet e partive politike. Në mënyrë të veçante do të analizojmë ndikimin e administratës ndërkombëtare që ka në raportin midis partive politike dhe ideologjisë. Duke u bazuar në shënimet që kemi siguruar nga metodat analitike dhe empirike, do të bëjmë futjen dhe sistemimin e të dhënave në formën e përshtatshme, në të cilën do të bëjmë analizimin e secilës variabël të pavarur.

Në këtë studim, ne përshkruajmë një qasje ndërdisiplinore për të kuptuar strukturën dhe dinamikën e ideologjisë politike dhe paqartësitë që demonstrohen tek partitë politike në Kosovë.

Ne së pari do të bëjmë rishikimin e literaturës ekzistues, duke analizuar autorë dhe literaturën e kësaj trajtese.

Së dyti, ne do të studiojmë strukturën konceptuale të ideologjive specifike brenda kornizës sonë, duke vlerësuar nënvariabla që kanë një ndikim pjesërisht në fenomenin që analizohet.

Së treti ne do të analizojmë ndërveprimin e faktorëve që ndikojnë në sjelljen e Partive Politike me Ideologjinë.

Metodologjia e shkrimit të punimit fokusohet nga këndvështrimi sociologjik dhe politik dhe në këtë punim janë përdorur:

Metoda përshkruese, e cila është përdorur duke cituar autorë të spikatur të fushës.

Metoda analitike, është përdorur për të analizuar faktorët që kanë demonstruar paqartësi të ideologjike tek partitë politike në Kosovë dhe

Metodën empirike, e cila është përdorur për të ofruar rezultate e të përpunuara nga anketimi me elektoratin e Kosovës. Mostra e hulumtimit ka qenë 500 anketues, sipas strukturës së moshës, gjinisë dhe vendbanimit, e cila është bashkëngjitur në shtojcën e punimit. Pyetësi i është ofruar 870 personave, nga të cilët 710, gjegjësisht 81.6 për qind e tyre u janë përgjigjur pyetjeve të shtrura. Anketimi është realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, me pyetësit (hardcopy) printuar si dhe në mënyrë elektronike.

Natyrisht qasja e studimit është analitike dhe metoda analitike është dominante në hulumtimin e kësaj materie.

1.5.1 Burimet e referimit

Metodologjia e punimit bazohet në shqyrtimin e burimeve primare dhe ato dytësore.

Për sa i përket kornizës teorike, ne kemi analizuar makro teoritë të studiueseve të ndryshëm si Mark, Engels, Andrea Heewood, Habermas, Lipset, Scarrow, Brunell, Rajmond, Fukuyama etj, pa lënë anash edhe studiues lokal.

Në grupin e dytë ne kemi studiuar statutet të partive politike, programet elektorale të partive politike, dokumente të ndryshme qeveritare dhe raporte të institucioneve vendore.

Në grupin e tretë fokus i studimit tonë kanë qenë ligjërimet politike të elitave të partive, raportet ndërkombëtare, gazetat dhe web faqet.

Dhe në grupin e katër, kemi gjykuar të ndërmarrim një anketim, përmes të cilit hetonim se si elektorati i Kosovës e perceptonte raportin midis ideologjisë dhe partive politike.

Për të lehtësuar punimin tim, në këtë punim kam shqyrtuar përfundimet ekzistuese të ideologjisë partiake ofruar nga teoricienët politikë..

Në vlerësim të këtyre veprave kam shqyrtuar pyetjen se sa është ideologjia e qartë në kuadrin e partisë, duke argumentuar me një metodë më të veçantë të studimit që njih specifikat e partive politike në Kosovë si dhe mjedisin në të cilin Partitë Politike të sillen në një mënyrë jo-ideologjike.

1.6 Struktura e tezës

Për të çuar përpara qëllimin e punimit, ne kemi strukturuar tezën si më poshtë:

- **Kapitulli 2 – Kuadri teorike**

Në këtë kapitull do ta kthejmë vëmendjen drejt të kuptuari të koncepteve ideologjike duke u bazuar në punën e teoricienëve më të spikatur të kësaj fushe si (Marx, K., Engels, F, 1976), (Freedon, 2003), (Fuchs, D., & Klingemann, H. D, 1990), (Bell D. , 2000), (Fukayama, 1992), e shumë studiues të tjerë për të eksploruar mënyra të ndryshme të studimit ideologjike në këtë kontekst.

Duke u bazuar në studime të ndryshme të studimit, theksohet nevoja për një formë të analizave për të pasqyruar faktorët e ndryshme të cilat ndikojnë në marrëdhëniet e partive politike me ideologji.

- **Kapitulli 3 - Partitë Politike në Kosovë para dhe pas Pavarësisë**

Krijimi dhe funksionimi i partive politike është njëra nga karakteristikat thelbësore të çdo sistemi demokratik politik. Përmes garës zgjedhore dhe mobilizimit të votuesve, pas një vizioni të caktuar për shoqërinë, partitë u ofrojnë qytetarëve zgjedhje të ndryshme dhe mundësi për udhëheqje dhe për formimin e ardhmërisë së shtetit.

Në këtë kapitull po ashtu kemi përshkruar

- *Sfondi historik i formimit të partive politike në Kosovë*
- *Partitë politike në Kosovë gjatë administrimit ndërkombëtar*
- *Partitë politike pas Pavarësisë së Kosovës*

Në këtë kapitull mund të përfundojmë se krijimi i Partive Politike në Kosovë u ndikua në masë të madhe proceset e ndryshëm historike dhe politike.

Kapitulli 4 – Analizë: Sjellja e Partive Politike në raport me Ideologjinë

Në këtë kapitull kam ngushtuar hendekun mes teorisë dhe praktikës, përshkruhet shtrirja e saktë e analizës sime dhe parimet metodologjike dhe proceset të cilat udhëheqin studimin tim mbi ideologjitë politike në Kosovë.

Preferenca ime e ndjekur nëpërmjet analizës së retorikës së elitës partiake, është përshkruar se janë parimet me të cilat përmbajtja e programeve politike dallohet nga ligjërimet publike.

Në kuadër të këtij kapitulli do jepen të dhëna për perceptimet publike të ideologjisë, duke pretenduar se një kuptim më të detajuar të perceptimeve të ideologjisë përftohet kur shqyrton mënyrën në të cilën mesazhi i një partie është deshifruar nga një audiencë. Me anë të këtij kapitulli, pra kemi për qëllim të pajisë lexuesit me mjetet e nevojshme për formën e

hetimit ideologjike dhe dallimet mes programeve politike me ligjërimet publike të partive politike. Në këtë kapitull do të analizohen edhe efektet globale dhe roli i ndërkombëtarëve që kanë ndikim në raportin Ideologji-Parti Politike.

Kapitulli 5 – Rezultatet

Në kapitull do të ndalemi për të testuar secilin indikatorë që paraqitet në shpjegimin e raportit midis Partive Politike me Ideologjitë.

Kapitulli 6- Diskutimet dhe Përfundimet

Në këtë kapitull jemi fokusuar në tri tematika:

- Kufizimet e studimit – implikimet dhe hulumtimet në të ardhmen
- Risia e këtij studimi
- Konkluzionet

Tek kufizimet e studimi kemi identifikuar të gjitha çështjet që mund të kenë ndikim në studimin e variablave dhe se si të tejkalohen ato në hulumtimet në të ardhmen. Ndërsa unë ndjek në gjurmët e studimeve të mëparshme në shpjegimin se si proceset politike dhe historike, pastaj ndikimi i administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe globalizmi kanë ushtruar ndikimin e tyre që konceptet “e djathtë”, “e majtë”, kanë qenë të padukshme tek partitë politike në Kosovë. Mirëpo, ky punim doktrate ofron një analizë të thelluar duke paraqitur disa nga variablat që kanë ndikim në aspektin e raportit të partive politike në Kosovë me Ideologjinë. Të gjitha këto, janë trajtuar në perspektivën e raportit ideologji parti politike.

Risia e këtij studimi kontribuon në literaturën mbi ”ideologjinë politike në Partitë politike”, duke demonstruar efekte në një kontekst të rëndësishëm, por ende të anashkaluar, deri tani tek partie politike.

Tek pjesa e konkluzioneve jepet një përmbledhje e gjitha të gjeturave nga analizimi i secilës variabël në këtë studim.

KAPITULLI 2: KUADRI TEORIK

Koncepti i ideologjisë ka provokuar debate midis shkencëtarëve socialë, të cilët u përpoqën të kuptojnë natyrën dhe funksionin e ideologjive të ndryshme të shoqërisë.

Mund të thuhet se koncepti i ideologjisë ka të ngjatë të jetë koncept më i ndërlikuar, meqë sipas literaturës, paraqet një grupim konceptesh, vlerash dhe simbolesh të cilat inkorporojnë koncepte të natyrës njerëzore. I nisur nga Revolucioni Francez i viteve 1790 dhe i analizuar së pari nga filozofi francez Antoine Destutt de Tracy, ky koncept vazhdoi me Marks-in në vitet 1840, në shekullin XX e deri më sot. Megjithatë ekzistojnë katër përdorime të termit “ideologji”:

1. shkencë e re empirike e ideve;
2. përkatësi e një forme të republikanizmit laik liberal;
3. konotacion negativ që përshkruan paaftësinë intelektuale dhe praktike dhe radikalizëm të rrezikshëm; dhe,
4. doktrinë politike (Vincent, 2010).

(Marx, K., Engels, F, 1976) e shikuan ideologjinë në një kuptim pezhorativ - si një ligjërim të shprehur për të ligjësuar autoritetin e atyre që janë në pushtet, dhe për të ruajtur status quo-në shoqëror (Marx, K., Engels, F, 1976) (Bendix, 1956)). Në të kundërt, shumë studiues të tjerë kanë adaptuar një qëndrim neutral, duke pranuar bazat filozofike dhe psikologjike të të gjitha ideologjive (Wilson, 1973; Beyer, J. M., R. L. Dunbar, and A.D. Meyer, 1988; Fine, G. A., and Sandstrom, K., 1993).

Në këtë këndvështrim, ideologjitë përbëjnë një grup të besimeve të gjera:

“Një ideologji është njëkohësisht një hartë njohëse për grupe sociale dhe një shkallë e vlerave në të cilat janë shpallur standardet dhe imperativat. Ideologjia shërben kështu si një çelës për të kuptuar dhe si një udhëzues për veprim, duke zhvilluar në mendjen e ithtarëve të tij një imazh të procesit me të cilin mund të arrihen më së miri ndryshimet e dëshiruara”. (Wilson, 1973).

Një nga pyetjet shumëvjeçare të bëra nga sociologë të ndryshëm kanë qenë mbi strukturën e ideologjisë, domethënë, mënyrën dhe shtrirjen ndaj të cilëve qëndrimet politike janë njohëse, të organizuar sipas një ose më shumë dimensioneve të preferencës ose gjykimit (Converse P. E., 2006; Duckitt, 2001; Eagly, A. H., & Chaiken, S, 1998; J.Eysenck, 1999; Feldman, 2003; Kerlinger, 1984).

Shkencëtarët socialë shpesh konceptojnë ideologjinë si një grup relativisht të organizuar të qëndrimeve ndaj objekteve të ndryshme shoqërore dhe politike që mund të rrjedhin nga më shumë vlerat të përgjithshme dhe pikëpamjet botërore. Ata, sidoqoftë, nuk pajtohen për nivelin e koherencës në qëndrime të tilla, dhe përmbajtjen e dimensioneve themelore ideologjike. (Converse P. E., 1964) argumentoi se qëndrimet politike janë të paqëndrueshme, të çorganizuara, të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht jo ideologjike (shiko gjithashtu (Zaller, 1992). Në shkencat politike mbizotëron pikëpamja që më e rëndësishme se sa dimensionin ideologjik është dallimi i së majtës dhe së djathtës (Fuchs, Dieter, and Hans-Dieter Klingemann, 1990). Autorët e tjerë ndërkaq e shohin autoritarizmin kundrejt liberalizmit si dimensionin kryesor ideologjik që karakterizon kulturën politike bashkëkohore (perëndimore) (Flanagan, Scott C., and Aie-Rie Lee., 2003).

Sociologë të ndryshëm, megjithatë, pohojnë se jo vetëm që qëndrimet politike në nivelin individual shfaqin një shkallë koherencë dhe strukturë të konsiderueshme (nëse maten në mënyrë adekuate), por që ato duhet të jenë të organizuara në përgjithësi përgjatë linjave të njohura ideologjike (p.sh., (Kerlinger, Fred , 1994; Middendorp, 1992; Shikano, Susumu, and Franz Urban Pappi, 2004)

2.1 Mënyra të ndryshme të konceptimit të ideologjisë

Nuk ka një përcaktim të dakorduar të teorisë së ideologjisë. Ka shumë kuptime, të cilat janë mbledhur në mënyrë të përpiktë nga studiuesit (Bell D. , 1962). Nuk është qëllimi im të rendit disa ose të ofroj një qasje të duhur ndaj ideologjisë. Por ne duhet të dimë që në fillim se çfarë lloj gjëje është një ideologji dhe cilat janë cilësitë e pretendimeve apo besimeve ideologjike. Dhe, ajo që shihet më rrallë, ne duhet të dimë qëllimet e kërkimeve teorike në ideologji. Sepse është e qartë se jo vetëm ideologjitë, por teoritë e ideologjisë shërbejnë për qëllime të veçanta politike, duke justifikuar një lloj regjimi dhe jo një tjetër, duke shprehur qëndrime të veçanta ndaj arsyeve dhe pa përsosmërisë ndaj klasave, lëvizjeve masive etj.

Marksit dhe Engelsi (Marx, K., Engels, F, 1976) e përdorën termin “Ideologji” për të treguar konceptet më abstrakte që popullojnë një botë imagjinare të ideve të pavarura të jetës materiale. Më vonë, Marksistët shpesh e përdorën atë për të treguar një “mburojë” ideor konspirative, të tërhequr mbi sytë e masave. Shkencëtarët politikë e përdorin atë për të treguar pako pozicionesh, që shpesh besohet se janë të pakuptueshme, dhe, natyrisht, shumë prej nesh e përdorin atë për të treguar bindjet, qëndrimet dhe mendimet e atyre me të cilët nuk jemi dakord. Për Marksit dallimi midis ideologjisë dhe shkencës, midis të

vërtetave dhe të pavërtetave është thelbësor. Së dyti, ideologjia lidhet me sistemin e klasave, ku ideologjia shërben për legjitimimin e sundimit ndaj klasës së shtypur. Së treti, ideologjia është një manifestim fuqie. Ideologjia përbën idetë sunduese të epokës. Sipas Marksit, klasa e proletariatit, nuk ka nevojë për ideologjinë, sepse është klasë që nuk ka nevojë për iluzione.

Pikëpamja e përbashkët për ideologjitë është se ato janë sisteme besimi që udhëheqin zgjedhjet dhe sjelljet tona, dhe me të vërtetë justifikojnë mendimet, veprimet dhe teoritë tona (Bailey, G. & Gayle, N, 2008; Goodwin, 2007; Lundy, 2011). Siç shpjegojnë Bailey dhe Gayle (2008), strukturat sociale dhe fuqia e sistemeve luajnë një rol kryesor në ruajtjen e zhvillimit të pikëpamjeve ideologjike. (Carey, M., & Foster, V, (2011/2013)) gjithashtu theksuan se ideologjia mund të përdoret për të manipuluar, shtrembëruar ose gjeneruar mendime, veprime ose ndjenja ilustruese. Kështu, siç u sqarua (Eagleton, 1991), ideologjia ka një gamë të tërë kuptimesh të dobishme, dhe jo të gjitha formulimet janë të pajtueshme me njëra-tjetrën.

Një shpjegim tjetër me ndikim i ideologjisë, bazuar në idetë e Marksit, u ofrua nga (Mannheim, *Ideology and utopia* , 1936). Ai argumentoi se në zemra e çdo ideologjie ekziston disa utopi ide që tregojnë se si duhet të jetë e organizuar shoqëria. Rëndësia e kësaj është se këto koncepte/ide flasin fuqishëm për vlerat dhe parimet sociale.

Ideologjitë mund të ekzistojnë në nivele të ndryshme në shoqëri. (Beyer, 1981) përshkroi strukturën e ideologjive në nivelin shoqëror, organizativ dhe individual. Disa vende dihet se janë më kapitaliste në vlerat, normat dhe praktikën e tyre, ndërsa shumë të tjera dihet se shfaqin më shumë tendenca socialiste.

Pra, duke pasur parasysh që ideologjia është shumë e rëndësishme në politikë, çfarë është ideologjia? A ka diçka në lidhje me mendimin ideologjik që është i dallueshëm nga format e tjera të të menduarit? David Joravsky ofron një pikënisje të dobishme:

“Kur e quajmë një besim ideologjik, ne po themi të paktën tre gjëra në lidhje me të: megjithëse është i pa verifikuar ose i paverifikueshëm, ai pranohet siç verifikohet nga një grup i veçantë, sepse kryen funksione shoqërore për atë grup” (Joravsky, 2007).

Të gjitha ideologjitë politike pretendojnë përkufizime “të vërteta” të lirisë, barazisë, drejtësisë, të drejtave dhe shoqërisë “më të mirë”. Gjithmonë ka pasur një pikëpamje të mbajtur gjerësisht në politikë dhe filozofi politike që “ideologjia” thjesht siguron një mashtrim për luftën për pushtet, mjetin e vërtetë të politikës. Për të justifikuar fuqinë e tyre dhe për të bindur njerëzit të binden, t'i ndjekin dhe mbështesin ata, pushtetarët përdorin ideologji të llojeve të ndryshme. Machiavelli (Machiavelli, N., & Wootton, D, 1995) këshilloi, në Princin (1513), se feja ishte një mjet shumë i dobishëm për sundimtarin. Për Machiavelli objektivi i vërtetë i politikës ishte marrja dhe mbajtja e pushtetit. Këto forma “racionale” të mendimit kontribuan në kritikimin e kohës së lashtë në Francë, Revolucionit Francez dhe zhvillimin e asaj që ne tani i quajmë ide ideologji politike që mbizotëruan debatin politik në Evropë dhe në botë gjatë dy shekujve vijues. Larg futjes së formave të reja të racionalitetit në politikë, format ideologjike të të menduarit kanë tendencë të krijojnë forma të reja të të menduarit “iracionale”, duke nxitur dhe lëshuar pasione të thella politike që në shumë mënyra i ngjante angazhimit emocional ndaj fesë. Në të vërtetë, ideologjitë politike për shumë u bënë sisteme besimi “pseudo-fetare” që kishin shumë nga shenjat e përkushtimit fetar. Nga mesi i shekullit XIX industrializimi po

shndërronte ekonomitë, shoqëritë dhe sistemet politike perëndimore. Kërkohej një mënyrë e re e të menduarit për shoqërinë. Shumë shkrimtarë në atë kohë kontribuan në zhvillimin e asaj që u quajt si shkencë e shoqërisë: “sociologji”. Më me ndikim ishin Karl Marx dhe Friedrich Engels, të cilët patën një ndikim të madh në studimin e ideologjisë. Në fakt, ata pretenduan se kishin krijuar një “shkencë” të ideologjisë. Në studimet e tyre për shoqërinë e hershme industriale, Marksii dhe Engelsi, veçanërisht në “The Ideology German” (1846), argumentuan se ekzistonte një lidhje e ngushtë midis kushteve materiale të shoqërisë, mënyrave në të cilat prodhohej pasuria (“nënstruktura”), dhe struktura e klasës dhe sistemet e besimit ('superstruktura') (Marx, K., Engels, F, 1976).

Interesat e klasave, sipas mendimit të tyre, formojnë ideologji. Merrni për shembull liberalizmin. Liberalizmi është një ideologji që pretendon, si të gjitha ideologjitë, të jetë një grup universal vlerash “të vërteta”, të përshtatshme për të gjithë njerëzit në të gjitha shoqëritë, dhe jo vetëm në një shoqëri liberale. Marksistët besojnë se nuk është kështu. Ata argumentojnë se liberalizmi është me përdorim të konsiderueshëm si një mjet ideologjik për të mbrojtur dhe forcuar interesat e borgjezisë dhe për t'i ndihmuar ata për të shfrytëzuar proletariatin. Liberalizmi mund të ketë kuptim eminent për borgjezinë, argumentojnë Marksistët, dhe madje mund të bindin anëtarët e proletariatit, por në thelb i shërben interesave të të parës dhe ndihmon në shfrytëzimin e këtij të fundit.

Shumica e teoricienëve të kësaj fushe, sikurse p.sh. (Bourdieu, (1984 [1979])), kanë një qëndrim të tillë realist sa i përket natyrës së disa prej ndërtimeve kryesore ideologjike që përdorin për të kuptuar veprimin shoqëror. Këtu do të argumentoj se sa do larg mund të duken konceptimet rreth ideologjisë të Marksit dhe Engelit në njërën anë dhe ato të shkencëtarëve politikë nga ana tjetër, ato duhet të bashkohen. Kjo do të thotë, ideologjia

politike është "ideologji" në kuptimin e Marksit dhe Engelsit, jo sepse është shpërqendruese, por sepse është ekuivalenti ideal i modeleve aktuale të marrëdhënieve politike.

2.2 Profilet kryesore ideologjike

Partitë politike filluan të manifestohen gjatë dhe pas rënies të Republikës Federale Sociale të Jugosllavisë. E para parti politike serioze ishte LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) e themeluar në vitin 1989 dhe e udhëhequr nga Ibrahim Rugova. Disa studiues e konsiderojnë themelimin e LDK-së më shumë si lëvizje e pavarësisë, sesa formimi i një partie politike (Hofmeister, 2013).

Themelimi i partive të tjera pasoi në vitet 1990- 1991; ato parti u përpoqën të krijojnë një sistem paralel politik, duke u shkëputur nga institucionet serbe. Partitë e reja politike si Partia Demokristiane e Kosovës, Partia Liberale e Kosovës, Partia Social Demokrate e Kosovës, të gjithë nuk arritën të mbledhin mbështetje dhe organizojnë në mënyrë efektive si LDK-ja.

LDK ishte veçanërisht me ndikim jashtë Kosovës, kryesisht në atë perëndimore dhe vendet evropiane, ku jetonte diaspora shqiptare.

LDK arriti të organizojë fondin e famshëm “3%”, i cili u bë nga dhurime vullnetare nga diaspora shqiptare për zhvillimin e një aksioni politik shqiptar dhe institucioneve paralele (Hofmeister, 2013). Lëvizjet tjera politike që ia vlen të përmenden janë LPK-ja, Lëvizja Popullore e Kosovës dhe LKÇK, Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Siç deklaruan Hofmeister dhe Grabow, këto dy lëvizje politike çuan në formimin e njësisë ushtarake

politike me kërkesa politike në lidhje me pavarësinë e Kosovës, si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (Hofmeister, 2013). Në këtë pikë, ndryshimi kryesor ideologjik midis LDK dhe UÇK ishte si t'i përgjigjet veprimeve të Serbisë në Kosovë. Kjo ndarje solli një dallim të qartë ideologjik midis dy krahëve në Kosovë. LDK u përpoq të zgjidh çështjen e Kosovës përmes jo-dhunës, ishte udhëheqësi i saj Ibrahim Rugova i quajtur si “Gandi i Ballkanit” për metodat e tij jo të dhunshme; në pala tjetër, UÇK-ja e pa luftën si një domosdoshmëri për të krijuar një të Kosovë të pavarur. Këto dy lëvizje të pavarësisë në Kosovë u quajtën zakonisht si “krahu i luftës” “dhe krahu i paqes”. Pas luftës, LDK u bë parti e “krahut të paqes”, ndërsa PDK dhe AAK ishin parti që përfaqësonin “krahun e luftës”.

Pas Luftës së Kosovës, Serbia de-fakto kishte humbur kontrollin mbi Kosovën dhe u bë UNMIK (Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë), institucioni kryesor në Kosovë. UNMIK-u kishte një mandat për të siguruar kushtet e paqes dhe një jetë normale për të gjithë banorët e Kosovës. Nën UNMIK-un kishte kushte më të favorshme për krijimin e partitë politike, kështu që ish-komandantët e UÇK-së krijuan dy parti të mëdha politike; Hashim Thaçi u bë udhëheqësi i PDK-së (Partia Demokratike e Kosovës) dhe Ramush Haradinaj u bë udhëheqësi i AAK-së (Aleanca për Ardhmërinë) të Kosovës). Në zgjedhjet e para në Kosovë, të organizuara nga OSBE, LDK fitoi me 46.29% të votave (Hofmeister, 2013), duke mposhtur rëndë partitë e krahut të luftës.

Sidoqoftë, UNMIK ishte duke qeverisur dhe administruar me Kosovën duke ruajtur paqen dhe ndërtuar institucione vetëqeverisëse. Kjo çoi në një situatë ku të gjithë partitë në Kosovë e përvetësuan qëllimin e pavarësisë si qëllim kryesor ideologjik, duke drejtuar gjithashtu propozimet dhe platformat e politike drejt kauzës përfundimtare të pavarësisë.

Ky synim i fundit i pavarësisë pengoi formacionet ideologjike të partive. Programet e tyre politike në vend që të përqendrohen në krijimin e një rendi shoqëror i bazuar në vlera, parime dhe një vizion, thjesht ishte prezent pavarësia si premtimi i tyre kryesor elektoral. Partia e parë politike që doli me një ideologji të qartë politike ishte lëvizja reformiste ORA, e themeluar në vitin 2004. Si Hofmeister dhe Grabov shpjegojnë se, ORA ishte një parti e qartë e majtë, me politika të majta ekonomike dhe propozime të qarta të ndërhyrjes shtetërore për çështjet në lidhje me ndërmarrjet publike, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në Kosovë, duke pasur parasysh monopolin e tyre që kanë në treg. Megjithatë, ORA nuk ka arritur të rifreskojë sferën politike në Kosovë, dhe partitë politike në Kosovë mbetën njësi të thjeshta që premtinin pavarësi për Kosovën. Për më tepër, mungesa e ideologjive politike u vonua për shkak se udhëheqësit politikë ishin përballur me negociatat Prishtinë-Beograd, të imponuar nga Kombet e Bashkuara dhe ndërmjetësuar nga i dërguari special i Kombeve të Bashkuara z. Marti Ahtisaari.

Pavarësia e Kosovës si qëllim u bë “e djathta dhe e majta” tek secila parti politike në Kosovë. Ajo u shndërrua në një plan, duke kompensuar mungesën e ideologjive dhe mungesën e gatishmërisë për tu përafëruar me ideologjitë politike. Prania e zgjatur e UNMIK-ut, trajtimi sipërfaqësor i partive politike të Kosovës dhe Qeveria e Përkohshme para Pavarësisë kishte gjithashtu ndikim në mungesën e formimit të partive politike me ideologji të qartë. Ideologjia kryesore e partive politike mbeti pavarësia, dhe në raste si Vetëvendosje, ishte më nacionaliste dhe premtoi bashkim me Shqipërinë.

Për ta përmbledhur, partitë politike në Kosovë u formuan si reagim kundër Serbisë dhe ideologjia e tyre kryesore ishte të shpallnin një Kosovë të pavarur. Institucionet e

përkohshme nën rezolutën 1244 të KB sollën një situatë ku e djathta dhe e majta e politikës së Kosovës kishin pavarësinë si qëllimin e tyre kryesor, duke qenë më pak i shqetësuar për platformat koherente politike, kryesisht për shkak të mungesës të kulturës politike demokratike në Kosovë, dhe statusit të ulët socio-ekonomik të qytetarëve kosovarë.

Partitë politike, në vend që të propozojnë ideologji ose programe politike, zgjedhën premtime pompoze për qindra mijëra vende të reja të punës, zhvillim ekonomik, liberalizim të vizave dhe hyrje në BE dhe NATO.

Zhvillimi i partive politike të Kosovës për krijimin e konsistencës ideologjike lidhet ngushtë me rrugën e politikës së Kosovës drejt shtetëndertimit. Me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, krijohen edhe parakushtet për konsolidim dhe profilizimin e Partive Politike në Kosovë.

Në këtë studim përshkruhen partitë politike në Kosovë dhe identifikimin e tyre me një profil të caktuar ideologjik. Në disa raste partie politike identifikojnë vetën qartë me një profil ideologjik të caktuar që, që zakonisht gjenden në deklaratat e udhëheqjes partiak, në programin e partisë, ose nënkuptohet përmes përpjekjeve të tyre për anëtarësim në grupimet partiake pan-evropiane.

3.2 Partitë politike në Kosovë gjatë administrimit ndërkombëtar

Fillimisht pas luftës në Kosovë në 1999, Partitë Politike u ndanë në parti të dala nga lufta (PDK dhe AAK) dhe partitë që kishin ndjekur një rrugë paqësore (LDK) me të njëjtin qëllim për çlirimin e Kosovës, por duke përdorur mënyrë të ndryshme (Hofmeister, W and Grabow, K, 2011) .

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ishte në favor të marrëdhënieve të mira me LDK dhe udhëheqësin Rugova, duke iniciuar përpjekje për kthimin e Rugovës nga mërgimi (Romë-Itali), në mënyrë që të shmanget ndikimi i partisë pasardhëse të UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) (Tansey, 2009).

Kjo ndodhi sepse ata së pari donin të vendosnin ekuilibrat shoqërorë, më pas do të ishte më e lehtë të qeveriste vendin me partitë që konsiderohen si moderne. “Në të njëjtat mënyra si me Timorin Lindor, në Kosovë, një nga mënyrat e ndikimit të administratës ndërkombëtare në tranzicion politik ndodhi përmes ndërmjetësimit të elitave hyrjen në pushtet. Para dhe pas zgjedhjeve, UNMIK kishte ndërhyrë në garat midis partive politike dhe elitës, me qëllim të formësimit të rezultateve zgjedhore, duke shmangur ndikimin e ndonjë partie apo etnie të vetme dhe promovimin e politikës moderne në Kosovë. UNMIK kishte formuar politikën kosovare përmes përzgjedhjes së bashkëbiseduesve vendor dhe përfshirjes ndërkombëtare në formimin e koalicioneve pas zgjedhjes” (Tansey, 2009).

Gjatë zgjedhjeve të para parlamentare nën Administratën e UNMIK-ut në vitet 2001-2004, koalicioni qeverisës ishte i përbërë nga partitë kryesore politike në Kosovë (LDK, PDK dhe AAK) dhe pakicat që ishin pjesë integrale e të gjitha qeverive, të garantuara me

Kushtetutën e Kosovës. Kjo përbërje kishte përfshirje gjithëpërfshirëse sociale, por pa ndarje ideologjike ose programore.

Ndërkohë nuk ka pasur parti politike opozitare me mbështetje të gjerë. Kjo nuk ishte e zakonshme për një vend demokratik. Kjo na tregon se mbi të gjitha, administrata ndërkombëtare ishte e interesuar për stabilitet dhe gjithë përfshirje, posaçërisht për një vend (territor) pa ndonjë traditë të fortë demokratike siç ishte Kosova pas luftës.

Qeveria e viti 2004-2007 shënon për herë të parë pozicionin e partive politike sipas pjesëmarrjes në qeverisje, një koalicion LDK / AAK dhe një kundërshtim të fortë me PDK-në. Gjatë administratës ndërkombëtare në Kosovë, roli i UNMIK-ut ishte shumë i rëndësishëm dhe i fuqishëm në vendosjen, bërjen dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave në të gjitha fushat. Për më tepër, ai ishte gjithashtu i përfshirë në sistemin partiak dhe politik, përfshirë organizimin e zgjedhjeve, sistemin zgjedhor, kohën e zgjedhjeve, certifikimi dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. UNMIK emëroi pakicat serbe në disa raste për shkak të kundërshtimit të tyre për të marrë pjesë në zgjedhje për arsye politike.

Vitet elektorale	2001	2004	2007	2010	2014	2017
Koalicionet drejtuese	LDK,	LDK,	LDK		LDK	
	PDK,		PDK	PDK	PDK	PDK
Partitë kryesore politike shqiptare	AAK	AAK		AKR		AAK

Tabela 2. Burimi: Përmbledhja e autorit

3.3 Partitë politike pas Pavarësisë së Kosovës

Më 17 shkurt 2008, data e shpalljes së pavarësisë së Kosovës kishte pushtetin PDK dhe LDK, të cilat ishin partitë kryesore në kuptimin e mbështetjes së qytetarëve dhe përfaqësimit të historisë. Periudha pas pavarësisë u karakterizua me vendosjen institucione të reja shtetërore, të cilat në fazat e mëparshme nuk ekzistonin ose ishin nën administrimin ndërkombëtar. “Faza e pas pavarësisë u karakterizua nga themelimi i institucioneve të tjera shtetërore që më parë nuk kishin ekzistuar ose ishin administruar nga misionet ndërkombëtarët. Ky hap i konsolidimit demokratik dhe institucional në të njëjtën kohë paraqitet si një sfidë kryesore për shoqërinë kosovare” (Krasniqi, A & Shala, K, 2012). “Me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror mund të pritet që partitë politike mund të fillojnë artikullimin e programit, orientimet dhe kështu skena politike në Kosovë do të konsolidohet” (Krasniqi, A & Shala, K, 2012).

Gjatë qeverisë së PDK dhe LDK 2007-2010, partitë në pushtet ishin më të orientuara drejt shtet ndërtimit dhe qëndrimit në pushtet sesa shqetësimi me ndonjë program të qartë bazuar në përcaktimin ideologjik. Këtë e dëshmoi edhe Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, sipas të cilit “koalicioni PDK-LDK ishte për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës dhe ndërtimin e shtetit, dhe nuk kishte të bënte me ndonjë lidhje konceptuale ose ideologjike” (Thaçi, 2014). Kjo u konfirmua edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në 2010 për shkelje të Kushtetutës pas çështjes së dy pozicione të mbajtura nga Presidenti i Kosovës dhe Presidenti i LDK-së (Vendim, 2010). Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, LDK u largua nga koalicioni qeverisës me çka vendi hyri në krizë institucionale dhe që pasoi nga

mbajtja e zgjedhjeve të reja parlamentare në shkurt 2011 (Ejupi, B dhe Qavdarbasha, Sh, 2011).

Nga Marsi 2011 deri në qershor 2014, Kosova drejtohej nga PDK dhe AKR. Ky koalicion qeverisës u bazua më shumë në numër në mënyrë që të krijojë një shumicë në Kuvend sesa në lidhje ideologjike dhe programore. Në të njëjtën kohë ishte një kundërshtim i fortë në numër, por kishte mungesë uniteti dhe programi ideologjik.

Në lidhje me koalicionet e ardhshme të mundshme, pas zgjedhjeve të qershorit 2014, Kryeministri Thaçi deklaroi se: “Ne nuk do të përjashtojmë asnjë parti politike për të krijuar një qeveri të re. Së pari, ne mezi presim të krijojmë një koalicion me partitë që kanë ide më të ngushta me tonat, por megjithatë kjo do të vendoset pas rezultateve të zgjedhjeve” (Thaçi, 2014). Kjo ndodhi me të vërtetë pas zgjedhjeve të qershorit 2014. Mungesa e profileve ideologjike të partive politike, para zgjedhjeve si dhe krijimi i koalicioneve dhe më pas qeveria, ka një ndikim negativ në rezultatet e qeverisjes. Do të thotë që ndikimi është në sistemin politik dhe cilësinë e qeverisjes, me theks të veçantë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik.

Ndërsa në vendet me profilizim të qartë ideologjik të së djathtës dhe të majtës apo qendrës (me ndonjë sistem zgjedhor proporcional), dihet paraprakisht se cila parti hyn në koalicion me cilën parti. Në rastin e Kosovës, të gjitha partitë kalojnë në fushatë zgjedhore me programe dhe oferta të caktuara zgjedhore dhe programe, por pa qenë në gjendje të thonë dhe përcaktojnë partnerin e koalicionit pas rezultateve të zgjedhjeve. Historia e shkurtër e Kosovës (pas administratës ndërkombëtare) dëshmoi se së pari gjatë 2001-2007 nën administrimin ndërkombëtar si dhe nga pavarësia e Kosovës në 2008 deri në 2017,

koalicioni qeverisës ishte i bazuar më shumë në numër të anëtarëve të parlamentit sesa në parime, programe apo profilizim ideologjik. Kjo ka ndikuar në cilësinë e qeverisjes, fillimisht për shkak të qeverisjes me UNMIK gjatë 1999-2008, e cila kishte një paqartësi dhe mungesë të rezultateve dhe pastaj për shkak të mungesës së spektrit ideologjik dhe profilizimit të partive politike. Si rezultat i mangësive të mësipërme pas zgjedhjeve të qershorit 2014 (KQZ, 2014), vendi hyri në krizë sepse asnjë nga partitë politike nuk kishte një shumicë parlamentare për të krijuar shumicë në Parlamentin.

Në një skemë partiake, me PDK-në nga njëra anë si fituese të zgjedhjeve, dhe LDK, VV, AAK dhe NISMA nga ana tjetër, e njohur si blloku LVAN, krijuan pengesa në krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve, sepse asnjë prej tyre (LDK, VV, AAK dhe NISMA) nuk donin të ishin në koalicion me PDK-në si fituesin e zgjedhjeve në vitin 2014. Gjatë kësaj kohe pakicat e përfaqësuara në parlament ishin neutrale. Kjo ndarje e Partive Politike nuk ishte e bazuar në ndonjë program, ideologji apo plan koherent. Pas gjashtë muaj bllokadë, mendimi i Gjykatës Kushtetuese për të drejtën e partisë më të madhe për të zgjedhur Kryetarin e Parlamentit dhe propozimin e kabinetit qeveritar dhe pas presionit të ambasadave në Kosovë, konkretisht Ambasadës së SHBA për të krijuar një qeveri të re, PDK dhe LDK nënshkruan marrëveshjen për koalicionin qeverisës.

Qeveria e mëparshme me PDK-në dhe AKR-në ishte e njëjtë, si të tjerat në Kosovë, pa ndonjë udhërrëfyes ideologjik apo programor. Arsyeja e vetme e bllokut LVAN për të qenë së bashku ishte që të linte PDK-në jashtë koalicionit qeverisës, por nuk kishte ndonjë vizion programatik ose ideologjik. Koalicioni aktual midis PDK-së dhe LDK-së u krijua në dhjetor 2014 pas bllokadës 6-mujore. Koalicioni ishte i qëndrueshëm për sa i

përket numrave në parlament pavarësisht se disa deputetë të LDK-së nuk votuan pro, sepse ata ishin kundër qeverisë me PDK-në. Gjithashtu, partitë opozitare të përbëra nga VV, AAK dhe NISMA (nga njerëzit që më parë ishin si udhëheqës të vjetër në PDK) ishin duke vepruar fuqishëm kundër qeverisë që nga fillimi i koalicionit, veçanërisht ata po kundërshtojnë me forcë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi dhe Asociacionin e Komunave Serbe, të dakorduar nga bisedimet Kosovë-Serbi e lehtësuar nga BE. Kështu, si rezultat i mospranimit dhe refuzimit të marrëveshjes, partitë opozitare kanë bllokuar mbajtjen e seancave të Kuvendit duke hedhur gaz lotsjellës dhe duke organizuar protesta në rrugë.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që marrëveshja nuk është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, kundërshtimi nga partitë opozitare po bëhet shumë më i fortë.

Ende sistemi partiak në Kosovë është dialektik dhe jo i qëndrueshëm. Sikurse qeverisja e koalicionit (PDK-LDK), partitë opozitare (VV, AAK dhe NISMA) nuk janë konsistente në kuptimin e të kaluarës, ideologjisë dhe programeve të tanishme. Pothuajse roli kryesor në krijimin e koalicioneve qeverisëse në Kosovë, që nga viti 2001 deri në vitin 2014 u luajt nga Ndërkombëtarët (UNMIK) dhe ambasadat (konkretisht SH.B.A., Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania).

KAPITULLI 4: ANALIZË: SJELLJA E PARTIVE POLITIKE NË RAPORT ME IDEOLOGJINË

4.1 Sistemi partiak në Kosovë

Sistemi politik dhe partiak në Kosovë ka specifikimet e veta, megjithatë përdorimi i një modeli të vetëm ose kornizë teorike të organizimit të partisë është e mundshme kur analizoni partitë kryesore politike. Ky kapitull do të paraqesë një analizë të peizazhit politik në Kosovë, si shteti më i ri në Rajon më i riu nga të gjitha shtetet pas Jugosllavisë. Ne do të diskutojmë kornizën politike të Kosovës duke analizuar tre parti kryesore politike: PDK, LDK dhe VV. Së pari, ne do të paraqesim shkurtimisht rregulloret kryesore ligjore kombëtare mbi krijimin dhe funksionimin e palëve kosovare. Së dyti, ne do të vazhdojmë duke theksuar karakteristikat kryesore të ndara nga të gjitha partitë kryesore në Kosovë sot, siç është demokracia relativisht e ulët e partive të brendshme dhe çështjet e financimit transparent të partive. Së treti, ne do të prezantojmë një përmbledhje të shkurtër të strukturës, rregullave dhe funksionimit të tre partive politike. Për të filluar, duhet të kuptohet që partitë politike kosovare janë në fakt shumë të reja, dhe se atyre u mungon shpesh orientimi ideologjik, programe të qarta dhe janë të paqarta në lidhje me shifrat e anëtarësimit të tyre. Sidoqoftë, ato plotësojnë kriteret themelore për klasifikimin si parti politike dhe janë në proces të transformimit si pjesë e kalimit të Kosovës në demokraci. Fatkeqësisht, partitë kosovare janë ende shumë të ndara etnike, gjë që pasqyron ndarjet që ekzistojnë akoma në vend (Nenadović, 2012).

Shteti më i ri evropian, Kosova ka pjesën e vet të problemeve tranzicionale, kryesisht në drejtim të korrupsionit, krimit të organizuar, sundimit të ligjit të dobët dhe ekonomisë së

pazhvilluar (European Commission. Kosovo Progress Report 2014, 2014). Kjo, partitë politike lokale shpesh janë parë si shumë të përshtatshme mjete për arritjen e pozitave të pushtetit, të cilat nga ana tjetër u sigurojnë mbajtësve të tyre përparësi sociale që u mungon shumicës së qytetarëve kosovarë. Tre partitë politike që janë në fokus të këtij kapitulli do të merren në konsideratë në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve, mbështetjen popullore dhe veprimtarinë politike vitet e fundit.. Ndërsa gjatë viteve 90, vendet e mëparshme komuniste filluan të veprojnë nën sistemin e partive demokratike dhe pluraliste, Kosova u vendos nën okupimin serb. Gjatë kësaj kohe në Kosovë, u lejua të vepronin disa parti politike si LDK, e cila ishte më shumë si Lëvizja e shqiptarëve të Kosovës kundër okupimit serb sesa që ishte parti politike në një mënyrë klasike.

“Kemi të bëjmë me një rast specifik, qoftë në aspektin e qeverisjes, qoftë në profilizim, sepse pas rënies së komunizmit, Kosova si pjesë e ish-Jugosllavisë Federale, jo se ajo ishte në gjendje të fitonte lirinë e saj, për më tepër atë ishte kufizuar që ishte vënë nën regjimin serb” (Peci, L. Malazogu, L., Dugolli, I., 2016).

Kosova, gjatë viteve 1989-1999, vazhdoi rezistencën e saj kundër regjimit serb, duke mos e pranuar atë sistem përmes zhvillimit të jetës paralele institucionale në të gjitha fushat. “Gjatë periudhës 1990-1999, në Kosovë kishte aktive më shumë se një parti politike si- Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Social Demokrate e Kosovës, Partia Demokristiane, Partia Liberale. Sidoqoftë, këto partitë nuk kanë vepruar në rrethana normale ku do të lejohej zhvillimi i jetës normale politike dhe demokracisë” (Krasniqi, A, Shala, K, 2012).

Në këtë periudhë kohe nuk mund të flisnim për profilizim ideologjik ose për vendosmëri ose për ndonjë zhvillim dhe orientim. Orientimi i vetëm dhe kryesor ishte liria dhe pavarësia e Kosovës nga Serbia. Pas ndërhyrjes së NATO-s kundër regjimit serb në Kosovë dhe Serbi, Kosova u vendos nën ndërkombëtare administratës, ku baza ligjore ishte rezoluta 1244/99 e Këshillit të Sigurimit të KB (Caplan, 2005).

Në aspektin statutor, mënyra e organizimit në PDK, LDK dhe AAK bazohet në Degë dhe Nëndegë në nivelin bazë, ndërsa organe tjetra partiake të këtyre partive janë: Kuvendi (LDK, AAK) ose Konventa (PDK), Këshilli Drejtues (PDK, AAK) ose Këshilli i Përgjithshëm (LDK), dhe Kryesia e Partisë në të gjitha partitë e lartpërmendura (Leon Malazogu and Brenna Gautam). Përndryshe, mënyra e organizimit të LVV është e ndarë në tre nivele; niveli i parë organizativ i formuar nga Këshilli kryesor, niveli i dytë organizativ i formuar nga Këshilli Qendror, Kryesia Qendrore dhe Sekretariati Qendror dhe niveli i tretë organizativ i formuar nga Këshilli i Përgjithshëm, Kryesia dhe Sekretariati i Përgjithshëm.

Degët, nëndegët (LDK) por edhe seksionet (PDK), dhe aktivet (AAK) janë njësi të organizimit dhe veprimtarisë së territorit, ku në të gjitha partitë politike, Degët ose Qendrat (LVV) tregojnë nivelin më të lartë të organizimit në nivelin komunal (Statuti i PDK-së, neni 21-23); (Statuti i LDK-së, neni 16.2); (Statuti i AAK-së, neni 4); (Neni 5 i Statutit të LVV). Kuvendi i LDK-së (Statuti, neni 17) dhe AAK (Statuti, neni 13), Konventa e Përgjithshme në Partinë Demokratike të Kosovës, (Statuti, neni 30), paraqet organin më të lartë të partisë. Në LVV, niveli i tretë organizativ, Këshilli i Përgjithshëm konsiderohet të jetë autoriteti më i lartë i vendimmarrjes, pasi kjo parti nuk ka një Asamble ose një Konventë të Përgjithshme. Të mos kesh këtë lloj organi, mund të justifikohet me faktin se

për çështje të ndryshme si zgjedhja e Drejtuesit të LVV-së, zgjedhja e Drejtuesit Qendror ose programi politik etj., votohet nga aktivistët e LVV-së përmes demokracisë direkte, bazuar në parimi një votë për një aktivist. (Statuti, neni 28). Kjo do të thotë se duke e krahasuar me partitë e tjera ku vetëm Delegati i Asamblesë / Konventës mund të votojë për çështjet që lidhen me partinë e tyre politike, në LVV kjo është e mundur për çdo aktivist brenda partisë. Pra, gjatë zgjedhjeve të brendshme partiake, çdo aktivist që ka një broshurë të LVV-së, mund të shkojë në cilindo nga qendrat e zgjedhjeve dhe të votojë për çështje të caktuara. Këshilli Drejtues (PDK, AAK) ose Këshilli i Përgjithshëm (LDK, VV) është organi më i lartë në marrjen e vendimeve ndërmjet dy Asambleve / Konventave (PDK, LDK, AAK) (Statuti i PDK-së, neni 38); (Statuti i LDK-së, neni 22); (Statuti i AAK-së, neni 18); (Statuti i LVV-së, neni 61). Kryesia Qendrore është organi më i lartë politik-ekzekutiv në të gjitha partitë politike (Statuti i PDK-së, neni 43); (Statuti i LDK-së, neni 28); (Statuti i AAK-së, neni 21); (Statuti i LVV-së, neni 68). Në përgjithësi, të gjitha partitë politike, përveç LVV (Lëvizja Vetëvendosje), mund të klasifikohen me një skemë të ngjashme të organizimit.

Në fund, mund të konkludojmë që partitë politike në Kosovë, veçojnë organet dhe kompetencat bazuar në Statut. Sidoqoftë, siç mund ta shohim gjatë analizës së plotë, në praktikë, mënyra se si funksionon raporti i partive me Ideologjinë ka një paqartësi të theksuar, e cila do të pasqyrohet në këtë studim.

4.2 Ideologjitë e Partive Politike në Kosovë

Ideologjitë nuk shërbejnë si arsyeja kryesore pse partitë ekzistojnë ose fitojnë zgjedhje, por ato mbeten një bazë e rëndësishme e këndvështrimit të politikave të partisë. Një ideologji është një tërësi parimesh koherente, unifikuese, idetë dhe vlerat që sigurojnë një kornizë për të kuptuar shoqërinë, duke krijuar një vizion për përmirësimin e saj dhe duke identifikuar opsionet e politikave të kërkuara për të arritur atë vizion. Shumë nga konceptet paraqiten si koncepte universale, interpretohen ndryshe nga secila familje ideologjike. Ndërsa partitë politike punojnë për të zhvilluar politikat e tyre, ideologjitë e përcaktuara qartë ndihmojnë të shërbejnë si një lloj busull politike. Të gjitha idetë politike formohen nga rrethanat shoqërore dhe historike në të cilat ato zhvillohen dhe nga ambiciet politike që shërbejnë (Ball, T and Dagger, R, 2006). Pavarësisht, partitë politike në Kosovë zyrtarisht deklarohen si më poshtë:

Dy partitë më të mëdha në Kosovë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) (PDK, 2012) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) (LDK, 2014) në statutin e tyre janë deklaruar si parti të qendrës së djathtë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) (AAK, 2014) është deklaruar po ashtu si e qendrës së djathtë. (Statuti i PDK, LDK, AAK); - Aleanca e Re e Kosovës (AKR) (Re, 2014) është shpallur si një orientim liberal-demokrat. (Statuti i AKR). Lëvizja Vetë-Vendosje (LVV) ka është shpallur parti e qendrës së majtë (Statuti i VV) (LVV, 2014).

Që nga vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar deri në ditët e sotme, partitë politike janë duke vepruar më shumë në mënyrë pragmatike, duke ofruar zgjidhje për

problemet në një mënyrë më gjithëpërfshirëse sesa synojnë grupe të caktuara të shoqërisë bazuar në profilin ideologjik.

Mënyra e votimit dhe fushata zgjedhore varet nga zhvillimet specifike politike në Kosovë, në drejtim të ushtrimit të sovranitetit nga vendasit dhe administrata ndërkombëtare. Deri në vitin 2008, për të gjitha partitë politike tema kryesore gjatë fushatës elektorale ishte pavarësia, ndërsa për temat e tjera si ekonomi dhe papunësia ishte disa oferta të përgjithshme, por asgjë e prekshme. Për këta të fundit u fajësua UNMIK-u.

Pas vitit 2008, Partitë ishin më specifike me ofertat ekonomike, por gjithsesi ishte e përgjithshme. Ndërsa deri në vitin 2017, mund të thuhet se ka pasur përparim në ofertat e partive politike, por pa ndonjë ndarje të qartë ideologjike. Të gjitha ofertat ishin për të adresuar çështjet që sjellin më shumë vota. Oferta zgjedhore ishte më specifike në krahasim me zgjedhjet e kaluara, ofrimi i zgjidhjeve për disa çështje si: punësimi, zhvillimi ekonomik, taksat, privatizimi, energjia, bujqësia, politika sociale, integrimi në BE, etj.

E gjithë oferta elektorale ishte gjithëpërfshirëse në kuptimin e votuesve që kishin si synim ndarjen ideologjike. Integrimi Evropian, partneriteti strategjik me SH.B.A, ekonomia e tregut të lirë, shoqëria e hapur, lufta kundër fenomeneve negative dhe politikës sociale janë disa nga pikat që Partitë në Kosovë janë më afër. Përfshirë VV, e cila ka qasje të ndryshme për disa tema ekonomike, privatizimi, (kundër privatizimit të disa ndërmarrjeve të rëndësishme për vendin, të tilla si Trepça, Zyra Postare, Aeroporti dhe KEK), politika e jashtme ose prania ndërkombëtare në Kosovë. Të gjitha Partitë Politike, me disa ndryshime të vogla në qasje, deklarojnë angazhimin e tyre për të ndihmuar njerëzit që jetojnë në kushte të këqija ekonomike. “PDK me programin e saj të qeverisjes është e angazhuar që:

të vazhdojë dhe të rrisë mbështetjen për familjet e dëshmorëve; veteranët; invalidët e luftës; Indeksimin e pensionit bazë ndaj inflacionit; Sigurimi i mbështetjes adekuate shëndetësore për kategoritë sociale, në institucionet e shëndetit publik; Indeksi i skemave sociale me inflacionin, etj” (PDK, 2019).

LDK, me programin e saj parasheh: “Ndhmën sociale të ofruar nga shteti për familjet e varfëra. Për sa kohë që është e mundur, ndihma sociale do të kushtëzohet me punën aktive në punë të ndryshme, si dhe pjesëmarrjen në shumë trajnime. Kjo është mënyra më e mirë për të lehtësuar varfërinë dhe për të zvogëluar varësinë nga ndihma sociale” (LDK, 2014).

Lëvizja Vetëvendosje është e përkushtuar të mbështesë shtresat e varfra me sistemet publike të ndihmës sociale, të financuara nga një sistem progresiv i taksave. Sa i përket, Politikës Sociale dhe pensioneve: LVV është për përkujdesjen e shtetit për secilin qytetar (LVV, 2014).

AAK gjithashtu promovon përfshirje sociale dhe mbështetje për shtresat në nevojë (AAK, 2014). Bazuar në këtë, Partitë Politike në Kosovë veprojnë bazuar në kontekstin e nivelit të zhvillimit dhe nevojave të qytetarëve në Kosovë. Zyrtarisht, kjo tregon gjithashtu se rrethanat ekonomike në Kosovë, mbi ndarjen e majtë, kërkojnë adresimin e nevojave themelore të qytetarëve. Gjithashtu mund të konkludohet se të gjitha partitë politike, me ndryshime të vogla, mbështetje ofrimin e mundësive të ofruara për rritjen e numrit të vendeve të reja të punës. Në të njëjtën kohë partitë politike janë për mbështetje sociale të shtetit për shtresat në nevojë.

4.2.1 Raporti midis Ideologjisë dhe Lidhjes Demokratike të Kosovë

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u krijua si parti politike nga një grup i intelektualëve në vitin 1989. Themeluesi kryesor i partisë politike LDK ishte Ibrahim Rugova, i cili mbante pozitën e kreut të partisë deri në vitin 2006.

Tri parimet kryesore të LDK-së që nga themelimi i saj, në dhjetor të vitit 1989 janë: *“Liri, pavarësi, demokraci”*.

LDK-ja për sa i përket spektrit politik mund të thuhet se i përket ideologjisë së qendrës së djathtë, dhe paraqet një kombinim të liberalizmit ekonomik dhe konservatizmit social. “LDK është e anëtarësuar në Partinë Popullore Evropiane (EPP), e cila e identifikon veten si familja politike e qendrës së djathtë” (EPP, 2018). Një nga gjërat që LDK dhe PPE kanë të përbashkët është ideologjia e tyre. Të dy janë liberal-konservatorë, duke bërë kështu një rrugë për bashkëpunim: “Shumica e sfidave aktuale politike, ekonomike, të sigurisë / mbrojtjes dhe mjedisore të BE-së nuk mund të trajtohen pa partnerët tanë jashtë Evropës. Prandaj, PPE angazhohet intensivisht me parti dhe partnerë të ngjashëm në të gjithë botën,” shkruan PPE në ballinën e saj (EPP, 2018).

LDK konsiderohet si parti pak më shumë liberale sesa partitë e qendrës së djathtë kur kemi të bëjmë me çështjet ekonomike.

LDK-ja shihet si parti tradicionale që kontrollohet ende prej gjeneratës së vjetërve, të cilët janë në politikë tash e një kohë të gjatë (Leon Malazogu and Brenna Gautam). Kjo parti shihet edhe si tejet e ngurtë kur bëhet fjalë për reformimin e saj të brendshëm dhe për tërheqjen e të rinjve.

“LDK-ja e përkrah fuqishëm privatizimin e ndërmarrjeve publike, por, sikur partitë e tjera, nuk e ka kundërshtuar ofrimin pa pagesë të kujdesit shëndetësor.

Sipas Nenit të dytë të statutit të LDK-së, është Parti e Qendrës së Djathtë (LDK, Karta e LDK-së, 2016). Lidhja Demokratike e Kosovës është e bazuar në vlera demokratike si: respektimi i traditës, liria, drejtësia dhe toleranca, përgjegjësia dhe transparencia, liria e shprehjes, të drejtat individuale dhe kolektive.

Objektivi i LDK-së është krijimi i një Kosove Evropiane, ku demokracia, sundimi i ligjit, mirëqenia e qytetarëve dhe zhvillimi ekonomik të cilat duhet promovuar. Ajo kërkon të stimulojë tregtinë e lirë, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe idetë, mbështetur nga arsimi modern dhe një shoqëri ku vlerat dhe tradita e Qytetarëve të Kosovës respektohen. LDK, si shumica e partive të tjera kosovare, ishte ngatërruese me qëllim që ideologjia e tyre të ishte e moderuar për sa i përket rendit shoqëror dhe ekonomisë.

Definimi i saktë ideologjik i partive në Kosovë është tejet i vështirë ngase ato qëllimshëm ende nuk i kanë të qarta ideologjitë. Të gjitha partitë politike në Kosovë angazhohen për liberalizëm në çdo aspekt. Por, kontradikta apo kundërshtimi fillon pikërisht në vetvete. Si çdo parti edhe LDK ka qëllim maksimizimin e votave, në Programin e nëntorit të vitit 2019, i ka vendosur disa fjali që tregojnë orientimin e djathtë të LDK-së.

“Të jesh liberal ndaj ekonomisë do të thotë se je konservator në ideologji dhe si pasojë parti e djathtë, por të jesh liberal ndaj shoqërisë do të thotë të jesh liberal ose social demokrat në ideologji dhe si pasojë parti e majtë, kurse nëse ke pozicion të moderuar qoftë ndaj shoqërisë qoftë ndaj ekonomisë do të thotë të jesh qëllimshëm konfuz në ideologji dhe si pasojë të jesh parti e qendrës” (Bailey, G. & Gayle, N, 2008).

Këto parti (partitë e qendrës) kanë si synim atë që Otto Kirchheimer e quajti si “catch-all party” (parti gjithëpërfshirëse), ku sipas tij qëllimi kryesor i këtyre partive është maksimizimi i votave (Kirchheimer, 1999). Edhe pse programi politik i LDK-së mund të duket i qendrës, LDK orientohet nga Qendra e Djathtë.

Në programin e LDK-së po ashtu gjenden edhe dy fjali të tjera që tregojnë qëndrimin e tyre konservator ndaj kulturës: “LDK-ja si parti e vlerave tradicionale e moderne (Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena, 2008) dhe LDK-ja, si parti e vlerave burimore, tradicionale, por edhe të vlerave moderne”s (Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena, 2008).

“Kurse fjalia e tretë dhe e pesta në fakt janë një ikje nga spektri i djathtë. Partitë me ideologji konservatore janë zakonisht edhe nacionaliste. Në përgjithësi këto parti i donë fjalët e egra dhe nuk besojnë në idealizëm dhe në institucionet ndërkombëtare si OKB” (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008). Megjithatë LDK si parti politike synon që me qeverisjen e saj Kosova të anëtarësohet në OKB.

Qasja e LDK-së ndaj luftës është kryesisht e butë dhe madje nuk preferon luftën fare. Kjo mund të shpjegohet qartazi nga lideri i saj shpirtëror z. Rugova i cili udhëhoqi rezistencën paqësore në Kosovë për gati 10 vjet. Rugovës madje i pëlqente kur e krahasonin me liderin shpirtëror dhe paqësor të Indisë Mahatma Gandhi.

Sipas referimeve të profileve ideologjik, qasja e butë ndaj luftës është veçori e partive të majta, rrjedhimisht liberale dhe Social Demokrate.

“Fjala e katërt, shpreh qëndrimin e LDK-së ndaj lirisë së individit dhe përgjegjësinë e tij. Kjo në fakt i përket spektrit të partive të djathta. Partitë e djathta, rrjedhimisht konservatore në ideologji, janë për maksimizimin e lirisë së individit, por kjo shkon tok edhe me përgjegjësinë e tij. Pra shteti do të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë, por ai nuk merr përgjegjësi të madhe për mirëqenien e individit, duke e lënë individin që të shfrytëzojë mundësitë e barabarta” (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008).

Natyrisht të fiksuar nga globalizimi i cili nuk pyet për kultura, konservatorët dëshirojnë që të i konservojnë disa elemente të traditës të cilat edhe e lidhin të tashmen me të kaluarën. Zakonisht, konservatorët janë të lidhur dhe frymëzohen nga e kaluara.

Historikisht, LDK u formua kundër socializmit të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ajo evoluoi në një parti që kërkoi për të ruajtur vlerat tradicionale të Kosovës. Është gjithashtu pjesë e Partive Popullore Europiane, e cila bashkon partitë e qendrës së djathtë të Evropës. Sidoqoftë, LDK është më liberal se partitë e qendrës së djathtë për çështje ekonomike (Malazogu, Leon and Gautam, Brenna, 2014), ajo gjithashtu ka një qasje më individualiste ndaj shoqëria, edhe pse pretendon se është konservatore. LDK është një ithtar të privatizimit të ndërmarrjeve publike, por gjithashtu qëndron për kujdes shëndetësor falas. Duke studiuar programin politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është e dukshme se programin e saj mund të ndahet në dy profile, majtiste konservatore dhe liberale e tregut të lire. LDK kundërshton rregullimin e tregut nga qeveria dhe në të njëjtën kohë favorizon subvencionet e kufizuara. LDK përkrah një ekonomi të tregut të lirë “laisser-faire” e cila do të siguronte sistem efektiv shëndetësor dhe rritje në normë

potenciale të punësimit. Si parti politike, ajo është në favor të qeverive të vogla, tregut të lirë të ekonomisë, më pak taksa, rol më të madh të individit, kundër abortit, kundër martesave me të njëjtën gjini, privatizim të plotë.

LDK në Preambulën e saj ka ndërtimin e shtetit dhe demokracisë, si dhe promovimin e vlerave politike e kulturore shqiptare. Me Programin nacional të saj, LDK angazhohej për daljen nga sistemi një partiak komunist dhe kalimin në pluralizëm politik. “LDK angazhohet për liritë e njeriut, lirinë e fjalës, lirinë e shtypit përmes gatishmërisë personale dhe kombëtare për ta fituar dhe për ta mbrojtur atë” (LDK, Preambula e programit të LDK, 2016).

LDK, sipas programit të saj, është parti e profilizuar me platformë politike që e ka mision shtetin për qytetarët, ndërtimin e lidërshipt të fortë, krijimin e politikave që gjenerojnë cilësi të lartë të jetës përmes mundësive dhe qasjes së barabartë për të gjithë qytetarët. Edhe pse partitë e djathta janë kryesisht euroskeptike, pasi që këto parti janë për ruajtjen e sovranitetit dhe pushtetit qendror, del se sipas argumentimit të tyre hyrja në Bashkimin Evropian cenon sovranitetin e shtetit (LDK, Programi politik i LDK, 2015).

Programi politik i LDK-së është i koncentruar për arritjen e objektivit për një Kosovë evropiane duke promovuar mbështetjen e familjes dhe ekonominë e tregut. Lidhja Demokratike e Kosovës, si bartëse themelore e jetës institucionale, është angazhuar për krijimin e parakushteve për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurruese, me një infrastrukturë të re ligjore të ekonomisë së tregut me qasje mjaft liberale. Është ndërtuar një sistem i ri fiskal i cili financon nevojat publike nga mjetet vetjake dhe sistemi bankar krejtësisht i ri që siguron stabilitet valutor.

Është në zhvillim e sipër një sektor privat mjaft dinamik, sidomos në sektorin e shërbimeve, ndërkaq po ndihen efektet pozitive nga privatizimi. Viteve të fundit institucionet e Kosovës kanë nënshkruar disa marrëveshje të tregtisë së lirë me vendet fqinje për të tejkaluar barrierat tregtare dhe lehtësuar qarkullimin ndërkufitar të mallrave (LDK, Programi zgjedhor i LDK, 2016).

Në zhvillimin e Kosovës LDK synon një shoqëri të bazuar në dije, me një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese në tregun ndërkombëtar. LDK ka orientime të qarta për sa i përket ekonomisë. LDK, në programin e saj ka një qasje mjaft liberale dhe angazhohet për një ekonomi të tregut. Për më tepër LDK-ja vazhdon të jetë në favor të bizneseve dhe kompanive të mëdha, që do të thotë në fakt se është një qasje komplet e djathtë. “Në programin e tyre ata janë shprehur se do të bëjnë rishqyrtimin e tatimeve dhe aplikimin e lehtësirave tatimore për investimet dhe bizneset e reja, me kusht që të rrisin punësimin” (Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena, 2008).

LDK përkrah gjithnjë privatizimin e plotë të ndërmarrjeve shtetërore. Kjo nuk është karakteristikë për partitë e majta. Në fakt, Partitë e majta angazhohen që kompanitë e mëdha dhe fitimprurës të jenë pronë shtetërore, ndërkaq LDK në programin e saj nuk parasheh që burimet strategjike të Kosovës duhet të jenë të shtetëzuara por duhet të privatizohen.

“Në programin e tyre theksohet qartë edhe përkrahja e tyre për bizneset eksportuese: (psh. Ferronikeli, Llamkosi, prodhuesit e verërave, prodhuesit e materialit ndërtimor, etj)” (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008). Përkrahja e LDK në fakt konsiston në uljen e taksave për këta prodhues në mënyrë që këto

kompani të maksimizojnë fitimet e tyre, por jo të jenë pronë shtetërore. “LDK është në favor të tregut lirë, pa monopole dhe pa barriera për investime, politika tërheqëse të tatimeve dhe taksave për investitorët” (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008). Këto angazhime tregojnë qartë orientimet e djathta të LDK-së..

“LDK-ja beson në konkurrencë, si mjetë themelor i sigurimit të ekonomisë së tregut, zhvillimit dhe prosperitetit” (LDK, Orientimet programore të LDK-së). Parimin “laissez-faire” apo tregu i lirë në ekonomi që zakonisht e përkrahin partitë e djathta.

LDK-ja është pak më shumë liberale sesa partitë e qendrës së djathtë kur kemi të bëjmë me çështjet ekonomike. Në aspektin social, LDK-ja ka qëndrime konservatore, edhe pse mban pozicionim individualist në fushën e të drejtave të njeriut, duke e theksuar barazinë pa marr parasysh gjininë, moshën, përkatësinë etnike dhe fenë” (LDK, LDK Online, Vision) . “Partitë politike me ideologji të djathta janë të prira që të zvogëlojnë administratën shtetërore përkatësisht numrin e të punësuarve në administratë” (Bailey, G. & Gayle, N, 2008). “Qeveria e Kosovës do të ketë vetëm 12 ministri, secila sosh me vetëm dy zëvendësministra“ (LDK, Orientimet programore të LDK-së). Duke u pozicionuar si një parti e qendrës së djathtë, LDK ka përkrahur një qeveri të vogël dhe kjo është në përputhje me orientimin e saj ideologjik sikurse është edhe pro privatizimit.

“Privatizimi bënë që shumë shërbime që ofrohen nga shteti të kalojnë në kompanitë private dhe kjo ndikon në zvogëlimin e administratës shtetërore” (Eagly, A. H., & Chaiken, S, 1998). “Këtë LDK e ka shprehur në programin e saj ku thotë se LDK synon të zvogëlojë administratën shtetërore” (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008).

“Partitë e djathta janë kundër abortit dhe kundër martesave me gjini të njëjtë, të cilat afektojnë familjet dhe prishin sistemin familjar” (Geuss R. , 2002).

“Konservatorët nuk janë në tërësi kundër ndryshimeve, por ata preferojnë ndryshimet organike e jo ato revolucionare. Ashtu siç Burke thoshte se: shteti i cili është pa mjetet e ndryshimit, është shtet pa mjetet e konservimit” (Hutchins, 2009). Pra, ndryshimet nuk janë të ndaluara, sepse shoqëria zhvillohet dhe duhet të ndryshojë, por jo esencialisht dhe në mënyrë revolucionare. “Për konservatorët, shoqëria njerëzore është e rrënjësuar dhe organike, nëse vendos të ndryshosh apo riformosh atë sipas planeve të ideologjive, do të thotë të ftosh shkatërrime të paparashikuara” (Dunn J. , 1993). Me fjalë të tjera LDK është parti e cila dëshiron të i konservojë vlerat që ka shoqëria jonë (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008).

Në aspektin e integriteteve evropiane të gjitha partitë politike në Kosovë janë për integrim, edhe LDK është e vendosur se Kosova duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Partitë politike të spektrit të djathta zakonisht janë euro-skeptike, për shkak se argumentojnë se hyrja në Bashkimin Evropian minon sovranitetin e shtetit dhe dihet që partitë e djathta janë për ruajtjen e sovranitetit dhe pushtetit qendror.

Sipas përfaqësuesve të LDK-së, të drejtat individuale dhe kolektive duhet të ushqehen në një shtet sekular ku garantohet e drejta e besimit dhe religjionit dhe ku dot ë mbizotëronte toleranca fetare. Përkundër këtij qëndrimi ndaj fesë, LDK-ja nuk e përkrahë futjen e mësimet fetar në plan programet e sistemit të shkollave publike. Ata besojnë se në një shtet sekular siç e promovon kjo parti, feja duhet të jetë e ndarë nga të gjitha institucionet publike. Duke përcjell mënyrën e njëjtë të argumentimit, LDK përkrah të drejtën për

ndërprerje të shtatzënisë. Përfaqësuesë të LDK-së theksojnë se e drejta për abort forcon vlerën e familjes dhe kontribuon drejt zhvillimit të normave të shëndosha morale dhe shoqërore. Megjithatë, anëtarët e Kuvendit theksojnë se një e drejtë e tillë duhet të shfrytëzohet para se embrioni të jetë zhvilluar në fetus.

Efektet e një orientimi ideologjik ishin të pamundura për shkak të një bashkëqeverisje e një koalicioni të gjere të imponuar nga Bashkësia ndërkombëtare.

“Nëse mospajtimet apo kundërshtitë nuk lejohen në emër të përkrahjes së liderit të partisë dhe kur ka shumë pak kanale zyrtare për shprehjen e këtyre mospajtimeve, polemikat apo mospajtimet ka shumë të ngjarë që ta qojnë partinë më shumë drejt ndarjes sesa drejt një fraksioni” (Scarrow, 2010). Konkludim i Susan Scarrow i përshtatet më së miri LDK-së. Duke qenë se Ibrahim Rugova ishte jo vetëm lider i partisë por edhe personi që personifikonte partinë, gjatë kohës së tij nuk kishte konflikte apo mosmarrëveshje të pazgjidhura, sepse ai ishte i zoti i shtëpisë dhe mendimi i tij ishte final (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008). Por, LDK kishte një hierarki partiake dhe postet politike që i mbanin ata në qeveri dhe në Parlament që vetë Ibrahim Rugova ua kishte dhënë nuk do të thotë se ishin mbi postin e partisë, të paktën kështu mendonin në partinë e LDK-së (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008).

Kjo është një situatë e paqartësisë ideologjike mund ta bëjë të vështirë për qytetarët që të marrin vendime “të informuara”.

4.2.2 Raporti midis Ideologjisë dhe Partisë Demokratike të Kosovës

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), krijohet në një moment të veçantë të historisë së Kosovës. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së forcave ndërkombëtare, fillimit të organizimit dhe të ndërtimit të institucioneve të para demokratike të Kosovës, janë krijuar kushtet e përshtatshme për veprimtari politike publike.

PDK konsiderohet si trashëgimtare e strukturave politike të UÇK –së dhe e sistemit të vlerave politike kombëtare për liri demokraci e pavarësi të Kosovës. PDK identifikohet me vlerat dhe synimet e organizatave patriotike të pas Luftës së Dytë Botërore, trashëgimtare e luftës së UÇK-së dhe vazhduese e realizimit të synimeve të saja në paqe.

“PDK mbështet përpjekjet e forcave politike shqiptare në rajon, të cilat kanë për qëllim që me pjesëmarrje në procesin e integriteteve rajonale dhe evropiane të realizojnë të drejtat e pakontestueshme kombëtare. PDK angazhohet për ndërtimin e një politike sa më të afruar e të njëzuar me shtetin shqiptar, kombëtare e ndërkombëtare” (PDK, Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, 2012).

Përshkrimi i profilit të PDK-së duke marrë disa paragrafë nga programi i saj, i cili për dallim nga partitë tjera, është program i partisë dhe jo program zgjedhor. Sidoqoftë e rëndësishme është ajo që është shkruar në këta paragrafë dhe që tek partitë tjera nuk gjenden si të tillë.

Partia Demokratike e Kosovës ofron statutin e saj partiak ku qëllimi, vlerat dhe vizioni politik i partisë jepen në nenet 3 dhe 4. Sipas statutit të PDK-së, ajo është parti popullore e

cila mbështet vlerat tradicionale, kombëtare, vlerat e luftës dhe vlerat e demokracisë qytetare (neni 3 pika1) (Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës (pa datë), neni 3). Partia Demokratike e Kosovës pretendon të jetë parti e qendrës së djathtë, megjithëse në periudhat e hershme të saja ka qenë parti e vet deklaruar si majtë. Sipas statusit të kësaj partie synimet kryesore janë sundimi i ligjit, demokracia kushtetuese dhe parlamentare në një shtet të fortë dhe funksional, integrimi i Kosovës në strukturat euroatlantike.

“Tipari më dallues i partive të djathta është edhe ai i retorikës patriotike” (Arendt, On Revolution, 1990). “Partitë e djathta zakonisht parapëlqejnë forcën për arritjen e qëllimit” (Blattberg, 2000), e që në rastin e PDK-s kjo mund të lidhet me kohën e para shndërrimit në parti politike, pra koha kur ishte UÇK, por edhe aspiratat të cilat kjo parti i mbartë në vete”. PDK tani ka një pozicion më të moderuar, madje thuhet se është moderuar së tepërmi, por karshi forcave tjera politike, ajo ende mbetet partia e cila bartë vlerat dhe synimet e UÇK-së, ashtu edhe siç janë deklaruar vetë në këtë program.

Për të kryer punim doktrate, ne i jemi referuar programit të partisë, i cili e shpjeguar që nuk është program zgjedhor, por përcakton sistemin e besimeve dhe vlerave që ka kjo parti dhe i cili si dokument nuk mbanë ndonjë datë se kur është miratuar, pastaj edhe ueb faqeve zyrtare të cilat i ka PDK në internet siç janë: <http://pdk.info/sq-AL/ballina.aspx> dhe <http://krenohu.com>.

“PDK përkufizohet kryesisht si parti e qendër së djathtë në spektrin politik, dhe ka një kombinim të politikave liberale në aspektin ekonomik, por edhe atyre konservatorë në aspektin social; p.sh. përkrahja e tregut të lirë dhe tatimet e ulëta, si dhe ruajtja e vlerave tradicionale” (Insight, Key Political Parties in Kosovo, 2010). Një shembull i mirë ka qenë

përkushtimi i PDK-së për privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës përkundër disa zërave brenda partisë dhe jashtë partisë.

Po ashtu PDK herë pas here ka pasur tendenca drejt të majtës. “PDK-ja më parë e ka përkufizuar vetën si social demokrate, dhe ka mbajtur lidhjen me Partinë Laburiste (e punës) të Mbretërisë së Bashkuar” (Zulfaj, Jeton; Mulliqi, B; Shala, M; Tahiri, P, 2008) si dhe me Partinë Demokratike në SHBA (Selimi, 2015). PDK-ja ka shfaqur lidhje të ngushta me Partinë Socialiste të Shqipërisë edhe pse nuk është e qartë që ka elemente të përbashkëta sa i përket disa çështjeve specifike të ideologjisë partiake. PDK, në aspektin ideor, është parti e qendrës së djathtë (PDK, Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, 2012). Në fillimet e saj, PDK-ja ka pasur një orientim ideologjik relativisht majtist, duke kultivuar kontakte edhe me Partinë Laburiste të Mbretërisë së Bashkuar.

“Partia Demokratike e Kosovës beson dhe angazhohet për lirinë e individit. Konsideron se individit duhet të ketë qasje në informata dhe angazhohet për respektimin e të drejtave të tij. Konsideron se shteti dhe shkolla duhet të jenë laikë” (PDK, Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, 2012).

Në përgjithësi partitë e djathta konsiderojnë se shteti është i obliguar që të ligjëroj moralin publik, kjo për faktin se ato dëshirojnë të konservojnë traditën dhe të kaluarën. Partitë me profil të djathtë shprehen kundër martesave me gjini të njëjtë dhe kundër abortit, prandaj edhe kërkojnë të ligjërohet morali publik sepse e pastron shoqërinë dhe u tregon atyre se çka është e drejtë dhe e gabuar.

PDK-ja në këtë rast bënë një devijim nga spektri i djathtë ideologjik dhe qëndrimi i tyre i përshtatet më shumë spektrit qendër- e majtë të cilët janë për maksimizimin e respektimit të të drejtave të njeriut pa diskriminim.

PDK-ja ka shfaqur tipare të ideologjive të kundërta. Në njërën anë e mbështet privatizimin e plotë të ndërmarrjeve publike, që është e qartë se i takon se i takon të djathtës, dhe në anën tjetër ka ndërtuar një administratë të madhe publike, gjë që është më shumë majtiste. Po ashtu shfaqet majtiste edhe në rastin e subvencioneve për bujqësi, të cilat janë rritur ndjeshëm sidomos gjatë administrimit të PDK-së. Partia Demokratike e Kosovës sikurse të gjitha partitë tjera, me disa ndryshime të vogla në qasje, deklarohej në angazhimin e saj për të ndihmuar njerëzit që jetojnë në kushte të këqija ekonomike. PDK me programin e saj të qeverisjes është e angazhuar që:

- të vazhdojë dhe të rrisë mbështetjen për familjet e dëshmorëve;
- veteranë;
- invalidët e luftës; Indeksi i pensionit bazë ndaj inflacionit;
- Sigurimi i mbështetjes së duhur shëndetësore për kategoritë sociale, në institucionet e shëndetit publik; etj.

“PDK angazhohet fuqishëm për të afirmuar dhe garantuar lirinë e mendimit, të shprehjes, solidaritetin, barazinë sociale dhe përgjegjësinë personale të çdo qytetari, parimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen e vlerave qytetare dhe të diversitetit etnik dhe fetar të shoqërisë” (PDK, Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, 2019).

- “PDK-ja do të ulë taksën e korporatave.
- Taksa jonë e korporatave është më e larta në rajon.
- Në nivelin aktual nuk ekziston pothuajse asnjë stimul për kompanitë ndërkombëtare që të investojnë në Kosovë.

- Ulja e taksës së korporatës do të qonte një mesazh botës se Kosova është e hapur ndaj bizneseve.
- PDK angazhohet për ekonomi private në Kosovë, të bazuar në ligjet e ekonomisë së tregut, të hapur e të lirë, të integruar në institucionet rajonale dhe evro-atlantike.
- PDK do të angazhohet për privatizimin e pronës private sa më shpejtë që të jetë e mundur.
- PDK do të stimulojë, favorizojë dhe mundësojë krijimin e ndërmarrjeve duke bërë lehtësime dhe duke i zbutur masat administrative” (PDK, Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, 2019)

Sipas këtyre paragrafëve pa përjashtim, demonstrohet orientimi i djathtë i Partisë Demokratike apo thënë më mirë i një qasje të djathtë sa i përket aspektit ekonomik.

Ne hyrje të këtij studimi ne kemi thënë në hyrje se partitë politike në Kosovë më shumë janë në qendër se sa që i përkasin ndonjë krah politik, por ligjërimet e tyre për gjëra të ndryshme e bëjnë atë që të ketë edhe qasje të ndryshme dhe të dalë herë në krahun e majtë e herë në të djathtin. Kjo edhe kuptohet duke u nisur nga teoria e Otto Kirchheimer, e cila shpjegon se partitë politike kanë për qëllim maksimizimin e votave (Kirchheimer, 199), prandaj edhe lëvizin në spektrin politik herë në të djathtë e herë në të majtë.

Zotimi i Partisë Demokratike për hapjen e vendeve të punës është një tjetër aspekt i matje ideologjik. “Partitë e djathta nuk zotohen për krijimin e vendeve të punës por për ofrimin e mundësive të barabarta dhe është tregu i lirë ai që punëson njerëzit” (Bailey, G. & Gayle, N, 2008).

“Shihet qartë se PDK dëshiron që të ulë taksat për bizneset dhe kompanitë, pastaj premtion edhe lehtësira tjera administrative” (Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena, 2008). Aspekt tjetër i djathtë tek Partia Demokratike e Kosovës është edhe privatizimi

“PDK angazhohet për privatizim sa më të shpejtë të pronës shoqërore” (PDK, Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, 2012), çka është prapë element i partive të djathta rrjedhimisht konservatore në ideologji.

Përkrahja për privatizimin do të thotë edhe angazhimi i Partisë Demokratike për zvogëlimin e administratës shtetërore që është në përputhje me privatizimin.

Të gjitha këto qëndrime:

- “përkrahja për tregtinë e lirë dhe pa barriera dhe të avancimit të kapitalizmit, në vend të intervenimit në ekonomi për të zvogëluar hendekun në mes të pasurve dhe të varfërve”,
- “krijimi i mundësive të barabarta në vend të barazisë sociale”,
- “përkrahja për privatizimin në vend të ruajtjes së të drejtës për nacionalizim të resurseve strategjike, etj, janë indikatorë për një qëndrim të djathtë të PDK-së”

Një qasje e djathtë e PDK-së shihet edhe tek angazhimi i PDK-së për mirëqenien sociale.

PDK angazhohet për institucionalizimin e një fryme të re sociale që konsiston në krijimin e kushteve të barabarta për progres të çdo qytetari të Kosovës, pra në thelb të fjalisë është krijimi i kushteve të barabarta që nënkupton barazi në mundësi, por jo edhe barazi në të ardhura (Bobbio, 1997).

PDK-ja është e vendosur se shteti i Kosovës duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Siç e theksuam partitë e djathta zakonisht janë euro-skeptike, për shkak se ato argumentojnë se hyrja në Bashkimin Evropian minon sovranitetin e shtetit dhe dihet që partitë e djathta janë për ruajtjen e sovranitetit dhe pushtetit qendror. Programi i Partisë Demokratike të Kosovë shihet midis ligjërimit të së djathtës por që nuk është shumë i theksuar dhe ligjërimit pragmatik.

PDK ka pikëpamje më konservatore sa i përket çështjes së pakicave dhe prostitucionit. Ata nuk besojnë që qeveria duhet të ndërmarrë veprim afirmativ për institucionalizimin e kuotave për pakicat gjatë punësimit në sektorin publik – të gjithë njerëzit që konkurrojnë për punë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë (Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena, 2008). Ndërsa sa i përket prostitucionit PDK e sheh atë si kundërvajtje që duhet të dënohet.

Sa i përket çështjeve ekonomike, PDK-së pozicionohet më shumë në të majtë të qendrës, dhe më pak se gjysma në të djathtë të qendrës. Kjo parti politike ka shfaqur simpati për rolin e qeverisë në rregullimin e tregut dhe doganave, dhe në krijimin e vendeve të punës për një ekonomi të shëndetshme.

Partitë politike që anojnë kah e djathta tregojnë mbështetje për ekonominë e privatizuar, e cila është më efektive, si dhe për një politikë fiskale, e cila e promovon zvogëlimin e tatimeve për një mjedis më të mirë afarist. Në këtë kuadër globalizimi shihet në përgjithësi si një forcë pozitive, por në disa raste mund të ketë ndikim negativ, posaçërisht, në ekonomi.

“Për më tepër, zyrtarë të shumtë nga radhët e PDK-së besojnë se politikat shëndetësore duhet të jenë pa pagesë ose me kosto të ulët, ndërsa shteti duhet ta mbështes më shumë kujdesin shëndetësor nga buxheti” (Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena, 2008).

Sa i përket vlerave kryesore sociale/politike, PDK-ja ka shfaqur orientim konservator, dhe më pak se gjysma e tyre kanë shfaqur vlera liberale, pra janë mbi vijën ndarëse në mes. Për shembull, ata besojnë se të drejtat e komunitetit LGBT duhet të mbesin private dhe të mos promovohen publikisht.

4.2.3 Raporti midis Ideologjisë dhe Lëvizjes Vetëvendosje

Vetëvendosje (VV) u themelua si lëvizje në 2005 dhe mori pjesë në zgjedhjet në 2010 për herë të parë. Themeluesi i VV-së është Albin Kurti, një të organizatorëve kryesorë të demonstratave të dhunshme në vitet 1997-1998. Lëvizja Vetëvendosje filloi me parullën dhe mbishkrimet “Jo Negociata, Vetëvendosje”.

Vetëvendosje argumenton se dialogu Prishtinë-Beograd mund të vazhdohet vetëm nëse Serbia njeh shtetësinë e Kosovës; në këtë kuptim ajo ka një qasje më radikale për negociatat, sesa partitë e tjera politike të Kosovës. Vetëvendosje ishte kundër Protektoratit të KB dhe kundër Pakos së Ahtisari që kërkoi për të krijuar një Kosovë me një pavarësi të mbikëqyrur. VV mbetet një parti e fortë kundërshtar i çdo forme sovraniteti që nuk garanton pavarësi të plotë. Lëvizja VETËVENDOSJE karakterizohet si parti e qendrës së majtë me ideologji nacionaliste, proteksionizëm dhe demokraci direkte. Për sa i përket shtet ndërtimit, kjo parti politike mbështet subjektivitetin dhe sovranitetin e shtetit, demokracinë

brenda tij, drejtësinë dhe qytetarinë, kurse zhvillimin ekonomik shoqëror e mbështet në rritje të kapaciteteve prodhuese dhe shpërndarje më të drejtë të pasurisë në funksion të rritjes së mirëqenies (Parimet dhe prioritetet programore të Lëvizjes Vetëvendosje!).

Në programin politik të kësaj partie vihen në pah dy prioritetet: shteti ndërtimi dhe zhvillimi ekonomik social. VV e konsideron veten si një parti të qendrës së majtë, por Kurti pranon se rrethanat dhe sistemi politik në Kosovë e bëjnë më të vështirë të jenë partitë ideologjike (Nosan, 2012).

Programi i Vetëvendosjes përqendrohet në tre akse kryesore: shteti zhvillimor, meritokracia dhe shteti i mirëqenies (Kurti, 2013). Ato karakterizohen nga kontrasti i madh me spektrin kryesor politik brenda Kosovës në lidhje me dy çështje që karakterizojnë Kosovën pas luftës: procesi i gjatë i negociatave me Serbinë në lidhje me organizimin e brendshëm dhe aspektet socio-politike të Kosovës, pa i imponuar asnjë kusht paraprak Palës serbe, të cilën ata e konsiderojnë "të padrejtë dhe të dëmshme" (Kurti A. , 2013) dhe procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, të cilat ata i përshkruajnë si "një model korrupsioni, duke kontribuar në rritjen e papunësisë, shkatërrimin ekonomik dhe ndalimi i zhvillimit ekonomik të vendit" (Kurti A. , 2013)

Në politikat ekonomike, VV është më e majtë se çdo parti tjetër e Kosovës, duke favorizuar një sistem ekonomik i cili krijon barazi ekonomike midis qytetarëve. Në përputhje me ideologjinë e tyre, VV mbetet një kundërshtar i ashpër i procesit të privatizimit në Kosovë dhe një përkrahës i fortë i rolit të shtetit në ekonomi. Ajo favorizon politikën rishpërndarëse, arsimin falas në universitet, kujdesin shëndetësor falas dhe shërbimet sociale. Ajo është gjithashtu e vetmja parti me një qëndrim më të qetë për fenë, duke mbështetur shaminë në

shkollat publike, e cila aktualisht është e ndaluar në Kosovë dhe është ndoshta çështja më e rëndësishme për praktikimin e myslimanëve të Kosovës.

Qëndrimi i LVV-së kundër UNMIK-ut, kritika e saja kundër Serbisë e bën atë të dalë më shumë si nacionalist, sesa një parti e majtë. LVV përveç Prishtinës në një nivel lokal nuk ishte kurrë pjesë e ndonjë qeverie koalicion dhe refuzon në mënyrë kategorike çdo koalicion të mundshëm me PDK-në, të cilën ajo konsideron si të korruptuar.

LVV është kritikuar brenda Kosovës për mos njohjen e simboleve të Kosovës dhe kushtetutën e saj. Kjo parti kryesisht kritikohet për qëndrimin e pa kompromis ndaj çështjeve të veçanta, veçanërisht në marrëveshjet Kosovë-Serbi, të cilat kundërshton jo vetëm me mjete legale, por përmes protestave dhe bllokimit parlamenti duke përdorur gaz lotsjellës. Për më tepër, ajo kundërshton SHBA dhe BE për përfshirjen në çështjet e brendshme të Kosovës, duke kundërshtuar gjithashtu EULEX-in (Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë). Kjo është arsyeja pse BE dhe SHBA janë shumë kritike ndaj LVV-së dhe metodave të saj, që është disi problematike për LVV-në, duke marrë parasysh që (të paktën aktualisht) në Kosovë, nëse një parti kërkon të fitojë zgjedhjet dhe dëshiron të ketë opinion publik të favorshëm kosovar, është e domosdoshme të jesh mbështetur dhe pëlqyer nga BE dhe SH.B.A., pasi që shumica e shqiptarëve të Kosovës pranojnë që Kosova si shtet ekziston kryesisht nga mbështetja e Perëndimi në përgjithësi, dhe Shtetet e Bashkuara në veçanti. Nacionalizmi i Lëvizjes Vetëvendosjes dhe qëndrimi anti-sistem shpesh zbeh rëndësinë e ideologjisë së partisë ideologjia dhe zbeh më shumë nacionalizmin dhe karakterin e tij pa kompromis. Duke vënë në pah besimin e kësaj partie se Kosova e ka të drejtën e të qenët shtet i barabartë me shtetet e tjera, atëherë kjo nënkupton se Kosova ka

të drejtën e saj për vetëvendosje të jashtme, që do të thotë se shteti i Kosovës duhet ta ketë të drejtën e bashkimit me Shqipërinë. “I takon popullit shqiptar që jeton në Shqipëri dhe në Kosovë të deklarohen lirshëm si do ta përdorë dhe ta shfrytëzojë këtë të drejtë” (Alternativa Qeverisëse).

Diskursi mbizotërues i thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje kishte të bënte me nevojën për zgjerimin e lirive politike, veçanërisht të drejtën për vetëvendosje, dhe prioritizimin e drejtësisë sociale dhe mirëqenies mbi liberalizmin e prapambetur dhe privatizimin në Kosovë. Në manifestin e tyre, Lëvizja Vetëvendosje vendos lidhjen midis vetëvendosjes dhe zhvillimit, si dhe vetëvendosjes dhe çlirimit / rezistencës. Në lidhje me të parën, ata pretendojnë se:

“Kur nuk ka liri, barazi ose drejtësi, mungesa e ushqimit është e pashmangshme. Pa liri, garantohet regresioni ekonomik dhe shoqëror. Të bësh në jetë të drejtën për vetëvendosje nuk është garanci për sukses - por krijon kushtet për zhvillim të lirë; dhe marrja e përgjegjësisë rezulton në një motiv të fortë për të pasur sukses, dhe aftësinë për tu përmirësuar nga gabimet” (Lëvizja Vetëvendosje, 'Manifesti i Lëvizjes', 2010).

Brenda sferës socio-ekonomike, Lëvizja Vetëvendosje synon të punojë për ndërtimin e një sistemi të miksuar të ekonomisë, bazuar në prodhimin e brendshëm, rishpërndarjen e drejtë të pasurisë dhe drejtësinë e mirëqenies dhe shoqërisë. Lëvizja Vetëvendosje u referohet këtyre dy shtyllave si thelbësore për të mbetur një shtet sovran dhe republikan, i cili mjegullon dhe përzien programin e tij ideologjik me elementë të së majtës dhe të djathtës. Strategjia kryesore e përdorur nga Lëvizja Vetëvendosje drejt UNMIK-ut dhe më vonë kundër EULEX-it ishte de-legjitimizimi në sytë e popullatës lokale, duke i portretizuar

mandatet e tyre si regjime jodemokratike, koloniale dhe kufizues të lirisë dhe vetëvendosjes së Kosovës (Lëvizja Vetëvendosje, 'Historia e Lëvizja VETËVENDOSJE (Lëvizja për vetëvendosje)). Në ndjekjen e ideologjisë së tyre të rezistencës, Lëvizja Vetëvendosje angazhohet në mënyrë aktive për të shndërruar në mënyrë të ndërsjellë agjencinë dhe strukturën në Kosovë. Në nivelin e agjencisë, Lëvizja Vetëvendosje kërkon në mënyrë aktive të edukojë aktivistët e saj me një socializim kritik politik dhe t'i trajnojë ata se si të praktikojnë rezistencën ndaj autoriteteve në baza ditore përmes veprimeve kolektive simbolike dhe më të organizuara. Ky spektër pedagogjie ka për qëllim krijimin e një qytetarie aktive (masë kritike), e cila do të jetë në gjendje të konfirmojë thirrjen e lëvizjes në çdo moment, si dhe të propagandojë dhe rekrutojë me sukses anëtarët e rinj, si nga prejardhja urbane, ashtu edhe nga ato rurale dhe të arsimuara dhe të paarsimuara. Shtrirja e tij e gjerë e orientimit ideologjik i lejon Lëvizja Vetëvendosje të përmirësojë ndikimin e agjencisë mbi strukturën, si rezultat i arritjes për të sjellë në trupin e saj studentë të arsimuar, të cilët janë të ngopur me situatën politike dhe duan të shohin ndryshime pozitive në Kosovë, ish-veteranët e luftës që janë përjashtuar nga palët që kanë të bëjnë me luftën dhe nga shoqata e luftës dhe që duan të mbrojnë vlerat dhe identitetin shqiptar që ata kanë luftuar gjatë luftës; dhe njerëz të papunë që jetojnë në varfëri dhe kushte të cënueshme. Pra, agjencia që po ndërton Lëvizja Vetëvendosje është e rrënjosur në të dyja zgjedhjet rationale, të bindur kryesisht nga anëtarësia që vijnë nga prejardhje të papunë, dhe më shumë motive dhe perkusione gjithëpërfshirëse për transformimin shoqëror të bindur nga ata që janë arsimuar dhe kanë marrë pjesë në luftën e Kosovës.

Sa i përket strukturës, Lëvizja Vetëvendosje është e përkushtuar të ndryshojë kushtetutën e Kosovës, të ndikojë në vendimin kryesor në lidhje me sistemin ekonomik në Kosovë, integritetin territorial në veri të copëzuar dhe t'i japë fund prezencës ndërkombëtare të ngarkuar me autoritete civile dhe ushtarake mbi Kosovën. Transformimi i saj në një parti politike dhe hyrja në parlamentet e Kosovës shpjegon qasjen sistematike të Lëvizja Vetëvendosje dhe synimin drejt ndryshimit të strukturës së sistemit politik të Kosovës, së bashku me presionin e saj të jashtëm që ushtron përmes një agjencie aktive dhe kritike. Ata kanë qenë një nga partitë më aktive politike në Kuvendin e Kosovës gjatë vitit 2012 dhe ata kanë rritur me sukses debatin kritik brenda dhe për të gjitha sferat e zhvillimeve politike në Kosovë. Lëvizja VETËVENDOSJE në programin e saj elektoral angazhohet për zvogëlim të numrit të ministrive (Parimet dhe prioritetet programore të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, 2019). Shikuar nga perspektiva ideologjike, qeveritë e vogla janë tipike për partitë e djathta.

4.3 Programet elektorale dhe ligjërimet të subjekteve politike në Kosovë

Partitë politike në Kosovë karakterizohen nga premtime shumë ambicioze dhe synime të arritshme gjatë fushatave zgjedhore.

“Programet e partive politike në Kosovë theksuan mungesën e qartë të orientimit të tyre profil. Është vërejtur që shumica e subjekteve ende funksionojnë nën sistemin e njohur si “Catch-all Party”, që do të thotë të gjitha Partitë që nuk kanë një program të qartë dhe skemë ideologjike do të përpiqen përmes disa mekanizmave të përkohshëm (ad hoc) për të kënaqur grupet e popullatës që vijnë nga klasa të ndryshme shoqërore” (Kirchheimer, 1966). Prandaj, partive politike në Kosovë u mungonte përkufizimi i duhur ideologjik, i cili është i domosdoshëm jo vetëm për partitë politike të cilat do të kishin një format themelor të hartimit të politikave, por edhe për qytetarët e saj, sepse në këtë mënyrë është më e lehtë për ta (qytetarët) të identifikohen, udhëzojnë dhe mbrojnë interesat e tyre në nivelet të ndryshme vendimmarrjeje. Partitë politike më të mëdha politike që garojnë në zgjedhje siç janë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Këto parti politike hartuan programet e tyre qeverisëse që përshkruajnë opsione të mundshme për probleme të shumta që shqetësojnë shumicën e qytetarëve të saj. Programet e partive politike dukej se ishin dizajnuar në atë mënyrë që të ishin të përshtatshme për secilën klasë të shoqërisë. Sidoqoftë, termi “zhvillim” ishte emëruesi i përbashkët i pothuajse të gjitha partive politike.

Programet politike u karakterizuan nga njëra-tjetra në disa aspekte (Shih Tabelën 2). “Për shembull, PDK-ja me programin e saj politik të quajtur Dekada e re - synohet, siç thuhet, të ketë program, një zhvillim të shpejtë ekonomik, krijimin e Fondit për punësimin dhe për

krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe përshpejtimin në integritet euro-atlantik” (Programi Qeverisës PDK, 2014). Kjo do të bëhej përmes disa hapave, si investimi në bujqësi, industri, forcimi i sektorit privat dhe tërheqja e investimeve të huaja. “Kështu, qëllimi themelor ishte tendenca për të forcuar ndërmarrjet e vogla / të mesme, për të zëvendësuar importet me produkte vendase” (Programi Qeverisës PDK, 2014). Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për sistemin e taksave, programi i këtij subjekti nuk përcaktonte qartë se çfarë forme e taksave do të përdore

Programi i LDK, ndryshe nga partitë e tjera, si pikë qendrore kishte zhvillimin ekonomik dhe një pjesë të madhe të programit të kësaj partie që merrej me këtë fushë (Programi qeverisës i LDK, 2014). LDK, si Parti me profilin e saj të qendrës së djathtë, përmes programit të saj, objektivat e saj të drejtuara drejt zhvillimit të sektorit privat, veçanërisht zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Kjo ka ndodhur për dy arsye, a) sepse 99% e ndërmarrjeve në Kosovë janë NVM (Programi qeverisës i LDK, 2014) dhe b) sepse NVM-të kanë të punësuar 80% të të punësuarve në sektorin privat dhe në këtë mënyrë synojnë rritja e elektoratit të partisë. Ndërsa PDK dhe LDK premtuan për mundësi të zhvillimit të NVM-ve, AAK, përmes programit të quajtur “Drejtimi i Ri” pretendoi diçka edhe më të madhe. Për sa i përket zhvillimit ekonomik, konsiderohej përdorimi i burimeve natyrore (industria e rëndë), tërheqja e investimeve të huaja direkte dhe për më tepër bërja e rregullimit të politikave të kreditit dhe kushteve për koncesion ose burime (Programi qeverisës AAK, 2014). ”E gjithë kjo do të bëhej përmes zhvillimit të minierave dhe energjisë. Politika e drejtpërdrejtë e Aleancës në këtë fushë do të jetë ndërtimi i termocentraleve të reja si për shembull “Kosova C”” (Programi qeverisës AAK, 2014). Dhe ndryshe nga partitë e tjera, Lëvizja Vetëvendosje thekson formën e saj për zhvillimin e

ndërmarrjeve prodhuese dhe zhvillimin e industrisë në një formë të ndryshme. Në programin e saj, kjo temë synonte, përmes forcimit të ndërmarrjeve publike, të fillonte rivitalizimin e ekonomisë së Kosovës (Programi i shkurtër i VV, pika 52, 2014). Sidoqoftë, programi i tij ishte disi kontradiktor. Për shembull, për sistemin zgjedhor dhe partiak në Kosovë, ndërsa, një nga objektivat programorë të Lëvizjes Vetëvendosje për sa i përket ekonomisë ishin gjithashtu lehtësira për diasporën shqiptare për të investuar në kompanitë publike dhe private (Programi i shkurtër i VV, paragrafi 49) , ata dukej se ishin kundër çdo privatizimi dhe dhënie me koncesion të ndonjë ndërmarrje publike (Programi i shkurtër i VV-së).

Programet elektorale të partive politike për pesë fusha të ndryshme

	Politika tatimore	Shëndetësia	Politika Jashtme	Edukimi	Zhvillimi Ekonomik
PDK	Sigurimi i një sistemi të thjeshtë tatimor (megjithatë nuk specifikohet qartë se cili sistem do të përdoret) Ulja e normave tatimore, përmes së cilës synohet stimulimi i bizneseve.	- Reformimi i sektorit të shëndetit, aplikimi i sigurimit shëndetësor. -Financimi i duhur dhe i qëndrueshëm i shëndetit.	- Ruajtja e sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues. -Forcimi i diplomacisë ekonomike. -Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. - Njohja e pavarësisë së Kosovës dhe integritetit në BE, NATO dhe KB.	-Edukimi i nxënësve, studentëve dhe mësuesve, në përputhje me ofertat e tregut të punës	-Krijimi i Fondit të Punës (200,000 vende të lira të punës) -Lehtësime fiskale dhe financiare. -Forcimi i diagramin publik-privat.
LDK	Përdorimi i një sistemi të thjeshtë tatimor, përmes shpërndarjes proporcionale të barrës tatimore	- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit shëndetësor, - Sistemi shëndetësor i financuar përmes rritjes së fondeve publike dhe partneritetit publik-privat	-Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare; -Integrimi brenda-shqiptar dhe bashkëpunim i ngushtë me bashkitë rajonale shqiptare	- Sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe arsimit në përputhje me tregun e punës. - Miratimi i sistemit “Mësimi gjatë gjithë jetës” dhe zhvillimi i sektorit privat të arsimit	-Zhvillimi ekonomik përmes zhvillimit të sektorit privat, me fokus në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).
LVV	Sistemi progresiv i taksave.	- Sigurimi shëndetësor për punonjësit e sektorit publik - i menaxhuar nga një kompani publike.	- Mbrojtja e interesave kombëtare të Kosovës dhe shqiptarëve. - Politika e Jashtme Unike drejt Shqipërisë. - Qasje e ndryshme për vendet që respektojnë shtetësinë e Kosovës nga ata që nuk e respektojnë atë.	-Edukimi publik në të gjitha nivelet duhet të jetë falas për secilin. - Krijimi dhe financimi i institucioneve shkencore për shkenca.	-Rritja ekonomike, punësimi dhe mirëqenia -Zëvendësimi i importeve me produkte vendore. -Kundër privatizimit dhe koncesionit të ndërmarrjeve publike

AAK	-Nuk do të ketë rritje të niveleve të taksave, por do të ketë një zgjerim për të përmbushur detyrimet fiskale. -Bizneset e reja që hapin 10 vende pune do të lirohen nga tatimi mbi fitimin për 3 vitet e para të punës	-Themelimi i fondit të sigurimit shëndetësor publik, i financuar nga Ministria e Shëndetësisë. -Ligji i ri për reformën shëndetësore dhe shërbimet cilësore për qytetarët	-Diplomacia si një strukturë e brendshme për sjelljet e investimeve. -Ruajtja dhe forcimi i marrëdhënieve me SH.B.A. - Integrimi në BE	-Rritja e buxhetit për arsimin. -Miratimi i sistemit Depolitizimi i mësimit gjatë gjithë jetës dhe arsimit të lartë	-Mbështetja e zhvillimit të burimeve natyrore (industria e rëndë) -Sigurimi i investimeve direkte të huaja. -Vendosja e një fondi garancie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
------------	--	--	---	--	--

Tabela 3. Programet qeverisëse të partive politike përkatëse për vitin 2014

Përkundër pikëpamjeve të ndryshme për këto parti politike në lidhje me fusha të ndryshme, disa nga pikat e përbashkëta të programeve të tyre ishin investimet e mundshme dhe hapja e vendeve të reja të punës, të cilat në realitet ishin objektiva të vështira për t'u arritur. Me nivelin e papunësisë në vend, të themi me 44%, nga të cilët ka afërsisht 70% të rinj të papunë (Raporti i UNDP, 2014), PDK dhe AAK prematuan 200,000 vende të reja pune secila, ndërsa LDK premtoi 120,000 vende të tilla pune. Fakti se përse punësimi në këto shifra nuk ishte i arritshëm, ka të bëjë me aftësinë e dobët ekonomike të administratës së Kosovës për të përmbushur premtimet për ato shifra (Raporti nga Komsioni Europian për Kosovën, 2015).

Subjektet më të mëdha politike shpalosnin programet e tyre politike kryesisht në bastionet e tyre qendrore dhe e orientuan strategjinë e tyre në dy fronte: njëri ishte i interesuar për ruajtjen e votave në bastionet e shtëpisë së tyre, ndërsa tjetri kishte të bënte me mundësinë e zgjerimit të elektoratit të tyre në tjetrin rajon. Kështu, në rastin e PDK-së një shembull tipik për të ilustruar këto fronte është deklarata e Presidentit të partisë dhe ish-kryeministrit Thaçi të bërë në rajonin Skenderaj ku ai deklaroi se “vota kundër PDK-së është një votë kundër Drenicës” (Fjala e Presidenti i PDK-së, Skenderaj, 2014).

Fronti i Dytë u pasua nga një numër i madh i vizitave të Presidentit të partisë në komunat ku partia nuk kishte aq shumë vota të mëdha në krahasim me subjektet e tjera politike. Përveç PDK-së, strategjia e shumicës së partive politike që garojnë në këto zgjedhje ishte e drejtuar kryesisht drejt frontit të dytë. Mungesa e ndarjes së saktë të programeve qeveritare në rajone të veçanta lë hapësirë për hile gjatë premtimeve të fushatës. Për shembull, PDK premtoi investime në spitale, dhe biznese të qyteteve të ndryshme, por projektet nuk figuruan në programin e kësaj partie (Fjalimi H. Thaçi në Ferizaj, 2014). LDK nuk ishte përjashtim për premtimet kryesore për investime (Programi qeverisës i LDK, 2014), megjithatë, programi i LDK-së ishte disi i lidhur me premtimet e bëra gjatë fushatës dhe kur ishte shkruar në programin e tyre. Në përgjithësi partitë politike në Kosovë janë të prirura të vendosin platforma tepër ambicioze dhe të japin premtime jorealiste elektoratit të tyre. Platformat e tyre nuk bazohen në ideologji dhe qëllime afatgjata. Ata përqendrohen në prioritetet e menjëhershme, siç janë rritja ekonomike dhe punësimi, të cilat nuk rezultojnë në masa konkrete. Platformat e partive të ndryshme politike janë shumë gjenerike, tingëllojnë pothuajse identike, sikur partitë të mos i kushtojnë energji dhe burime në zhvillimin e tyre. Partitë politike kanë filluar të shfaqin disa praktika ideologjike edhe pse ato nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë për pozicionet e partisë. Lidhja Demokratike është anëtare e Partisë Popullore të Popullit (EPP) e qendrës së djathtë për shumë vite; Lëvizjet Vetëvendosje është një parti e majtë, por mban pozicione nacionaliste; ndërsa është e vështirë të tregohen qëndrimet e partive tjera. Se sa efektive partitë politike komunikojnë ideologjitë dhe përparësitë e platformës të anëtarët e tyre është një shqetësim tjetër.

Bazuar në analizën e programeve politike, të këtyre partive, mund të thuhet se ato nuk kanë zhvilluar një fokus më të qartë ideologjik. Parimet e tyre rishikohen ose interpretohen

në varësi të zhvillimeve politik. Në këtë kontekst Partitë Politike në Kosovë shihen se kanë azhurnuar ose rishikuar parimet e tyre nga, ato janë përpjekur të gjejnë një ekuilibër midis qëndrueshmërisë dhe ndryshimi.

4.4 Ndikimi i Administratës Ndërkombëtare në vendimmarrjen e politikave lokale

Nivelet e përgjegjshmërisë së politikave mund të gjenden përgjatë spektrit që varijonë në periudha të ndryshme. Megjithatë mekanizmat e zbatimit të përgjegjshmërisë përbëjnë instrument i mirëfilltë efektiv në qeverisjen e Kosovës. Ky seksion do të hetoj se si ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë ndikoi në zbatimin e politikave dhe ndërhyrjen në elitat politike të Kosovës.

Së pari vetë ekzistenca e administratës ndërkombëtare parashikon një justifikim për aktorët politik lokalë, ku politikë bërja e tyre bëhet e bllokuar për shkak të paaftësisë së tyre për konsensus politik. Në rastin e Kosovës, administrata ndërkombëtare (UNMIK) ishte e strukturuar në katër nivele midis institucioneve të qeverisjes vendore. Kjo strukturë, e cila nën udhëheqjen e përgjithshme të PSSP-së, ndan përgjegjësi midis disa organizatave ndërkombëtare, d.m.th. vetë KB, UNHCR, OSBE dhe BE, është quajtur si “katër shtyllat”.

Së dyti, mbajtja në përgjegjësi e aktorëve politikë lokal ishte teje e kufizuar sidomos në fazën e ndërtimit të menjëhershëm të ndërtimit të shtetit.

Së treti mungesa e vullnetit të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë për të forcuar kapacitetet e standardeve të llogaridhënës.

Trashëgimia e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) vazhdon të ketë ndikim në sistemin politik të Kosovës. Sistemi partiak vazhdon të jetë i paqëndrueshëm, si në kuptimin ideologjik, ashtu edhe në formimin e qeverisë pas çdo cikli zgjedhor. Sistemi zgjedhor i përfaqësimit proporcional (PR) me një sistem elektorale me shumë anëtarë dhe vende të garantuara (20) për pakicat në parlament e bëjnë të pamundur të kenë një shumicë të qëndrueshme në Kosovë.

Administrata ndërkombëtare për të vendosur rregullin dhe përfaqësimin e strukturave sociale kujdesej që përmes mekanizmave ligjore të mbështesin ose imponojnë rregulla të caktuara, të cilat në raste të tjera nuk mund të vendosen pa imponim të jashtëm. Ishte e qartë se UNMIK ndante përgjegjësi administrative me elitat politike vendore. Në mungesë të ndonjë të dhëne të besueshme për nivelin e mbështetjes për secilin fraksion politik, PSSP-ja përfundimisht vendosi të fusë fraksionet e ndryshme politike shqiptare të Kosovës me kushte të barabarta.

“Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ishte në favor të marrëdhënieve të mira me LDK dhe udhëheqësin Rugova, duke iniciuar përpjekje për kthimin e Rugovës nga mërgimi (Romë-Itali), në mënyrë që të shmanget ndikimi i partisë pasardhëse të UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës)” (Tansey, 2009).

Kjo ndodhi sepse ata së pari donin të vendosnin ekuilibrat shoqërorë, më pas do të ishte më e lehtë të qeveriste vendin me partitë që konsiderohen si moderne. “Në të njëjtat mënyra si me Timorin Lindor, në Kosovë, një nga mënyrat e ndikimit të administratës ndërkombëtare në tranzicionin politik ndodhi përmes ndërmjetësimit të elitave në pushtet. Para dhe pas zgjedhjeve, UNMIK kishte ndërhyrë në garat midis partive politike dhe elitës, me qëllim të

formësimit të rezultateve zgjedhore, duke shmangur ndikimin e ndonjë partie apo etnie të vetme dhe promovimin e politikës moderne në Kosovë. UNMIK kishte formuar politikën kosovare përmes përzgjedhjes së bashkëbiseduesve vendor dhe përfshirjes ndërkombëtare në formimin e koalicioneve pas zgjedhjes” (Tansey, 2009).

Në disa aspekte, aktorët lokalë (partitë politike) dhe palët e interesuara ndërkombëtare (UNMIK dhe Ambasadat) ndoqën objektiva konkurrues, ndërsa bashkëpunimi ka qenë kryesisht i mirë. Përveç kësaj, në disa raste, PSSP-ja ndërhyri, veçanërisht për sa i përket disa subjekteve politike. Prandaj, vendasit dhe UNMIK-u në përgjithësi kishin më shumë marrëveshje sesa kundërshtime, duke përdorur kështu ndikimin e tyre ndërkombëtar.

Protektorati ndërkombëtar, mungesa e përcaktimit të statusit politik dhe marrëdhënieve me Serbinë, kanë përcaktuar kryesisht drejtimin ideologjik të partive politike në Kosovë.

Në drejtim të sqarimit të marrëdhënieve të partive politike me ideologjinë, disa nga arsytet që ndikuan negativisht në dështimin e profilizimit ideologjik të partive ishin frazat e mëposhtme: Liria, Pavarësia dhe Demokracia. Për më tepër, temat kryesore të adresuara nga partitë politike ishin: anëtarësimi në NATO dhe BE, zhvillimi ekonomik, ulja e papunësisë, sundimi i ligjit. Si rezultat, partitë brenda vetes në Kosovë ndryshojnë nga spektri i majta në të djathtë (Hofmeister, W and Grabow, K, 2011).

Sistemi partiak në Kosovë gjatë administratës ndërkombëtare në drejtim të vendimmarrjes, si dhe përcaktimit të rregullave të funksionimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve ishte i kufizuar. Partitë politike në Kosovë kishin kompetenca të kufizuara sepse fuqia e vërtetë ishte ushtruar nga UNMIK. UNMIK-u pati rolin kryesor në krijimin e bazës juridike, rrethanat

dhe mjedisin politik për të organizuar së pari zgjedhjet lokale dhe më vonë zgjedhjet parlamentare (UNMIK 2000). Për më tepër, vëmendje e veçantë i është kushtuar pajtimit dhe përfaqësimit multietnik në institucione, gjë që shpesh ishte jo proporcionale me situatën në terren. Si rezultat i angazhimit dhe interesit për përfshirje dhe pajtim të të gjitha komuniteteve në Kosovë, janë përdorur mekanizma për mbrojtje juridike për pakicat (Krasniqi, 2016).

Pavarësisht nga niveli i lartë i pranisë dhe qeverisjes ndërkombëtare, siç ishte në Kosovë, marrëdhënia dhe bashkëqeverisja me vendasit janë përcaktuese për suksesin e misionit. Përveç rivalitetit midis partive politike, në vendet e pas luftës nën administrimin ndërkombëtar, siç është Kosova, është e rëndësishme të kuptohet konteksti dhe divergjencat e tjera brenda shoqërisë. Nëse kultura nuk kuptohet në përgjithësi, dhe kultura politike në veçanti, duke marrë parasysh realitetin e tillë, atëherë është problem të ecni përpara dhe të keni një qeverisje të suksesshme (Krasniqi, 2016).

Sipas Tansey: Zhvillimet politike në Kosovë nuk u drejtuan ekskluzivisht nga bashkësia ndërkombëtare, por aktorët lokalë ishin pjesë e procesit. Politika lokale në Kosovë u karakterizua nga tre ndarje të lidhura me kontekstin historik dhe politik me Serbinë, gjë që ka ndikuar në formimi i aktiviteteve dhe përparësive të brendshme të UNMIK-ut ndarja ekziston midis shqiptarëve dhe serbëve, si dhe partive në Kosovë. Kjo ndikoi në ndarjen e mendimeve dhe veprimeve midis shqiptarëve dhe serbëve. Ajo gjithashtu ndikoi në mbajtjen e partive etnike dhe mungesës së ndonjë partie shumetnike. Pjesëmarrja serbe në proceset dhe strukturat e vetëqeverisjes në kohën e UNMIK ishte e kufizuar, duke bojkotuar zgjedhjet dhe institucionet qendrore. Ndarja e dytë është brenda vetë komunitetit

serb, ku disa ishin kundër bashkëpunimit me UNMIK dhe institucionet e Kosovës, ndërsa disa ishin në favor. Dhe ndarja e tretë ishte spektri politik i shqiptarëve të Kosovës brenda vetes, bazuar në historinë e konfliktit me Serbinë (Tansey O. , 2009). Duke analizuar rrethanat në për të cilat kanë kaluar Partitë Politike në Kosovë gjatë fazës së administrimit ndërkombëtar, mund të konkludojmë se atyre ju mungonte ndonjë ideologji dalluese. Për më tepër kjo paqartësi ka vazhduar të jetë trashëguese edhe pas shpalljes së Pavarësisë.

4.5 Efektet e globalizmit tek ideologjitë e partive politike në Kosovë

Shpesh, studiuesit kanë studiuar se si globalizmi ka pasur ndikim në ri konfigurim të pushtetit politik, i cili ka krijuar forma të reja të qeverisjes dhe politikës - si brenda shteteve ashtu edhe përtej kufijve të tyre (Held, 2000). Megjithatë, kohët e fundit, studimet në politikat krahasuese kanë vërejtur që globalizimi ka pasur një ndikim të madh politik në nivelin lokal / kombëtar (Held, 2005). Në gjurmim të kësaj agjendë kërkimore, vëmendja jonë përqendrohet në ndikimin e globalizmit në atë kombëtar dhe ideologjitë politike në Kosovë.

Globalizimi është një prirje e përgjithshme e denacionalizimit, ndarje e kufijve kombëtarë (Zürn, 2003). Globalizimi nuk është aspak një fenomen i ri (Osterhammel, J.; Petersson, N., 2005).

Held, vëren se globalizimi, në formën e tij të tanishme, ka tejkaluar shumë epoka të ngjashme historike në mënyrë sasiore si dhe në mënyrë cilësore (Held D., 2007). Duke përdorur qasjen strukturore të formimit të partive politike, mund të vëresh se si globalizmi prek strukturat themelore shoqërore që çojnë në formimin e partive (Van Biezen, 2005; Kitschelt H., 1992; Levy, 2004; Olson, 1998). Lipset dhe Rokkan (1967) vunë në dukje se ndarjet e thella sociologjike, ekonomike, kulturore dhe fetare në secilën shoqëri sigurojnë themelet për ndërtimin e sistemit partiak brenda tij (Lipset, S.; Rokkan, S, 1967). Si rezultat këto ndarje strukturore krijojnë dhe dallimet ideologjike. Kriesi (2012) zbuloi se globalizimi ka transformuar ndarjet kulturore në Evropën Perëndimore, ku politika e imigracionit ka përcaktuar një ndarje të re kulturore në dekadat e fundit në nivel kombëtar në Austri, Gjermani, Holandë, Zvicër, Angli dhe Francë (Kriesi, 2012). Njëzet e pesë vjetët

e fundit ka pasur tre tendenca të njëkohshme: intensifikimi i globalizmit ekonomik (Reimut Zohlnhöfer, Fabian Engler and Kathrin Dümig, 2017), një pakënaqësi në rritje me demokracinë përfaqësuese (Gideon Rahat, Ofer Kenig, 2018), dhe shumëzimi i procedurave të drejtpërdrejta demokratike në demokracitë e përparuara, më së shumti referendumat dhe nismat e qytetarëve (Marxer, 2015) Ndërsa ideologjia mund të ketë një efekt të fortë në kuptimin e qytetarëve për shkencën, është e paqartë se si bashkëvepron ideologjia me faktorë të tjerë ndërlikues, siç është arsimi, të cilat ndikojnë në kuptimin e informacionit të qytetarëve. Situata e ngjashme paraqitet edhe në Kosovë, ku partitë politike ende nuk janë strukturuar sipas ideologjive politike.

Partitë Politike të djathta, të majta, të qendrës, ekstrem të djathta, të majta në rrethanat e globalizimit, janë duke u nënshtruar. “Në kuadrin e doktrinës globaliste, si objektiv kryesor i veprimit është zvogëlimi i fushës së veprimtarisë së qeverive në raport me fluksin transnacional të kapitaleve si dhe reduktimi i sovranitetit nacional në marrjen e vendimeve në favor të fuqisë vendimmarrëse të institucioneve e të organizmave ndërkombëtare të tilla si: FMN-ja, Banka Botërore, OBT -ja, BE -ja, etj” (Lami, 2013). Nga shumë studiues vlerësohen politikat e ndjekura nga organizatat ndërkombëtare financiare si FMN, BB dhe OBT promovojnë politika të liberalizimit ekonomik - këto organizma kanë tendenca globalizuese të djathta. Duke ndjekur idetë e Anthony Giddens, i cili për "ngritjen e individualizmit të ri", ai argumenton se "transformimi i hapësirës dhe kohës" ka dobësuar thellësisht konceptin shtet-komb, duke “rigjeneruar identitetet lokale”, duke detyruar qeveritë kombëtare të punojnë në koalicione me njëri-tjetrin, me rajone, me organizata joqeveritare dhe korporata trans nacionale për të siguruar një formë e “qeverisjes” mbi

shoqërinë dhe ekonominë, e cila nuk është më e drejtë e posaçme e qeverive (Giddens, 1998).

Strukturat ekonomike të krijuara nga denacionalizimi i kufijve, krijojnë potenciale politike të gatshëm për mobilizimin e aktorëve politikë dhe partive në veçanti. Kushtëzuar me pozicioni i tyre në lidhje me ndarjet ekzistuese ose çështjeve të reja, partitë mund të ndryshojnë politikën e tyre për arsye strategjike, duke iu përgjigjur ndryshimeve të shkaktuara nga globalizimi.

Globalizimi mund të ndikojë në transformimin e ideologjive politike përmes disa ekzogjeneve. “Së pari, globalizimi besohet se krijon forma të reja të konkurrencës midis qytetarëve të atij vendi.

Së dyti, argumentohet që qytetarët marrin qëndrime për çështje të që janë të nxitur nga rritja e tregut, integritit kulturorë, etnik dhe global” (Brown, P.; Green, A.; Lauder, H., 2001).

Së treti, partitë politike përfshijnë çështje të reja në programet e tyre elektorale me një dëshirë për t'u bërë thirrje votuesve të tyre të vjetër dhe grupit të ri të mundshëm për përkrahje (Inglehart, 1984). Shkencëtarët politikë kanë propozuar një bollëk mekanizmash me të cilët globalizmi gjeneron efekte në secilën shoqëri përgjatë linjave ekonomike, kulturore dhe politike (Sparke, 2004). Në aspektin ekonomik, problemet me të cilat përballen shtetet me demokraci të re si rasti i Kosovës, i shtynë këto vende të zbatojnë një paketë rregulluese e ristrukturimit ekonomik e përshkruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. “Globalizimi ekonomik ndikon fuqishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare përmes procesit të integritit të tregut, mallrave, shërbimeve

dhe të financave argumenton Eric Hobsbawm” (Hobsbawm, 1994), mirëpo, kjo nuk nënkupton se kemi vetëm një përmbajtje të marrëdhënieve ndërkombëtare në raportet e jashtme dhe të brendshme të shteteve.

Anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore do t'i krijojë Kosovës siguri ekonomike, do ta rrisë imazhin e saj në tregjet financiare dhe pritet që shumë investitorë të huaj të futen në tregun e Kosovës me një besim shumë më të madh.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Kosova karakterizohet nga infrastruktura e pamjaftueshme e transportit, lidhje shumë e kufizuar me pjesën tjetër të botës, dhe furnizimi i pamjaftueshëm dhe jo i rregullt i energjisë, duke kërkuar që Kosova të investojë në më shumë shpenzime të infrastrukturës publike (FMN, 2018).

Kosova ka përjetuar një imponim të jashtëm të politikës shtrënguese dhe strukturore të reformës përmes organizatave ndërkombëtare, siç janë BE dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ose siç kërkohet në mënyrë implicite nga tregjet financiare ndërkombëtare. Kjo ndërhyrje në hapësirën për manovrim të parlamentit dhe qeverive ka ndikuar që partitë politike në Kosovë të mos jenë në gjendje të vendosnin në mënyrë efektive për politikën kryesore ekonomike dhe sociale, për institucionet shtetërore ekonomike dhe të mirëqenies.. Ngjashëm, sipas Bankës Botërore, strategjia e tanishme e rritjes së Kosovës duhet të përqendrohet në adresimin e infrastrukturës energjetike, krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat, pajisjen e popullatës së saj të re me aftësitë e duhura për t'i bërë ata tërheqës për punëdhënësit, ndërtimin e qeverisjes dhe sundimin e ligjit (World Bank, 2017). Bashkëpunimi i Kosovës me organizatat ekonomike

(FMN-në dhe Bankën Botërore) ka rezultuar e suksesshme si përcaktues për menaxhimin e financave publike dhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomikë të vendit.

Qeveria e Kosovës është zotuar se do t'i trajtojë me kujdes rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Programi i Qeverisë së Kosovës me FMN-në, që i ka sjellë Kosovës stabilitet ekonomik dhe financiar. “Programi me FMN-në ka kontribuar në rritjen e konfidencës së bizneseve dhe investitorëve të jashtëm në ekonominë vendore. Në veçanti u rrit gatishmëria e bankave zhvillimore për të financuar projekte zhvillimore të Qeverisë së Kosovës. Ne jemi të vendosur të vazhdojmë me këtë program dhe do të trajtojmë më shumë kujdes rekomandimet e FMN-së” (Hoti A. i., 2016).

Prezenca e FMN – së në Kosovë me rekomandimet për sistemin financiar të Kosovës shihet si mjaft pozitive qoftë nga pikëpamja këshilluese por edhe imponuese. Mirëpo, nëse e analizojmë këtë rol të FMN –së nga këndvështrimi ideologjike vërejmë se roli i saj në Kosovë kufizon në masë të madhe mundësinë për ti qëndruar strikt një profili të caktuar ideologjik.

Duke qenë anëtar i FMN-së, shteti i Kosovës do të gëzojë një qasje edhe më të madhe në bashkëpunim global monetar dhe në tregun ndërkombëtar. “Me këtë vendim vijnë për shtetin e Kosovës mundësi më të mëdha, por edhe përgjegjësi shumë serioze” (Thaçi H. K., 2009).

Rasti kur mund të testohet ky aspekt i FMN janë proceset e privatizimeve të ish-ndërmarrjeve publike. Të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pothuajse u privatizuan sipas rekomandimeve të FMN -së.

Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë zyrat e tyre në Kosovë që nga përfundimi i luftës. Këto dy organizata ndërkombëtare e ndihmuar me të holla disa projekte të vogla, ndërsa zyra e FMN-së ka mbikëqyrur buxhetin e Kosovës. Kjo në një masë të konsiderueshme ka ndikuar edhe “drejtimin” e politikave qeveritare të qeverisë.

Fondi Monetar Ndërkombëtar përmes programeve të saja nuk përkrah fonde specifike ekonomike, por ky mekanizëm përkrah iniciativat ekonomike në përgjithësi dhe me rastin e lejimit të kredive të ndryshme ky mekanizëm kërkon që të bëhen reforma të caktuara në politikën fiskale. Shembull me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve apo me rastin e deficitit në bilancin e pagesave. Pra, esenca e financimit nga FMN-ja ka të bëjë me financimin e përgjithshëm ekonomik, shembull kur shtetet nuk kanë likuiditet të mjaftueshëm për t'i përmbushur obligimet që kanë ndaj botës së jashtme. Që prej anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar në vitin 2009 deri më sot, politika, institucionet e Kosovës e kanë trajtuar gjithçka zyrtarisht marrëdhënien mes Kosovës dhe FMN-së.

“Kosova, me pretendimet e saja për ta monitoruar ky institucion i rëndësishëm ndërkombëtar, gjithsesi duhet të dëshmojë rrugëtimin e sajë integruar, por jo edhe atë konfliktuoz, siç ka bërë me rastin e mospërfilljes së standardeve për ngritjen e pagave” (Maloku F. P., 2011). Mbetet për tu parë se cilën nga rrugëtimet do ta marrë Kosova në periudhën që po hyjmë, ani pse ka shumë dilema të shfaqura kohëve të fundit nga ekspertët e ndryshëm!? Rritja prej 2.7 për qind e ekonomisë së Kosovës për vitin 2014, është vlerësuar me tone jo-optimiste nga banka qendrore e vendit. Me të ardhur në pushtet LDK-ja në 2014 thelluan më tej reformat neoliberales të nisura nga qeveria e PDK. Nën udhëheqjen e institucioneve ekonomike ndërkombëtare veçanërisht të FMN –së, Lidhja

Demokratike e Kosovës ndërmori një sërë reformash dhe nënshkruante një sërë marrëveshjes bilaterale dhe multilaterale në funksion të liberalizimit të tregut dhe lehtësimit të futjes së mallrave të importit. Ky qëndrim i tyre, tërhoqi shtetin nga shumë aspekte të jetës ekonomike dhe sociale, dhe e shndërroi atë në një qeverisje tipik të djathtë. Marrëveshja me FMN-në e lejon Kosovën të hyjë në deficit.

Me FMN është arritur pajtimi për ndryshimin e rregullave fiskale përkitazi me deficitin buxhetor, normalisht duke e mbajtur këtë rregull fiskale për shpenzimet e rregullta buxhetore por duke lejuar që përtej kësaj rregulle fiskale, ne si vend i ri me një ekonomi në zhvillim me plot nevoja të hyjmë në marrëveshjen ndërkombëtare për të financuar projekte zhvillimore që i nevojiten Kosovës (Hoti A. M., 2015). “Në nivele ndërkombëtare kur flitet për FMN –në dhe për vlerësimin e saj, nga shumë homolog të së majtës cilësohet si simbol i liberalizmit, xhandari i tmerrshëm financiar, makthi i shumë qeverive e vendeve, promotorë e neoliberalizmit etj, ndërsa tek ne FMN – ja shikohej në raport me administrimin e financave publike në prag zgjedhjesh së përgjithshme” (Lami, 2013).

Debatet se si duhet të vendosen raportet me FMN-në nuk janë parë gjithnjë mbi parimet ideologjike por më tepër nga interesat pragmatike të partive politike.

“Aq më shumë kur roli i FMN në kuadrin e të famshmit ”konsensus i Washingtonit” në shumë raste u cilësua si imponues si drastik, jo social, imponues i liberalizmit ekstrem, kufizim i mundësisë së qeverive për të vendosur lirisht për politikat e tyre të zhvillimit ekonomiko social etj” (Financial Development Report, 2015).

Partitë politike të majta shprehin shqetësime për rolin e FMN-së kundrejt tendencave të qeverisë për të shpërdoruar fondet publike në shërbim të fushatës elektorale sesa për

ndikimin e saj në funksion të ruajtjes së identitetit të saj. “Kjo forcë, ndryshe nga partitë si motra në perëndim, i interesonte më shumë roli kontrollues i këtij institucioni sesa ndikimi që sjell në adresë të shumë grupeve në nevojë që vuajnë politikat e diktuara nga ky institucion” (Lami, 2013).

Nga kjo perspektivë, mund të thuhet institucionet e Kosovës kanë ndjekur rekomandimet e FMN-së duke ndikuar kështu në sjelljen e partive politike në raport me identitete e tyre të mundshme ideologjik. Secila nga partitë politike që kanë qenë në pushtet është dashur të ndjekë rekomandimet dhe udhëzimet e FMN-së saj me qëllim përfitimin nga ekspertiza e saj dhe fondet që akordonte ajo për shtetet bashkëpunuese. Kjo sjellje e partive politike të Kosovës mundet të justifikohet duke ditur nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

4.6 Perceptimi i elektoratit në Kosovë mbi raportin ndërmjet ideologjisë dhe partive politike

4.6.1 Metodologjia e anketimit

Me qëllim të testimit empirik të raportit të Ideologjisë me partitë politike në Kosovë si pjesë të studimit, është gjykuar që të zhvillohet edhe një anketim, për të kuptuar se si e perceptonte elektorati i Kosovës raportin e partive politike me ideologjinë.

Ky anketim si rregull ka shërbyer për të mbledhur informacion për të testuar empirikisht të kuptuarit e raportit të partive politike me Ideologjinë nga këndvështrimi i elektoratit.

Në rastin e studimit tonë është konstatuar si problem partitë politike në Kosovë kanë një lidhje të dobët me Ideologjinë. Këtu mund të ngrihet pyetja:

Nga këndvështrimi i elektoratit, si sillen Partitë Politike në Kosovë në raport me Ideologjinë?

Ky anketim ka për qëllim testimin empirik të supozimit bazë, duke ofruar të dhëna që qasjen teorike e cila analizon faktorët që e bëjnë të padukshme ideologjinë tek partitë politike në Kosovë.

Anketa nuk ka parashtruar pyetje të hapur për prirjet ideologjike, por i parashtroi 12 (dymbëdhjetë) pyetje specifike për një varg çështjesh. Secila përgjigje përshtatet me një sistem të pikëve, e cila pastaj paraqitet në një diagram.

Për t'u siguruar që pyetësi mund të shërbejë si mjet i besueshëm për këtë detyrë, ne së pari identifikojmë ideologjitë kryesore politike, si do bëjmë një hulumtim të thellë të mendimeve të cilat i përfaqësojnë Partitë Politike në Kosovë.

Për shkak të natyrës komplekse që mbartë studimi ynë, si çdo studim tjetër është e pamundur që të jepet ndonjë analizë shteruese, por së paku synohet që në kuadrin teorik të ofrohet një kontribut modest në drejtim të leximit të raportit të partive politike në Kosovë me ideologjinë. Ndërsa në kuadrin empirik, të ofrohen rezultate të analizuara të të dhënave të grumbulluara nga një anketim i bazuar tek perceptimi që ka elektoratit i Kosovës për raportin midis partive politike në Kosovë me ideologjinë.

Kështu që mbetet vetëm rruga e testimit empirik me anë të testimit empirik të indikatorëve të dedukuara prej tij. Pra, nga ky supozim janë nxjerrë logjikisht një sërë indikatorësh, të tillë që lejojnë testim empirik të drejtpërdrejtë. Në varësi të rezultatit të këtij testimi do të gjykohet lidhur me provueshmërinë ose jo të supozimit bazë, gjë që do të përmbyllë praktikisht (por jo logjikisht!) procesin e testimit empirik të supozimit në fjalë.

Në këto kushte janë deduktuar ndikimet si më poshtë:

Indikatori 1: Programet e partive politike në Kosovë nuk përputhen me profilet e tyre ideologjik, atëherë pjesa e elektoratit të tyre që voton në mënyrë ideologjike do të priret t'i votojë më pak ato.

Indikatori 2: Partitë vendosin në programet e tyre elektorale politika që nuk përputhen me politikat e krahut ideologjik që ato deklarohen, atëherë ato rrezikojnë të humbasin mbështetje nga elektorati i tyre.

Indikatori 3: Programet e partive politike që nuk përputhen me veprimet e tyre në qeverisje atëherë pjesa e elektoratit të tyre që voton në mënyrë ideologjike do të priret t'i

votojë më pak ato.

Prej këtij indikatorit disa të përgjithshëm mund të deduktohen disa indikatorë më të thjeshta dhe më të drejtpërdrejta për testim empirik si vijon.

Indikatori 3.1: Nëse programi i PDK-së nuk përputhen me veprimet e saja në qeverisje atëherë pjesa e elektoratit të tyre që voton në mënyrë ideologjike ka të ngjatë t'i votojë më pak ato.

Indikatori 3.2: Nëse programi i LDK-së nuk përputhen me veprimet e saja në qeverisje atëherë pjesa e elektoratit të tyre që voton në mënyrë ideologjike ka të ngjatë t'i votojë më pak ato.

Indikatori 3.3: Nëse programi i Lëvizjes Vetëvendosje nuk përputhen me profilin e saj ideologji, atëherë pjesa e elektoratit të tyre që voton në mënyrë ideologjike ka të ngjatë t'i votojë më pak ato.

Testimi i indikatorit 1: Treguesit e programeve të politikave të djathta dhe të majta. Raporti i programeve të PDK dhe LDK dhe Lëvizjes Vetëvendosje me këto tregues. Opinioni që ka elektorati lidhur me përputhjen e programeve me treguesit në fjalë dhe kostoja elektorale që parashikon ai në rast mospërputhje midis tyre.

Testimi i indikatorit 2: Treguesit e programeve të politikave të djathta dhe të majta. Raporti i programeve të PDK dhe LDK dhe Lëvizjes Vetëvendosje me këto tregues. Opinioni që ka elektorati lidhur me përputhjen e programeve me treguesit në fjalë dhe kostoja elektorale që parashikon ai në rast mospërputhje midis tyre.

Testimi i indikatorit 3: Opinione të anketuesëve lidhur me perceptimin nga elektorati i PDK-së i dallimeve midis programit dhe veprimeve të parive në qeverisje.

Testimi i indikatorit 3.1: Opinione të anketuesëve lidhur me perceptimin nga elektorati i

LDK i dallimeve midis programit dhe veprimeve të LDK-së në qeverisje.

Testimi i indikatorit 3.2: Opinionet e anketuesëve lidhur me perceptimin nga elektorati i LDK i dallimeve midis programit dhe veprimeve të LDK-së në qeverisje.

Testimi i indikatorit 3.3: Opinionet e anketuesëve lidhur me perceptimin nga elektorati i VV i dallimeve midis programit dhe orientimit të tyre ideologjik.

Nga ky anketim, përveç të dhënave që synojnë testimin empirik të supozimit bazë, janë marr edhe të dhëna që përforcojnë qasjen teorike e cila analizon faktorët që e bëjnë të padukshme ideologjinë tek partitë politike në Kosovë.

Përcaktimi i kampionit: Me që Kosova ka vetë 1 (një) zonë zgjedhore, përcaktimi i kampionit është bërë me metodën e kampionit rastësor. Më konkretisht janë përzgjedhur anketuesë nga qytete të ndryshme të Kosovës. Në këto kushte u zbatua një kampionim me kuotë (bazuar në grup moshat dhe gjininë), me që pyetësi i përdorur përfshinte pyetje delikate që kishin të bënin me partitë, programet e tyre, krahun politik të partive dhe të anketuesëve etj. Periudha e anketimit zgjati 20 ditë me që rast janë intervistuar gjithsej 710 anketuesë të 5 grup moshave të ndryshme (18-25 vjeç, 26-35 vjeç, 36-45 vjeç, 46-55 vjeç dhe mbi 55 vjeç), nga të cilët rreth 49% ishin femra dhe afro 51% meshkuj.

Pas përfundimit të anketimit të anketuesëve, janë mbledhur të dhënat dhe më pas janë hedhur në një bazë të të dhënash. Të gjitha të dhënat janë hedhur në program SPSS.20. Ato do t'i gjeni si shtojca në fund të punimit.

4.6.2 Rezultatet e anketimit

Nëpërmjet kësaj ankete do të paraqesim rezultatet e interpretimit të të dhënave që ofrojnë tabelat e frekuencave dhe ato të kryqëzuara. Në këtë paraqitje do të jepen, në përgjithësi, të dhënat nga tabelat me një variabël dhe ato me dy variabla që kryqëzohen dhe vlerat e indikatorëve të madhësisë së shoqërimit statistikor Cramer's V dhe Approx. Sig. te tabela e Symmetric Measures. Pas paraqitjeve të të dhënave do të bëhet interpretimi i këtyre vlerave në lidhje me shoqërimet statistikore domethënëse të mundshme të tyre dhe raportin testues empirik ndaj indikatorëve në shqyrtim.

Për të kuptuar rezultatet e anketimit që flasin për sjellje votuese ideologjike ose pragmatiste, po sjellim të dhënat e tabelës që jep përgjigjet ndaj pyetjes: “A keni bindje të caktuar politike?”

Kemi rezultatet si në vijim:

A keni bindje të caktuar politike?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	78	11,0	11,0	11,0
	Po, në një masë të madhe	305	42,9	42,9	53,9
	Po, disi	225	31,6	31,6	85,5
	Më shumë, jo	62	8,7	8,7	94,2
	Aspak	25	3,5	3,5	97,7
	Nuk e di	16	2,3	2,3	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

Nga përgjigjja e anketueseve kuptojmë se njerëzit kanë bindje të caktuar politike në masën 85.5 kundrejt 14.5 të cilët e mohojnë atë. Pra raporti ndërmjet tyre është 5.9 :1 në të mirë të pohimeve. Sipas kësaj mund të thuhet se elektorati i Kosovës mund të supozohet në pjesën e tij më të madhe si politik.

Në pyetjen se “A i njihni programet e partive politike në vendin tonë?”, kemi këto të dhëna:

A i njihni programet e partive politike në vendin tonë?					
		Frequenc y	Percent	Valid Percent	Cumulativ e Percent
Valid	Po, për të gjitha partitë	53	7,4	7,4	7,4
	Po, për shumicën e tyre	122	17,1	17,1	24,5
	Po, për disa prej tyre	293	41,3	41,3	65,8
	Po, vetëm për një parti	14	1,9	1,9	67,7
	Jo, për asnjë parti	205	29,0	29,0	96,8
	Nuk e di	23	3,2	3,2	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

Nga këto të dhëna mund të shihet se afro 68% e anketuesëve raportojnë se njohin programet e të paktën një partie politike (nga një parti deri tek të gjitha partitë) kundrejt afro 33% që deklarojnë se nuk njohin asnjë program të partive politike. Pra, raporti ndërmjet tyre është 2.1 :1 në të mirë të njohjes së programeve të partive politike.

Në pyetjen se “A dini të dalloni nëse programi i një partie i përket krahut politik që ajo pretendon t’i përkas?”, kemi këto të dhëna:

A dini të dalloni nëse programi i një partie i përket krahut politik që ajo pretendon t’i përkas					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	41	5,8	5,8	5,8
	Po, në një masë të madhe	92	12,9	12,9	18,7
	Po, disi	261	36,8	36,8	55,5
	Më shumë, jo	247	34,8	34,8	90,3
	Aspak	46	6,5	6,5	96,8
	Nuk e di	23	3,2	3,2	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

Nga këto të dhëna mund të shihet se 55.5% e njerëzit në përgjithësi mund të dallojnë nëse programi i një partie politike i përket krahut që ajo pretendon se i përket kundrejt 44.5% që e mohojnë atë. Pra, raporti ndërmjet tyre është 1.1 :1 që do të thotë elektorati deri diku bënë dallimin mes programit dhe profilit ideologjik.

Në pyetjen se. “Sipas jush, a gjykoni se duhet ndëshkuar me mos votim ndonjë parti thjesht për faktin se programi i saj nuk përputhet plotësisht ose në një masë të madhe me orientimin ideologjik që ajo pretendon t’i përkasë?” kemi këto të dhëna:

Sipas jush, a gjykoni se duhet ndëshkuar me mos votim ndonjë parti thjesht për faktin se programi i saj nuk përputhet plotësisht ose në një masë të madhe me orientimin ideologjik që ajo pretendon t’i përkasë?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	280	39,4	39,4	39,4
	Po, në një masë të madhe	114	16,1	16,1	55,5
	Po, disi	128	18,1	18,1	73,5
	Më shumë, jo	82	11,6	11,6	85,2
	Aspak	23	3,2	3,2	88,4
	Nuk e di	37	5,2	5,2	93,5
	Pa përgjigje	46	6,5	6,5	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

Nga këto të dhëna **73.6%** deklarojnë pozitivisht në pyetjen tonë, kundrejt **26.4%** që japin përgjigje negative kësaj pyetje. Pra, raporti ndërmjet tyre është **2.7 :1** që do të thotë senë të mirë të përgjigjeve pozitive. Nga kjo e dhen, mund të bëhet interpretimi se kemi një konfirmim të një sjellje të votuesve pragmatik në nivel të anketueseve. Ky raport përbën një rezultat **negativ** të testimit empirik të **indikatorëve 1**.

Në pyetjen se: “Me aq sa ju dini, si e konsideroni PDK-s, si parti:” Kemi këto të dhëna:

Me aq sa ju dini, si e konsideroni PDK-n, si parti:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Në ekstremin e majtë	48	6,8	6,8	6,8
	Në krahun e majtë	112	15,8	15,8	22,6
	Në qendrën e majtë	39	5,5	5,5	28,1
	Në qendrën e djathtë	23	3,2	3,2	31,3
	Në krahun e djathtë	46	6,5	6,5	37,7
	Në ekstremin e djathtë	32	4,5	4,5	42,3
	Në asnjë krah	67	9,4	9,4	51,6
	Tjetër	19	2,6	2,6	54,2
	Nuk e di	205	29,0	29,0	83,2
	Pa përgjigje	28	3,9	3,9	87,1
	Tjetër: askund	34	4,8	4,8	91,9
	Tjetër: nuk dalloj qartë	57	8,1	8,1	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

Nga këto të dhëna, njerëzit e konsiderojnë PDK-n si parti e krahut të majtë me 28.1% kundrejt 14.2% që e rëndësinë atë si parti e krahut të djathtë (raporti 1.98: 1) dhe 14,2% që nuk e rendisin PDK në asnjë krah. Megjithatë rreth 8% e anketuesëve nuk dallojnë qartë orientimin ideologjik të kësaj partie. Pra, nga këto të dhëna mund të flitet se ka një paqartësi për identitetin ideologjik të kësaj partie.

Në pyetjen se: “Me aq sa ju dini, si e konsideroni LDK-në, si parti:” kemi këto të dhëna:

Me aq sa ju dini, si e konsideroni LDK-në, si parti:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulati ve Percent
Valid	Në ekstremin e majtë	13	1,9	1,9	1,9
	Në krahun e majtë	9	1,3	1,3	3,2
	Në qendrën e majtë	46	6,5	6,5	9,7
	Në qendrën e djathtë	243	34,2	34,2	43,9
	Në krahun e djathtë	151	21,3	21,3	65,2
	Në ekstremin e djathtë	30	4,2	4,2	69,4
	Në asnjë krah	48	6,8	6,8	76,1
	Tjetër	4	,6	,6	76,8
	Nuk e di	131	18,4	18,4	95,2
	Askund	12	1,6	1,6	96,8
	Tjetër: nuk dalloj qartë	23	3,2	3,2	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

9,7% që e konsiderojnë si parti e krahut të majtë kundrejt **59.7%** (**raporti 1: 6,15**)

deklarojnë LDK është e pozicionuar si parti e krahut të djathtë dhe **8,4%** që nuk e rendisin atë në asnjë krah. Pra, janë afro **15%** që nuk e perceptojnë LDK si parti e krahut të djathtë.

Kjo tregon se ka paqartësi në identitetin ideologjik të kësaj partie.

Në pyetjen se: “Me aq sa ju dini, si e konsideroni Lëvizjen VETËVENDOSJE, si parti:”

kemi këto të dhëna:

Me aq sa ju dini, si e konsideroni Lëvizjen VETËVENDOSJE, si parti:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Në ekstremin e majtë	179	25,2	25,2	25,2
	Në krahun e majtë	196	27,5	27,5	38,7
	Në qendrën e majtë	101	14,2	14,2	42,9
	Në qendrën e djathtë	14	1,9	1,9	44,8
	Në krahun e djathtë	12	1,6	1,6	46,5
	Në ekstremin e djathtë	25	3,5	3,5	50,0
	Në asnjë krah	58	8,1	8,1	58,1
	Tjetër	12	1,6	1,6	59,7
	Pa përgjigje	46	6,5	6,5	96,1
	Tjetër: askund	38	5,3	5,3	96,5
	Tjetër: nuk dalloj qartë	29	4,1	4,1	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

66,9% e anketuesëve e perceptojnë Lëvizjen Vetëvendosje si parti e krahut të majtë kundrejt **7%** (**raporti 9,5:1**) e konsiderojnë si parti e krahut të djathtë dhe, **13,4%** që deklarojnë se nuk i përket asnjë krahu ideologjik. Pra, rreth **20,4%** nuk e perceptojnë Lëvizjen Vetëvendosje si parti e krahut të majtë. Kjo tregon se megjithëse ka një pëqindje të lartë që e konsiderojnë si parti e Majtë, megjithatë ka një paqartësi në identitetin ideologjik të kësaj partie.

Në pyetjen se: “A mendoni se veprimet e PDK-së në qeverisje bien ndesh me orientimin ideologjik që ajo pretendon se i përket?” Kemi këtë rezultat:

A mendoni se veprimet e PDK-së në qeverisje bien ndesh me orientimin ideologjik që ajo pretendon se i përket					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	623	87,7	87,7	87,7
	Jo	87	12,3	12,3	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

87.7 % e anketueseve mendojnë se ka mospërputhje midis veprimeve të PDK-s në dhe orientimit ideologjik që ajo pretendojnë se i përket kundrejt **12.3%** e atyre që e mohojnë këtë. Raporti midis tyre është **7.1 :1** në të mirë të pohimit.

Në pyetjen se: ” A gjykoni se elektorati duhet të reagoj me mos votim për PDK-n meqë ka mospërputhje midis veprimeve në qeverisje dhe orientimit ideologjike që PDK pretendon se i përket?”, kemi këtë rezultat:

A gjykoni se elektorati duhet të reagoj me mos votim për PDK-n meqë ka mospërputhje midis veprimeve në qeverisje dhe orientimit ideologjike që PDK pretendon se i përket?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	30	4,2	4,8	20,7
	Po, në një masë të madhe	44	6,2	7,0	76,8
	Po, disi	123	17,4	35,3	91,0
	Më shumë, jo	220	31,0	20,6	95,2
	Aspak	128	18,0	19,8	96,1
	Nuk e di	46	6,5	7,4	98,7
	Pa përgjigje	32	4,5	5,1	100,0
	Total	623	87,7	100,0	
	Missing system Total	87	12,3		
			100		

47,1% e anketuesëve që mendojnë se veprimet e PDK-s në qeverisje bien ndesh me programet e deklaruar gjatë fushatave zgjedhore mendoj se një mospërputhje e tillë do të ndikoj në mosvotimin e elektoratit për këtë parti në zgjedhje të radhës. Ndërsa, **40,4%** e anketuesëve që pohojnë se ka mospërputhje midis programit të PDK dhe veprimeve të PDK në qeverisje, nuk mendojnë se elektorati ka për të reaguar me mos votim për këtë parti në zgjedhje të radhës. Pra, raporti ndërmjet tyre është **1.2 :1** në të mirë të opsionit të mos votimit. Pra ky raport tregon për një rezultat pozitiv të testimit empirik të **indikatorin 3.1**.

Në pyetjen se: “A mendoni se veprimet e LDK-së në qeverisje bien ndesh me orientimin ideologjik që ajo pretendon se i përket?”. Kemi këto të dhëna:

A mendoni se veprimet e LDK-së në qeverisje bien ndesh me orientimin ideologjik që ajo pretendon se i përket					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	504	71,0	71,0	71,0
	Jo	206	29,0	29,0	100,0
	Total	710	100,0	100,0	

71.0 % e anketueseve mendojnë se ka mospërputhje midis veprimeve të LDK-s në qeverisje me Programet e deklaruar gjatë fushatave zgjedhore, kundrejt **29,0 %** e atyre që e mohojnë këtë. Raporti midis tyre është **7.1 :1** në të mirë të pohimit.

Në pyetjen se: “A gjykoni se elektorati duhet të reagoj me mos votim për LDK-n meqë ka mospërputhje midis veprimeve në qeverisje dhe orientimit ideologjike që LDK pretendon se i përket?”. Kemi këto të dhëna:

A gjykoni se elektorati duhet të reagoj me mos votim për LDK-n meqë ka mospërputhje midis veprimeve në qeverisje dhe orientimit ideologjike që LDK pretendon se i përket?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	53	7,4	10,4	95,2
	Po, në një masë të madhe	133	18,7	26,4	76,8
	Po, disi	101	14,2	20,0	91,0
	Më shumë, jo	183	25,8	36,4	20,7
	Aspak	7	1,0	1,4	96,1
	Nuk e di	18	2,6	3,6	98,7
	Pa përgjigje	9	1,3	1,8	100,0
	Total	504	71	100,0	
Missing system		206	29,0		
Total		710	100		

56,8 % e anketueseve mendojnë se veprimet e LDK-s në pushtet nuk përputhen me programet e deklaruar gjatë fushatave zgjedhore, mendojnë se elektorati do të reagoj me mosvotim për këtë parti në zgjedhje të radhës. Ndërsa, **37,8 %** që pohojnë se ka mospërputhje mes veprimeve të qeverisjes dhe programit të deklaruar në fushata zgjedhore mendojnë se elektorati do të reagoj me mos votim për këtë parti në zgjedhje të radhës.

Pra raporti mes tyre është **1.5 :1** në të mirë të opsionit të mos votimit.

Ky raport tregon për një rezultat pozitiv të testimit empirik të **indikatoreve 3.2.**

Në pyetjen se: “Sipas jush, a mendoni se ka mospërputhje midis programit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe orientimi ideologjik që ajo pretendon se i përket?”. Kemi këto të dhëna:

Sipas jush, a mendoni se ka mospërputhje midis programit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe orientimi ideologjik që ajo pretendon se i përket?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po, plotësisht	112	15,8	31,4	31,4
	Po, në një masë të madhe	50	7,1	14,1	45,5
	Po, disi	67	9,4	18,6	64,1
	Më shumë, jo	78	11,0	21,8	85,9
	Aspak	25	3,5	7,1	92,9
	Nuk e di	25	3,5	7,1	100,0
	Total	337	50,3	100,0	
Missing	System	373	49,7		
Total		710	100,0		

Nga tabela kuptojmë se **64.1% e anketueseve** që pohojnë se ka mospërputhje midis programit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe orientimit ideologjik që ajo pretendon se i përket elektorati duhet të reagoj me mos votim për këtë parti në zgjedhje të radhës. Ndërsa, **7.1%** e anketueseve që pohojnë se ka mospërputhje midis programit të VV dhe orientimit ideologjik që ajo pretendon se i përket.

Raporti midis tyre është 9.0 :1 në të kundër të opsionit të mos votimit. Pra edhe në këtë rast kemi një **rezultat negativ** të testimit empirik.

4.6.3 Interpretimi i rezultateve të anketimit

Duka analizuar rezultatet e mësipërme kemi shqyrtuar në veçanti rezultatet e testimit empirik të atyre indikatorëve që lidhen drejtpërdrejt me testimin empirik të supozimit bazë

A. Lidhur me **Indikatorin 1** kemi rezultatet testimit empirik që dalin nga tabelat e kryqëzimit të tresheve të variablave që lidhen me PDK dhe LDK.

- Nga tabelat e kryqëzuara treshe që lidhen me PDK del se kemi 2 teste negative.
- Kurse nga tabelat e kryqëzuara treshe që lidhen me LDK del se kemi 2 teste pozitive.

Duke analizuar tabelat e frekuencës që jep të dhënat lidhur me përgjigjet ndaj pyetjes A mund të thuhet se opinioni i përgjithshëm nuk gjykon se duhet ndëshkuar ndonjë parti thjesht për faktin se programi i saj nuk përputhet plotësisht ose në një masë të madhe me krahun ideologjik që ajo pretendon t'i përkasë? kemi një rezultat negativ të testimit empirik të indikatorëve 1.

Anketuesit e konfirmojnë indikatorin 1 për elektoratin e PDK dhe LDK dhe e hedhin poshtë për elektoratin e VV. Por kemi edhe një rezultat negativ të testimit empirik të indikatorëve 1. Kështu që në total raporti midis tyre është 2 : 1 në të mirë të rezultatit negativ të testimit empirik të indikatorëve 1.

Për sa i përket Lëvizjes Vetëvendosje nga tabela kuptojmë se **64.1% e anketueseve** që pohojnë se ka mospërputhje midis programit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe krahut ideologjik që ajo pretendon se i përket elektorati do të reagoj me mos votim për këtë parti në zgjedhje të radhës. Ndërsa, **7.1%** e anketueseve që pohojnë se ka mospërputhje midis programit të VV dhe krahut ideologjik që ajo pretendon se i përket, nuk mendojnë elektorati do të reagoj me mos votim të kësaj partie në zgjedhje të radhës. Raporti midis

tyre është 9.0 :1 në të kundër të opsionit të mos votimit. Pra edhe në këtë rast kemi një **rezultat negativ** të testimit empirik.

KAPITULLI V: REZULTATET E ANALIZËS TË INDIKATORËVE

5.1 Rezultatet e analizës të Indikatorit 1

Indikator 1: Nëse rrethanat politike dhe historike të statusit të Kosovës (deri më 2008), ka qenë një nga faktorët që e ka bërë të padukshme ideologjinë në kuadër të partisë, atëherë është e mundur që të gjenden të dhëna që e konfirmojnë atë.

Në Kosovë, partitë politike janë shfaqur në përgjigje të nevojave dhe luftërave për formimin e një shteti të pavarur.

Partitë politike filluan të manifestohen gjatë dhe pas rënies të Republikës Federale Sociale të Jugosllavisë. E para parti politike serioze ishte LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) e themeluar në vitin 1989 dhe e udhëhequr nga Ibrahim Rugova. Disa studiues e konsiderojnë themelimin e LDK-së më shumë si lëvizje e pavarësisë, sesa formimi i një partie politike (Hofmeister, 2013).

Themelimi i partive të tjera pasoi në vitet 1990- 1991; ato parti u përpoqën të krijojnë një sistem paralel politik, duke u shkëputur nga institucionet serbe. Partitë e reja politike si Partia Demokristiane e Kosovës, Partia Liberale e Kosovës, Partia Social Demokrate e Kosovës, të gjithë nuk arritën të mbledhin mbështetje dhe organizojnë në mënyrë efektive si LDK-ja.

LDK ishte veçanërisht me ndikim jashtë Kosovës, kryesisht në atë perëndimore dhe vendet evropiane, ku jetonte diaspora shqiptare.

Duke analizuar rrugën e zhvillimit të partive politike të Kosovës pashmangshëm duhet analizuar edhe rrethanat politike dhe historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova.

Në këtë seksion përshkruam se si partitë politike në Kosovë u identifikuan me një profil të caktuar ideologjik. Këtu përshkruhen rastet kur ato identifikojnë veten qartë me një

pozicion ideologjik, që zakonisht gjenden në deklaratat e udhëheqjes partiake, në programin e partisë, ose nënkuptohet përmes përpjekjeve të tyre për anëtarësim në grupimet partiake pan-evropiane. Partitë politike, në vend që të propozojnë ideologji ose programe politike, zgjedhën premtime pompoze për qindra mijëra vende të reja të punës, zhvillim ekonomik, liberalizim të vizave dhe hyrje në BE dhe NATO.

Nga ballafaqimi i të dhënave që testojnë indikatorin 1 del se ato konfirmojnë pikërisht këtë ndikim.

5.2 Rezultatet e analizës të indikatorit 2

Indikator 2: Nëse administrata ndërkombëtare në Kosovës (deri më 2008), ka qenë një nga faktorët që e ka bërë të padukshme ideologjinë në kuadër të partisë, atëherë është e mundur që të gjenden të dhëna që e konfirmojnë atë.

Në punim u ndalëm për të analizuar moszgjidhjen e statusit të Kosovës deri më 2008 si një nga faktorët që e ka bërë të padukshme ideologjinë në kuadër të partisë. Rruga e profilizimit dhe zhvillimit të partive të Kosovës për krijimin e konsistencës në qëndrimet e veta lidhet ngushtë me rrugën e politikës së Kosovës drejt modernizimit. Me përmbushjen e nevojave themelore (për rrugë, ujë, kanalizim), premtimet që kosovarët e zonave rurale presin të përmbushen janë më pak të lidhura me kufijtë gjeografik.

Gjatë administratës ndërkombëtare në Kosovë, roli i UNMIK-ut ishte shumë i rëndësishëm dhe i fuqishëm në vendosjen, bërjen dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave në të gjitha fushat. Për më tepër, ai ishte gjithashtu i përfshirë në sistemin partiak dhe politik, përfshirë organizimin e zgjedhjeve, sistemin zgjedhor, kohën e zgjedhjeve, certifikimi dhe shpalljen

e rezultateve të zgjedhjeve. UNMIK emëroi pakicat serbe në disa raste për shkak të kundërshtimit të tyre për të marrë pjesë në zgjedhje për arsye politike. Duke analizuar rrethanat në për të cilat kanë kaluar Partitë Politike në Kosovë gjatë fazës së administrimit ndërkombëtar, mund të konkludojmë se atyre ju mungonte ndonjë ideologji dalluese. Për më tepër kjo paqartësi ka vazhduar të jetë trashëguese edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Trashëgimia e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) vazhdon të ketë ndikim në sistemin politik të Kosovës. Protektorati ndërkombëtar, mungesa e përcaktimit të statusit politik dhe marrëdhënieve me Serbinë, kanë përcaktuar kryesisht drejtimin ideologjik të partive politike në Kosovë.

Nga ballafaqimi i të dhënave që testojnë indikatorin 2 del se ato konfirmojnë pikërisht këtë ndikim.

5.3 Rezultatet e analizës të indikatorit 3

Indikator 3: Nëse efektet globale është një nga faktorët që Partitë Politike nuk kanë një raport të qartë me ideologjinë, atëherë është e mundur të gjenden të dhëna që e konfirmojnë atë. Shumë studiues kanë paraqitur globalizimin si sfidë tepër të madhe për sofranitetin e shteteve për arsye politika e jashtme e një vendi është e ndikuar nga institucionet ndërkombëtare.

Në këtë kuadër ekziston dëshira e shtetit që politika e jashtme e saj të harmonizohet me politikën e institucioneve ndërkombëtare në këmbim për favorizimet të llojit të ndryshëm.

“Globalizimi ekonomik ndikon fuqishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare përmes procesit të integritit të tregut, mallrave, shërbimeve dhe të financave” (Lami, 2013). Konceptet e

majtë e djathtë në rrethanat e tanishme të globalizmit duket se u nënshtrohen modeleve të njëjta ideologjike. “Në kuadrin e doktrinës globaliste, si objektiv kryesor i veprimit është zvogëlimi i fushës së veprimtarisë së qeverive në raport me fluksin transnacional të kapitaleve si dhe reduktimi i sovranitetit nacional në marrjen e vendimeve në favor të fuqisë vendimmarrëse të institucioneve e të organizmave ndërkombëtare të tilla si: FMN-ja, Banka Botërore, OBT -ja, BE –ja, etj” (Lami, 2013). Shumë studiues vlerësojnë se politikat e ndjekura nga këto organizma kanë tendenca globalizuese të djathta.

Shteti i Kosovës ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi veçanërisht me FMN dhe BB. Institucionet e Kosovës kanë respektuar dhe janë munduar maksimalisht të përfitojnë në performancën e tyre nga këshillat dhe sugjerimet e FMN-në. Mirëpo, nëse e shikojmë nga perspektiva ideologjike rolin e FMN-së në Kosovë atëherë vërejmë disa probleme.

P.sh, procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është zhvilluar sipas rekomandimeve të FMN-së.

Për sa i përket privatizimit, që në parim është një koncept bazë i partive të djathta, asnjë nga partitë politike në Kosovë nuk e kundërshtojnë atë.

Për më tepër, ato kundërshtojnë vetëm mënyrën e privatizimit të aplikuar në Kosovë nga AKM duke e sulmuar atë proces si të padrejtë dhe të dështuar. Nga perspektiva e punëtorëve dhe punësimit, partitë politike përqafojnë qasjen tradicionalisht të djathtë se përmes privatizimit do të krijohen vende të reja të punës, gjë që nuk është praktikë shumë e shpeshtë në proceset e privatizimit nëpër vendet e tjera.

Andaj, ndjekja e udhëzimeve të FMN-së në Kosovë kanë ndikuar në raportin e ideologjisë me partitë politike përkatësisht me identitetin e tyre ideologjik.

Pavarësisht se cila parti politike ka qenë në pushtet, secila nga ato është dashur të ndjekë rekomandimet e FMN-së me qëllim përfitimin nga fondet e akorduara për shtetet bashkëpunuese.

Kjo sjellje e partive politike në raport me FMN-në, mundet të justifikohet dikur ditur nivelin e zhvillimit ekonomik dhe dëshirën për të përfituar sa më shumë nga ky institucion.

Duke ballafaquar të dhënat që testojnë indikatorin 3 del se ato konfirmojnë pikërisht këtë ndikim.

5.4 Rezultatet e analizës të indikatorit 4

Indikatori 4: Nëse faktorët e brendshëm partiak duke përfshirë këtu mungesën e elitave politike të strukturuar sipas ideologjive është një nga faktorët që ka ndikuar në raportin Parti Politike me Ideologjinë, atëherë kemi gjetur të dhëna që e konfirmojnë atë.

Nga këndvështrimi i politologëve demokracia paraqitet si metodë për realizimin e qeverisjes nga elitat politike më tepër se sa instrument i sigurimit të pushtetit të masave.

Në këtë kuadër, procesi politik më tepër se sa të formësohet nga preferencat e elektoratit, drejtohet nga aspiratat, qëllimet dhe ambiciet e politikanëve (Lami, 2013). Kështu, në këtë kuadër mund të analizohen një sërë veprimesh të rëndësishme të politikanëve shqiptare dhe mund të kuptohen derivatet e procesit politik të menaxhuar nga elitat.

Një pjesë e elitës u përfshinë në politikë duke mbart me vete edhe mentalitetin e së kaluarës, ndërsa pjesa tjetër mungesën e përvojës për tu ballafaquar me sfidat e kohës.

Partitë politike në Kosovë ende nuk kanë lëvizur prej deklaratave të tyre normative, të cilat e tregojnë dëshirën e udhëheqjes partiake se në çfarë drejtimi dëshirojnë ta zhvillojnë partinë në të ardhmen. Profilin ideologjik të cilin e shfaqin në ligjërimin e tyre politik nuk përputhet me qëndrimin që ato parti kanë për çështje të ndryshme e aq më tepër me historinë e votimit të tyre në Kuvend.

Lidershipi i partisë nuk është hartë e orientimit të partive politike. Emërtimet ideologjike që ata përdorin nuk përshtaten me veprimet e tyre në qeverisje.

Se a do ta arrijë partia të ndërtojë një profil të qartë ideologjik, varet prej mendimeve të një grupi më të gjerë të udhëheqësve të partive politike. Për këtë, është me rëndësi thelbësore të analizohen partitë politike kryesore në Kosovë si: Partia Demokratike e Kosovës –PDK dhe Lidhja demokratike e Kosovës – LDK, të cilat kanë mbajtur barrën kryesore të ndërtimit të shtetit të Kosovës.

Është po ashtu e rëndësishme të analizohen edhe ligjërimet politike të udhëheqjes të partive politike dhe aktivistëve me ndikim në parti. Konsistenca e qëndrimeve të partive politike është me rëndësi themelore në transicion, pasi partitë transformohen gradualisht nga të qenit mjete për realizimin e interesave të grupeve të caktuara në të qenit përfaqësues të një baze stabile të votuesve me interesa të përbashkëta specifike.

Aktualisht, popullariteti buron prej emrave të caktuar, dhe sa herë që një zyrtar i lartë kalon në një parti tjetër, ai/ajo i merr me vete edhe simpatizantët e vet. ***Duke ballafaquar të dhënat e studiuara që testojnë indikatorin 4 del se ato konfirmojnë pikërisht këtë ndikim.***

KAPITULLI VI: DISKUTIMET DHE PËRFUNDIMET

6.1 Kufizimet e studimit-Implikimet dhe hulumtimet në të ardhmen

Sikurse çdo studim, edhe ky studim ka disa kufizime që kërkimet e ardhshme mund të ndihmojnë në tejkalimin e tij. Së pari, modeli i hulumtimit i këtij studimi nuk më lejon të vëzhgoj mikro-proceset që injektojnë krijimin e paqartësisë së ideologjisë tek partitë politike në Kosovë. Ndërsa unë ndjek në gjurmët e studimeve të mëparshme në shpjegimin se si proceset politike dhe historike, pastaj ndikimi i administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe globalizmi kanë ushtruar ndikimin e tyre që konceptet “e majtë”, “e djathtë” kanë qenë të padukshme tek partitë politike në Kosovë.

Hulumtimet e ardhshme mund të shqyrtojnë ndikimin relativ të këtyre faktorëve, ose prania e mekanizmave të tjerë që mund të japin një shpjegim për gjetjet e këtij studimi.

Analiza jonë në rrafshin teorik ballafaqohet me disa kufizime që shpërfillin nënvariabla që mund të kenë një ndikim pjesërisht apoqenësor në fenomenin që analizohet.

Më konkretisht, këtë e ndeshim tek identifikimi i variablave të varur si: Statusi i pazgjidhur i Kosovës (deri 2008), prezenca e administratës ndërkombëtare në Kosovë, reformat të imponuara nga Bashkësia Ndërkombëtare, mungesa e elitave politik si dhe efektet globalizuese. Dhe, ajo që theksohet në këtë studim, masa e ndikimit të këtyre variablave varion në kohë të ndryshme, me masë të ndryshme. Prandaj në këtë punim doktore, kufizimet janë të pashmangshme.

Ky studim poashtu ofron një analizë të thelluar makro duke evidentuar disa nga variablat që ndikojnë në aspektin e raportit midis ideologjisë dhe partive politike në Kosovë. Të gjitha këto variabla, të trajtuar në këndvështrimin e raportit ideologji parti politike.

Duke e parë ideologjinë si diçka e projektuar nga partitë politike, ne e drejtojnë vëmendjen në të kuptuarit publik të pozicionit të partisë, duke pranuar se thëniet e partive dhe sjellja nuk janë parë gjithmonë të jetë i motivuar nga ideologjia. Kjo na shpie për të marrë parasysh formën e mundshëm dhe rëndësinë e ideologjisë që përcillet nëpërmjet retorikës së elitës partiake, duke zhvilluar një kornizë metodologjike e cila konsideron kontekstin e fjalimeve, motivet alternative të partisë dhe qëndrueshmëri ideologjike në aplikimin dhe arsyetimin e ideve.

6.2 Risia e këtij studimi

Mund të thuhet se studime të tilla të kësaj ka pasur edhe nga studiues kosovarë. Evidentojmë këtu analizën e prof. Adem Beha në librin “Zgjedhjet, partitë politike dhe demokracia brenda partiak”, ku trajtohet ndër të tjera edhe aspekti ideologjik i partive politike në Kosovë dhe i bëhet kritikë mungesës së ideologjive të qarta të partitë politik në Kosovë. Në këtë libër, kritikohet fuqia e pa kontestuar e liderit për të ekzekutuar vendime pa konsultuar as anëtarësinë e gjerë dhe as strukturat vendimmarrëse pamundëson vendimmarrjen demokratike brenda partive politike. Kjo trajtesë përshtatet me variabilen tonë të hipotezës se paqartësia e raportit midis ideologjisë dhe partive politike në Kosovë ka të bëjë edhe me arbitraritetin e leadershipit të partisë se në çfarë profili ideologjik synon të zhvillojë partinë në të ardhmen. Profilin politik të cilin partitë e kërkojnë nuk përkon me qëndrimin që e kanë për çështje të ndryshme e as me historinë e votimit të tyre në Kuvend. Gjatë gjithë studimit, nënvizohet mungesa e elitave politike në raport me orientimin e tyre ideologjik.

Gjithashtu, disa studime janë kryer edhe nga ambasadori Leon Malazog nga instituti “D4D”, ku është hulumtuar mbi profilet ideologjike në kontekstin e disa demokracive perëndimore. Gjetjet e prezantuara nga ky studim na ndihmojnë për të kuptuar më mirë nivelin e pikëpamjeve, dhe ka mundësi të inkurajojë partitë të zhvillojnë politika pozicionuese dhe të kenë një dozë “rikonstruktimi”. Autori i kushton një vëmendje të madhe orientimit ideologjik të partive politike në Kosovë duke përdorur si metodë pune intervistimin e 160 zyrtarë të lartë të katër partive më të mëdha në Kosovë. Marrë në përgjithësi, të gjitha studimet kanë një karakter deskriptiv dhe mund të thuhet harta e

orientimit të partive politike është bërë vetëm në kuadrin e kuadratit të dëshiruar ideologjik të zyrtarëve partiakë.

Një analizë e karakterit përshkrues nga pikëpamja teorike është bërë edhe nga instituti “KIPRED”, tek: “*Sistemi Zgjedhor dhe Partiak në Kosovë*”. Autori në këtë analizë ofron elementë analitikë duke na informuar për zhvillimin e partive politike që nga përfundimi i luftës. Një analizë serioze për funksionalitetin e partive politike në Kosovë është ndërmarrë nga studjuesi Valon Krasniqi që është botuar në Revistën shkencore “*Revista de Saúde Pública*”. Autori ka përdorur teoritë më të spikatura në fushën e shkencave politike për të pasqyruar një raport të mundshëm midis partive politike dhe ideologjisë.

Gjithashtu, duhet nënvizuar se në të gjitha këto studime nuk analizohen disa variabla që kanë pasur ndikim në paqartësinë e raportit midis partive politike dhe Ideologjisë, siç janë: efektet globale, roli i FMN-së dhe mungesa e elitave politik sipas profileve ideologjike.

Ky punim sjell risi në literaturën shkencore mbi raportin që Partitë politike kanë me ideologjitë.

Ky punim doktrate ka implikime thelbësore për qartësimin e raportit ndërmjet Ideologjisë dhe partive politike. Hulumtimet paraprake kanë një perspektivë socio-ekonomike tepër të madhe për të analizuar raportin midis Partive Politike dhe Ideologjisë, ne kemi marrë në konsideratë faktorët politikë që kanë ndikim në raportin e ideologjisë me partitë politike.

Ky studim ndërmerr hap të rëndësishëm në atë drejtim duke marrë parasysh bazat ideologjike të sjelljes së partive politike në shmangien e ideologjisë. Duke treguar që partitë politike ndryshojnë në mënyrë sistematike jo vetëm në prirjen e tyre ideologjike por dhe në ligjërimin e tyre politik dhe vendimmarrje. Ky studim përfshin një hapësirë të

konsiderueshme në zgjerimin e të kuptuarit shkencor të paqartësisë ideologjike tek partitë politike në Kosovë.

Si i tillë, ky studim kontribuon në literaturën mbi “Ideologjinë politike në Partitë Politike”, duke demonstruar efekte në një kontekst të rëndësishëm, por ende të anashkaluar, deri tani tek partie politike.

Ne argumentojmë që partitë politike në Kosovë kanë një lidhje të dobët me ideologjinë dhe nuk janë pozicionuar mirë sipas kërkesave të krahëve ideologjik të caktuar, pasi ato ofrojnë pikëpamje kontradiktore mbi pikëpamjet socio-ekonomike dhe vendimmarrjen në qeverisje. Nga pikëpamje ideologjike sugjerohen pikëpamje të qarta lineare për sa i përket programeve politike, ligjërimit politik dhe vendimmarrjes në qeverisje si kriter për qartësimin e pozicionimit ideologjik.

Risia e këtij studimi qëndron pikërisht tek fakti se ndryshe nga autorët e mësipërm, autori i këtij punimi synon të ofrojë një analizë makro dhe mikro të fokusuar vetëm tek aspekti i raportit midis ideologjisë dhe partive kryesore politike. Mbrojtja e paradigmës se fati i ideologjisë përcaktohet nga strukturimi politik, social dhe ekonomik përbën një risi në këtë studimi.

Më specifikisht fati i ideologjisë tek partitë politike në Kosovë në masë të madhe është ndikuar nga rrethanat politike dhe historike, duke përjashtuar modelin ideologjik të themelimit të partive; paqartësia e raportit midis ideologjisë dhe partive politike në Kosovë u ndikua edhe nga administrata ndërkombëtare, mos përcaktimi i statusit dhe marrëdhënieve me Serbinë; roli i institucioneve ndërkombëtare, mungesa e elitave të strukturuar sipas krahëve ideologjik si dhe efektet globalizuese.

Prandaj, mund të thuhet që studimi sjell një risi edhe për faktin se i kushton një rëndësi të posaçme rolit të faktorit ndërkombëtar në drejtim të shpjegimit të raportit parti politike - ideologji.

Një risi tjetër që sjell punimi është edhe hetimi empirik i perceptimit që ka elektorati në Kosovë për strukturën e raportit parti politike – ideologji. Kjo për faktin se shqyrtimi i këtij problemi nuk mbetet si deri tani, në rrafshin e opinionëve personale të shprehura në libra apo debate mediatike, por ngrihet në nivelin e analizës të të dhënave të një studimi të tipit empirik.

Një aspekt i rëndësishëm i studimi paraqet dhe përzgjedhja e temës. Një temë e cila është sfiduese për çdo studiues për shkak të numrit të variablave që ajo mbart. Shumë autorë mbrojnë idenë se trajtimi i këtij problemi, konsiderohet si shumë sfidues por i vlefshëm për fatet e politikës. Vlera e saj buron nga karakteristikat dhe funksionet që ai mbart.

Përderisa një profil i caktuar ideologjik do ta forconte disiplinën e partisë, konsistenca e qëndrimeve mund ta kufizojë lirinë e veprimit të udhëheqësve individualë dhe si rrjedhojë do ta forconte demokracinë e brendshme partiake.

Madje autorë si: Newman, Bobbio, Seiler, Ingleart, Down arrin në konkluzionin se vetëm ato parti të cilat mbështeten në ideologji të caktuara mund t'i rezistojnë kohës dhe konkurrencës politike.

Ne shprehim bindjen se ky punim doktrate ofron një kontribut modest në drejtim të kuptimit të paqartësisë së raportit parti politike – ideologji. Sigurisht, nuk pretendohet të jemi shterues në analizë për vetë kompleksitetin që mbart problemi, por të paktën të ofrohet një kuptim analitik mbi raportet që kanë partitë politike në Kosovë me ideologjinë, si dhe të

kuptohen më mirë roli i strukturave makro, brenda dhe jashtë vendit në drejtim të identitetit të partive politike.

6.3 Përfundimet

Në këtë punim jemi fokusuar kryesisht në paqartësinë e raportit parti politike – ideologji. Punimi është trajtuar në dy pika: e para është se paqartësia e raportit të partive politike me ideologjinë vërehet në programet e tyre zgjedhore dhe e dyta ligjërimet politike.

Është konstatuar se ka një paqartësi në raportin midis partive politike me ideologjitë. Shpesh herë partitë politike në Kosovë i përcaktojnë programet jo në përputhje me orientimet e tyre ideologjike që ato pretendojë se i përkasin. Një situatë e tillë vërehet edhe në raportin midis veprimit politike dhe krahut politike që ata pretendojnë se i përkasin.

Si përfundime, ne mund të konsiderojmë qasjet e mëposhtme:

krijimin e Partitë politike në Kosovë u ndikuan nga rrethanat politike dhe historike, duke përjashtuar modelin ideologjik të themelimit të partive; paqartësia e raportit midis Ideologjisë dhe Partive Politike në Kosovë u ndikua edhe nga administrata ndërkombëtare, mos përcaktimi i statusit dhe marrëdhënieve me Serbinë; partitë politike në Kosovë janë në proces të konsolidimi dhe profilizimi. Kjo shfaqet gjatë debateve, ofertave elektorale dhe programeve të tyre.

Gjatë periudha 1999 deri në 2008, mund të thuhet se qëllimi i partive politike ishte fillimisht të orientuara për të krijuar institucione me mbështetjen e UNMIK-ut, ekonomike dhe sociale zhvillimi, por pa ndonjë udhëzim të qartë se si t'i qasemi ideologjisë dhe zhvillimi institucional. Kjo u imponua nga konteksti në të cilin partitë politike vepruan nën të administrata ndërkombëtare deri në zgjedhje dhe më pas me disa fuqi qeveritare, por ende i kufizuar. Gjatë kohës së administratës ndërkombëtare, programi i vetëm 'ideologjia' e të gjitha partive shqiptare në Kosovë ishte pavarësia dhe prosperiteti ekonomik. Ndërsa ndarjet ideologjike, e djathta, e majta, qendra, ishin konceptet që diskutoheshin zyrtarisht.

Sistemi partiak në Kosovë zyrtarisht është më i pozicionuar si i djathtë i qendrës. (PDK, LDK dhe AAK) (ndërsa në përmbajtje ata kanë më shumë politika të majta për çështje sociale dhe ekonomike, konkretisht në fushat e mirëqenies sociale dhe mbështetjes për disa shtresa sociale). Politik partitë dhe shoqëria në Kosovë ka qëndrime unike ndaj zhvillimeve të caktuara, të tilla si: Integrimi Evropian, ushtria e ardhshme e Kosovës (nuk aplikohet për serbët e Kosovës), luftë kundër fenomeneve negative, politikës së jashtme, përveç VV me disa të ndryshme afrohet. PDK, LDK, AAK janë politikisht më gjithëpërfshirëse dhe më pak të profilizuara, ndërsa VV është më e profilizuar si qendër e majtë drejt çështjeve ekonomike dhe si e djathtë në lidhje me çështjet politikën.

Sistemi i Partive Politike në Kosovë mbetet i pa përcaktuar në kuptimin e përcaktimit paraprak të partitë politike për partnerin e koalicionit. Kjo krijon pasiguri gjatë fushatës zgjedhore dhe si rezultat edhe në qeveria. Partitë politike në Kosovë janë monoetnike (shqiptarë, serbë, turq, etj.) Boshnjak), përkundër faktit se qëllimi i administratës ndërkombëtare ishte krijimi i një multi shoqëria etnike. Partitë politike në Kosovë janë kryesisht më Karizmatike dhe Klientlistë, dhe më pak të bazuara në programe dhe ideologji.

Duke krahasuar raportin e ideologjisë me partitë politike në Republikën e Kosovës, vërejmë se paqartësitë në raportin në fjalë kushtëzohen nga faktorë social, ekonomik dhe politike të tillë si: zgjidhja e statusit të Kosovës (deri më 2008), mungesa e elitave të strukturuar sipas krahëve ideologjik si dhe efektet globale.

Siç edhe mund të vërehet nga ky studim, partitë politike në Kosovë e përdorin retorikën politike pa ndonjë qëllim të asociimit të politikave të veta me ideologji të caktuar politike. Andaj, për të krijuar një pasqyrë më të qartë rreth pozitës së partive kryesore në Kosovë në

raport me ideologjitë politike, si dhe çështjeve që mund të trajtohen në të ardhmen, është e domosdoshme të bëhet një klasifikim relativ krahasues ndërmjet këtyre partive.

Në favor të kësaj qasjeje shkon edhe argumenti i kontekstit lokal dhe rrethanave specifike socio- ekonomike jashtë të cilave çdo analizë do të ishte e kotë.

